

**PAN-SHQIPTARIZMI:
SA ËSHTË I MADH KËRCËNIMI PËR STABILITETIN E BALLKANIT?**

25 Shkurt, 2004



Raport Evropian N°153
Tiranë/Bruksel

TABELA PËRMBAJTËSORE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME	i
I. HYRJE	4
A. HISTORIK PËRMBAJËSOR.....	2
B. PAS RËNIES: KAOSI DHE ASPIRATAT E REJA.....	5
II. NGRITJA DHE RËNIA E AKSH-	8
III. SHQIPËRIA: KËNDVËSHTRIME NGA TIRANA	12
IV. KOSOVA: NDARJET E BRENDËSHME	16
V. MAÇEDONIA: A DO TË DUHEJ TË QËNDRONIM APO TË SHKONIM?.....	19
VI. MALI I ZI, SERBIA JUGORE DHE GREQIA	22
A. TË GJITHË TË QETË NË FRONTIN PERËNDIMOR?.....	22
B. LUGINA E PRESHEVËS NË SERBINË JUGORE	24
C. ÇËSHTJA GREKE	26
VII. EMIGRIMI, IDENTITETI DHE FUQIA E DEMOGRAFISË	27
A. DIASPORA: POLITIKA DHE KRIMI.....	27
B. DIMENZIONI DEMOGRAFIK	30
C. INTEGRIMI EKONOMIK.....	31
D. LIDHJET KULTURORE	32
VIII. KONKLuzion	33
SHTOJCAT	
A. HARTA E SHQIPËRISË	33
B. PËRMBLEDHJE E EMRAVE, AKRONIMEVE DHE TERMINOLOGJISË SË PËRDORUR.....	34
C. RRETH GRUPIT NDËRKOMBËTAR TË KRIZAVE.....	35
D. RAPORTET E ICG-SË DHE DOKUMENTET RAPORTUESE	36
E. ANËTARËT E BORDIT TË ICG-SË.....	42

PAN-SHQIPTARIZMI: SA ËSHTË I MADH KËRCËNIMI PËR STABILITETIN E BALLKANIT?

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE DHE REKOMANDIME

Pan-shqiptarizmi nga shumë vëzhgues është parë si kërcënim serioz për stabilitetin e Ballkanit. Lëvizja për një shekull e kufinjëve i ka lënë shqiptarët të shpërndarë në Kosovë, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni dhe Greqi. Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), Armata Kombëtare Shqiptare (AKSH) në Maqedoni, dhe grupe të tjera kanë zhvilluar fushata violente në mbështetje të fitimit të të drejtave për shqiptarët etnik. Cili është qëllimi i ambicjeve të tilla shqiptare?

Hulumtimet e ICG-së tregojnë se nocionet e pan-Shqiptarizmit janë shumë më shumë të shtrira dhe komplekse sesa çështja e karakteristikave të zakonshme të shqiptarëve etnik thjesht që synojnë arritjen e Shqipërisë së madhe ose Kosovës së madhe. Është domethënëse çështja se UÇK dhe AKSH filluan të marrin mbështetje nga popullata në Kosovë dhe Maqedoni pikërisht dhe përkatësisht në kohën kur pjestarë të tyre lëvizën nga qëllimet nacionaliste pan-shqiptare dhe u kocentruan në të drejtat e popullit të tyre. “Armata Kombëtare Shqiptare” (AKSH) që prej kur hapurazi plasoi agjendën lidhur me një “Shqipëri të madhe”, kurrë nuk arriti të fitojë kredibilitetin e popullatës. Dhuna e ushtruar për kauzën e Shqipërisë së madhe, ose të çfarëdo lloj lëvizje të kufinjëve nuk është politikisht popullore e as moralisht e arësytuar.

Në Shqipëri, që prej vendosjes së politikës multi-partiake, varfëria dhe konflikti i brendshëm partiak kanë errësuar çdo lloj aspirate që shpjen në drejtim të zgjerimit të kufinjëve shtetëror. Shqipëria është më shumë e interesuar për zhvillimin e lidhjeve ekonomike dhe kulturore me Kosovën, përderisa të

dyja të ruajnë shtetësitë e ndara; dhe qeveritë e njëpasnjëshme shqiptare kanë zgjedhur partneritetin strategjik me Maqedoninë për shkak se të dyja aspirojnë drejt anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian.

Mbetet një rrezik i konfliktit në Kosovë, ku nuk është zgjedhur ende çështja e statusit të ardhshëm të sajë. Dëshira e pjesës më të madhe të popullatës së Kosovës për pavarësi është përkrahur nga shumica e shqiptarëve nga çdo pjesë e Ballkanit. Sidoqoftë, një Kosovë e pavarur është krejt e ndryshme nga opcioni për Shqipërinë e madhe. Problemi i Bashkësisë Ndërkombëtare është që të menaxhoj procesin që ka të bëjë me statusin final të Kosovës pa destabilizuar fqinjët e sajë.

Dihet se edhe në Maqedoni edhe në Luginën e Preshevës së Serbisë Jugore, konflikti ka përfunduar më 2001 me ndërmetësimin ndërkombëtar të marrëveshjeve të paqes, përkatësisht të Marrëveshjes së Ohrit dhe të Planit të Qoviqit. Ndonëse ekziston pakënaqësia lidhur me shpejtësinë e implementimit të këtyre marrëveshjeve dhe zhvillimin e reformave të premtuara, kjo pakënaqësi ende nuk ka arritur stadin e krizës; nga ana tjetër përpjeket e AKSH-së për të kapitalizuar pakënaqësinë vendore në Maqedoni dhe në Serbinë Jugore kanë dështuar. Vëmendja e vazhdueshme ndërkombëtare do të jetë e domosdoshme për të përmbushur premtimet për të gjitha palët. Shqiptarët e Malit të Zi në anën tjetër i kanë rezistuar çdo lloj aktiviteti të organizimit paraushtarak.

Komunitete të diasporës së madhe të shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në SHBA, Gjermani dhe Zvicër kanë pasur dhe do të vazhdojnë të kenë një rol kyç në zhvillimet aktuale ekonomike, sociale, politike në Kosovë, tani dhe në të ardhmen si dhe do të vazhdojnë të drejtojnë ngjarjet e formacioneve ushtarake në këto hapsira. Ato shumë lehtë do të hapnin fronte të reja nëse do të dëshironin të mbanin tensionin e ngritur karshi çështjeve të pazgjidhura shqiptare. Për këto arsye do të ishte mirë që Qeveria Shqiptare dhe ajo Greke të provojnë të përpilojnë një marrëveshje të qëndrueshme dhe afatgjate të çështjes së popullatës Çame të zhvendosur nga Greqia më 1945, para se kjo çështje të ketë marrë hov dhe eksploduar nga nacionalistët ekstremist, atëherë kur ankesat legjitime të Çamëve do të ishin humbur në çështje më të thella kombëtare.

Në afat më të gjatë, nacionalizmi shqiptar do të zbutet me zbatimin e tërësishëm të marrëveshjeve të arritura me ndërmjetësimin ndërkombëtar për shqiptarët në Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi si dhe me mbajtjet e vazhdueshme të presionit ndaj ekstremistëve dhe politikanëve shqiptarë të cilët i nxisin ata. Procesi do të ndihmohet nga integrimi evropian, atëherë kur kufinj të hapen ndërmjet Shqipërisë dhe dhe fqinjëve verior me çrast gjasat për integrim ekonomik dhe arsimim në regjion në përgjithësi të jenë rritur. Decentralizimi i pushtetit në Maqedoni, dhe dhënja me kusht e pavarësisë së Kosovës me qëllim të sigurimit nga ana e të gjitha etniteteve shqiptare në Ballkan se kufinj të tanishëm të Evropës Jug-lindore në Evropë do të mbesin të pandryshuar, do të ndihmoj gjithashtu në stabilizimin e situatës.

REKOMANDIME

Për Qeverinë e Shqipërisë:

1. Të vazhdohet me përpjekjet për neutralizimin e grupeve paramilitare dhe grupeve të politikanëve ekstremist duke ndërmarrë masa energjike kundër të gjitha trafikimeve të armëve ilegale si dhe duke bërë grumbullimin dhe ruajtjen e armëve në Shqipëri si dhe vënien e ligjit për bashkëpunim me shtetet fqinje dhe Unionin Evropian.

Për UNMIK-un dhe KFOR-in:

2. Të behët intensifikimi i përpjekjeve për siguri kundër krimit të organizuar dhe militantëve politik, në veçanti të bëhet sigurimi i kufinjëve të Kosovës në mënyrë me efikase.
3. Të përgaditet një proces paqësor, legal dhe demokratik lidhur me zgjidhjen e statusit final për Kosovën, duke përfshirë këtu nëse është e domosdoshme edhe ndalimin e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

Për Qeverinë e Maqedonisë:

4. Të vazhdohet me implementimin e Marrëveshjes së Ohrit duke përfshirë edhe reformat në sektorin e sigurisë dhe centralizimin.

Për Qeverinë e Serbisë:

5. Të bëhet ndërtimi i trupit koordinues për Serbinë jugore.
6. Frenimi elementëve ekstremist në forcat e sigurisë.
7. Shtrëngimi i kontrollave doganore përgjatë kufirit administrativ me Kosovën si dhe të luftohet krimi i organizuar.

Për Qeverinë e Malit të Zi:

8. Të ndihmohet në themelimin e një kolegjii trajnues të gjuhës shqipe në Tuz ose Ulçin, me qëllim të trajnimit të mësuesve të shkollave të ardhme fillore dhe të mesme.

Për Qeverinë e Greqisë:

9. Të ndërmirren masa të menjëherëshme për përmirësimin e të drejtave të njeriut për të gjithë shqiptarët me banim në Greqi.
10. Të hapen negociata lidhur me rivendosjen e të drejtave të duhura për Çamët.

Për liderët politik shqiptarë në tërë Ballkanin:

11. Flisni hapur kundër politikanëve ekstremist dhe grupeve violente të cilët kërkojnë të minojnë marrëveshjet paqësore të pesë viteve të fundit.

Për Komunitetin Ndërkombëtar, në veçanti Unionin Evropian dhe shteteve anëtare:

12. Të vazhdohet me implementimin e marrëveshjes së Ohrit dhe planit të Çoviqit.
13. Të bëhet presion për rritjen e asistencës për qeverinë shqiptare dhe qeveritë fqinje për të

mundësuar luftën e vendosur kundër tregtisë ilegale dhe kontrabandës.

14. Të ndihmohet mënjanimi i pengesave për zhvillimin e tregtisë ndër-shqiptare
15. Të lehtësohet dhënja e vizave për banorët e Evropës Jug-lindore që dëshirojnë të punojnë ose vizitojnë shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.
16. T'i ipet reagim pozitiv aplikimit të Maqedonisë për antarësim në Unionin Evropian, si dhe të kurajoj aspiratat e Shqipërisë për antarsim në BE dhe të përkrahen aspiratat e Shqipërisë dhe Maqedonisë për anëtarësim në NATO.
17. Të vazhdohet me monitorimin e aktiviteteve të ekstremistëve shqiptarë dhe politikanëve që i mbështesin ata.

Tiranë/Bruksel, 25 shkurt, 2004



ICG –Evropë/ N°153

25 shkurt 2004

PAN-SHQIPTARIZMI: SA ËSHTË I MADH KËRCËNIMI PËR STABILITETIN E BALLKANIT?

I. HYRJE

Gjatë vitit 2003, spektri i gjerë i përkrahjes ushtarake për një Shqipëri të madhe është paraqitur në skenë edhe një herë në Ballkan, me një organizim të ri- Armata Kombëtare Shqiptare (AKSH), duke premtuar luftën për bashkimin e tërë popullit në një shtet të vetëm. Sidoqoftë, AKSH kurr nuk erdhi në një masë kritike prej nga do të kërkonte përkrahjen e gjerë popullore, në asnjë pjesë të Ballkanit të banuar me shqiptarë. Shqipëria për momentin, ka prioritete të tjera;¹ Shqiptarët e Maqedonisë që nga Marrëveshja e Ohrit e vitit 2001, nuk kanë përkrahur veprimet e violente kundër shtetit, megjithë zërat dhe shushurimat e dëgjua rreth zbatimit të ngadalshëm të reformave.² Paqja në pjesët e Serbisë jugore të banuara me shqiptarë që gjinden në kufi me Kosovën, momentalisht është e brishtë por e sigurt.³ Oportunitizmi i AKSH-së duket të ketë marrë sinjalin e servuar se ka dështuar në ndezjen e një konflikti më të gjerë; dhe se për momentin nuk është e interesuar të shkojë më tutje për arsye se në muajt e fundit, shumica e anëtarëve të sajë udhëheqës janë arrestuar ose presin ekstradimin e gjykimeve në instanca të ndryshme.

Por, çështja në aspektin më të gjerë politik mbetet. A ka vërtetë rrezik potencial për konflikte të reja në Ballkan në rast të paraqitjes së agjendës për “Shqipërinë e madhe”, agjendë kjo e ngjajshme me agjendën për “Serbinë e madhe” dhe “Kroacinë e madhe” që si pasojë pati luftën e Bosnjes të viteve 1992-95? Apo, a është krejt kjo përgjegjje definitive për çështjen shqiptare kur kihet parasysh pritja lidhur me statusin e papërcaktuar final të Kosovës? Dhe çfarë masash politike duhet të ndërmerren nga Komuniteti ndërkombëtar për të siguruar stabilitet të përhershëm?

Ata të cilët janë të brengosur për çështjen e pan-Shqiptarizmit, duhet të ndalen dhe analizojnë hartën. Tre milion e gjysmë shqiptarë jetojnë në Shqipëri. Nëntëdhjetë përqind e popullatës dy-milionëshe të Kosovës janë shqiptarë etnik. Numri i shqiptarëve në Maqedoni është më shumë se 500,000, i koncentruar në luginat që kufizojnë atë me Shqipërinë dhe Kosovën dhe gjithashtu në kryeqytetin maqedon, Shkup, janë një përbërje prej 15% e pupullatës së tërësishme maqedonase.⁴ 60,000 shqiptarë të tjerë jetojnë në Mal të Zi,⁵ dhe më konkretisht në Preshevë, Medvegje dhe Bujanovc, komuna këto të Serbisë Jugore.

¹Raport I ICG-së për Ballkanin N°140, *Shqipëria: Shteti i kombit 2003*, 11 Mars, 2003.

²Raport i ICG-së për Ballkanin N°149, *Maqedonia: Nuk ka hapsirë për vetkënaqësi*, 23 tetor, 2003.

³Raport evropian i ICG-së N°152, *Paqja e brishtë në Serbinë jugore*, 9 dhjetor, 2003.

⁴Në pajtim me shifrat zyrtare maqedonase, të publikuara më 1 dhjetor 2003, shqiptarët kanë përbërë 509,083 (25.2%) nga 2,022,547 e popullatës maqedonase. Viti 1994 në regjistrimin e përgjithshëm ka pasur një rezultat prej 442,914 Shqiptarë (22.4%) nga gjithsej 1,936,877.

⁵Rezultatet e regjistrimit të përgjithshëm në Mal të Zi.

Historikisht, gjithashtu ka shqiptarë në Greqi, Itali, Bullgari dhe Turqi dhe natyrisht, kohëve të fundit koncentrimet të shqiptarëve në tërë Evropën Perëndimore.

Shqiptarët në Ballkan janë ndarë në dy grupe të ndara me dy dialekte dhe struktura shoqërore. Ata që jetojnë në ish-Jugosllavi dhe në viset malore të Shqipërisë të njohura si Gegë. Ata që jetojnë në jug të lumit Shkumbin janë Toskë. Pjesa më e madhe e Gegës kanë përkatësi muslimane me rreth 10 përqind të religjionit katolik. Mund të thuhet se 80 përqind e pjesës Toskë kanë origjinë muslimane me rreth 20% të religjionit kristian ortodoks të lindjes. Organizimi tradicional i Gegës ishte i karakterit fisnor, i bazuar në një lidhje të ngushtë klanore që kishte bashkuar pjesë të ndryshme, aktualisht të izoluara dhe kështu është më e shkapërderdhur sesa pjesa e poshtme e quajtur Toskë. Gjuha e shkruar standarde shqipe është e bazuar në dialektet Toskë, por tani Gega është duke jetuar një rilindje letrare.⁶

Ndarjet shqiptarëve, si rrjedhojë e kësaj janë një faktor i dukshëm i cili duhet llogaritur. Rëndësia e perspektivave të ndryshme dhe aspiratave të shqiptarëve me peshë shumë të madhe varet nga koordinimi dhe veprimi i bashkësisë ndërkombëtare lidhur me çështjet e tilla, përderisa ky bashkëveprim do të jetë kyç në pengimin e dhunës e cila është parë mjaft shumë në rajon gjatë dekadës së fundit. Ky raport prezanton një anketë rajonale lidhur me çështjet e ndryshme të lidhura me Shqiptarët si shumicë dhe pakicë në Shqipëri, Kosovë, Serbi Jugore, Maqedoni, Greqi dhe Mal të Zi si dhe analizon një historik të shkurtër lidhur me Armatën

⁶ Gjuha shqipe është një gjuhë indo-evropiane, e përafërt me gjuhën rumune por e dalluar nga ajo, dhe shumë më e largët sesa gjuha greke dhe gjuhët e tjera sllave që fliten në Ballkan nga fqinjët e tyre. Ekzistojnë ndryshime gramatikore ndërmjet të dialekteve Gegë dhe Toskë, ndonëse heshturazi mund të thuhet se ato janë gjithëpërfshirëse. Gjuha letrare e bazuar në Toskë erdhi me shpalljen e sajë si të tillë nga qeveria e atëherëshme komuniste nga pjesa Toskë. Në anën tjetër pjesa Gegë ka argumentuar se dialekti i tyre është sakrifikuar në favor të apetiteve të regjimit të atëherëshëm Stalinist për të dominuar pjesën tjetër si ekonomikisht ashtu edhe në aspektin kulturor përderisa gjatë luftës së dytë botërore pjesa gegë edhe në Shqipëri edhe në Jugosllavi ishte jashtëzakonisht anti-komuniste. Që prej shkatërrimit të komunizmit në Shqipëri më 1991, janë paraqitur një numër iniciativash akademike me qëllim të ri-definimit të dialektit gegë për barazi në gjuhën standarde shqipe. Kjo ka rezultuar në ringjalljen e letërsisë në pjesën Gegë të publikuar nga puna e një numri shkrimtarësh deri atëherë të shtypur nga pjesa Gegë.

Kombëtare Shqiptare- lëvizja e vetme ushtarake shqiptare e rëndësishme në kohët e fundit që ka paraqitur në agjendën e sajë hapurazi çështjen politike pan-shqiptare. Një fokusim i konsiderueshëm i është dhënë gjithashtu rrënjës historike “të pan-Shqiptarizmit”, në diasporën shqiptare në Evropë dhe Amerikën Veriore dhe shpesh brengën e zëshme për atë se si shkalla e lindjes tek shqiptarët është përdorur për ndryshimin e përbërjes dhe pamjes së Ballkanit.

A. BARRA E HISTORISË

Në vend të referimit në “pan-Shqiptarizëm”, Shqiptarët kanë për qëllim që të përdorin një frazë “çështja e pazgjidhur kombëtare shqiptare”, të cilën frazë, Akademia e shkencës e Shqipërisë përmes një dokumenti kontraverz, më 1998 e interpretoi si “Lëvizja për çlirimin e tokave shqiptare nga okupatorët e huaj dhe bashkimi i tyre në një shtet të vetëm kombëtar”.⁷ Ndonëse ky do të ishte objektivi maksimal i programit nacional, ky njëkohsisht mbetet më shumë mitik sesa praktik për shumicën e shqiptarëve të cilët pranojnë se një aspiratë e tillë është krejtësisht kontradiktore me një realitet tjetër të gjeopolitikës bashkëkohore. Intelektuali shqiptar Fatos Lubonja pohon, “ëndërra e shqiptarëve që një ditë të bashkohen ka qenë pjesë e ndërëgjegjëjes së tyre kolektive pa kaluar kjo në programin politik sepse shqiptarët gjithëmonë kanë qenë të dobët.”⁸ Të tjerët, iniciativat pan-shqiptare kulturore ose ekonomike i shohin si një hap në drejtim të Shqipërisë së madhe ose Kosovës së madhe, por si thjesht pjesë të zhvillimeve në trendin evropian në drejtim të kurajimit për integrim përtej kufinjëve nacional.

Nacionalizmi shqiptar është pak sa më i ndryshëm nga traditat ekspansioniste serbe, kroate ose edhe greke lidhur me pikpamjen e mos-gjenerimit të ideologjisë nga kryeqyteti i shtetit shqiptar. Ndonëse të gjithë shqiptarët tani më i kanë të njohur termet si “pan-Shqiptarizëm”, “Kosovë e madhe” dhe “Shqipëri e madhe”, shumë rrallë dëgjohej ata të përdorin terminologji të tilla. Shqiptarët më shumë tentojnë të nisen nga prespektiva historike ër të parë çështjen si përpjekje kolektive për forcimin e pozitës së shqiptarëve në Ballkanin jugor për

⁷ Platformë për zgjedhjen e çështjes së pazgjidhur shqiptare, Akademia e shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 1998, p. 5.

⁸ Intervistë e radio BBC-së, 25 prill, 2002.

çlirimin e tyre nga shtypja sllave. Nga pikpamja e vëzhguesve të jashtëm, kjo pikënisje e tyre referimi mund të paraqes qëndrim të vendosur dhe plan strategjik për bashkimin e territoreve të ndara. Për shqiptarët, sidoqoftë, këto territore nuk janë të ndara –ato të gjitha janë Shqipëri-megjithëse të ndara në njësi të ndryshme politike me aplikimin e demarkacionit të kufinjëve të Sqhipërisë nga viti 1913 dhe 1921 dhe me shkatërrimin e mëpastajmë të Jugosllavisë dhe vetëm një numër i vogël i tyre përkrahin idenë e tërheqjes ose prishjes së kufinjëve.

Përkrahja për pan-Shqiptarizmin kurr nuk ka qenë e fuqishme brenda përbrenda vet Shqipërisë. Për dallim nga qytetet si Beogradi dhe Athina, zotërimi territorial i të cilave është rritur në mënyrë të vazhdueshme në mes të periudhës nga fillimi i shekullit nëntëmbëdhjetë e deri tek mesi i shekullit të njëzet, Tirana u bë kryeqytet i një shteti të pavarur gati krejt aksidentalisht më 1912; dhe një përfshirje e shkurtër ndodhi më 1940 nën okupimin italian. Qeveria aktuale socialiste udhëheqëse në Tiranë ashtu si edhe të gjitha rrymat e partive politike edhe në pozitë edhe në opozitë në Shqipëri, kundërshtojnë çdo lloj bashkimi politik të territoreve të banuara më shqiptarë. Paskal Milo, i cili ka shërbyer si ministër i punëve të jashtme të Shqipërisë nga viti 1997 deri 2001, ishte vërtetë i lemeritur nga numri shumë i madh i pyetjeve të të huajve lidhur me çështjen e Shqipërisë së madhe për ç'arsye ai është detyruar që të shkruaj një broshurë për të hedhur poshtë idenë se dëshira për Shqipërinë e madhe ekziston në qarqet qendrore të rrymave politike në Shqipëri, Kosovë ose Maqedoni.⁹

Disa prononcime publike të figurave udhëheqëse në Shqipëri në favor të ri-shqyrtimit të çështjes së kufinjëve shpejt e shpejt janë mohur nga pjesa më e madhe e përbërësve të subjekteve politike. Gjithashtu qarqet kryesore të partive politike në Kosovë koncentrohen në pavarimin e provincës së tyre më shumë sesa në bashkimin me Shqipërinë, dhe partitë politike shqiptare në Mal të Zi favorizojnë pavarësinë e asaj republike pa ndryshimin e kufinjëve. Në zgjedhjet e shtatorit në Maqedoni të vitit 2001, përderisa partitë kanë përkrahur një lloj të pan-Shqiptarizmit me të cilën frazë kan arritur të shënojnë një sukses, pjesa dërmuese e shumicës shqiptare etnike kanë hedhur

poshtë politikat e tyre për të favorizuar një agjendë integrimi në favor të marrëveshjes paqësore të Ohrit. Sidoqoftë, përderisa atje të ketë mbetur një numër i vogël militantësh që pohojnë se do të luftojnë për një “Shqipëri të madhe”, pa marrë parasyh sa i vogël është niveli i përkrahjes në popullatë, fqinjët e Shqipërisë mbesin të dyshimt dhe i frigohen pasojave të tmerrëshme të një ekspansionizmi shqiptar ose krijimit të çdarëdo shteti të ri ose zgjerimi të shtetit shqiptar.

Çdo kuptim i “zgjimit kombëtar” në mesin e shqiptarëve është një fenomen historik relativisht i freskët. Heroi i madh historik i shqiptarëve është Gjergj Kastrioti – ose Skendërbeu – statuja e të cilit mund të gjindet në shumë qytete shqiptare. Skendërbeu në fillim luftoi për Perandorinë Osmane në vitet 1440, para lëvizjes besnike për bashkimin e prijësve shqiptar në rezistencë kundër turqëve. Apeli i një figure të tillë historike si Skendërbeu ishte i qartë për Shqiptarët etnik. Akti i tij heroik dhe aftësia për të bërë bashkimin e shqiptarëve qëndron plotësisht në kontrast me historinë e zymtë përgjithësisht të shqiptarëve. Ashtu sikurse fqinjët ata i dhanë fund pesë shekujve sundim nga Perandoria Osmane; dhe në dekadat e fundit, shteti shqiptar ishte udhëhequr nga diktatura më e vrazhdë komuniste, i ndarë nga pjesët fqinje të banuara me shqiptarë nën dominimin jugosllav. Nuk ka dyshim se faktet historike të një qëndrese të tillë dhe prijësi të tillë siç ishte Skendërbeu, i cili arriti të bashkojë dhe të inspirojë klane të ndryshme për të bërë luftë për sovranitetin e shqiptarëve janë vlerësuar si shumë positive edhe tani pas 500 viteve.

Me gjithë rezistencën e Skendërbeut, në gjysmën e dytë të viteve 1400, Perandoria Osmane ka pushtuar dhe ndarë tokat shqiptare dhe si rrjedhojë, shumë shqiptarë kanë marrur besimin islamik. Më tutje, shumë shqiptarë i kanë shikuar otomanët si mburojë dhe mjet për luftë kundër sllavëve në veri dhe grekëve në jug, dhe kjo sollti deri tek kurajimi për identifikim të përgjithshëm me Perandorinë Otomane më shumë sesa me identifikimin e vençant shqiptar. Si shtesë, dhe ndryshe prej shumë fqinjëve, shqiptarët nuk ushqehen shumë me kujtimet për perandorinë shqiptare.

Aty nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, një ndjenjë e fortë për identitet nacional filloi të përhapet në mesin e shqiptarëve, e ndikuar nga “Krizat e lindjes” së viteve 1875-1878. Pas kryengritjeve në Hercegovinë, Bosnje dhe Bullgari, më 1878, nënshkrimi i traktatit rus të Shën Stefanit i bashkangjiti shteteve sllave shumë territore të

⁹ Paskal Milo, Shqipëria e madhe – Në mes të fiksacionit dhe realitetit, Tiranë: 2001.

banuara me shqiptarë. Marrëveshja kishte bashkuar 300 lider shqiptarë nga tërë Ballkani që të protestojnë në Prizren, Kosovë. Duke shpallur themelimin e Lidhjes së Prizrenit ata kundërshtuan copëtimin e territoreve të banuara me shqiptarë dhe kërkuan nga Fuqitë e Mëdha që të detyrojnë autoritetet turke që të bashkojnë katër regjionet: Kosovë, Shkodër, Manastir dhe Janinë në një njësi territoriale politiko-administrative brenda Perandorisë Osmane.¹⁰ Peticioni kishte paraqitur për të parën herë shushurimën e parë për bashkim territorial por kjo kërkesë ishte hedhur poshtë nga Kongresi i Berlinit ii korrikut të vitit 1878 (il cili sidoqoftë I ktheu tokat e banuara me shqiptarë nën kontrollin osman në vend të atij sllav). Bismarck kishte komentuar bujshëm se Shqipëria ishte vetëm një koncept gjeografik, dhe se nuk kishte diçka që kishte të bënte me kombin shqiptar.

Në dekadat e mëvonëshme në mënyrë shumë më të hapur shqiptarët filluan të acarohen me perandorinë osmane si rezultat i përpjekjeve të udhëheqësve turq që të asimilojnë popullatën shqiptare dhe si rezultat I kundërshtimit të vazhdueshëm të nacionalitetit shqiptar. Në konferencën e Londrës së viteve 1912-1913, të mbajtur në vigjilie të luftës së parë Ballkanike, fuqitë e mëdha u pajtuan të përkrahin krijimin e një Shqipërie të pavarur me një popullsi prej 850,000, por caktuan kufinj të asaj që sot quhet Kosovë, t'i takonin Serbisë dhe Malit të Zi.¹¹ Kufiri ishte ndryshuar prap, edhe njëherë në dëm të shqiptarëve, në nëtor të vitit 1921, në vigjilie të luftës së parë botërore.

Në ndërkohë, në nëntor të vitit 1918, një grup i politikanëve kosovarë me veprim në ekzil kanë themeluar Komitetin për Mbrojtjen e Kosovës i cili kishte zhvilluar fushatë kundër caktimit të kufinjëve në Konferencën e Londrës me ç'rast kërkuar çlirimin e Kosovës, dhe për herë të parë krijimin e një shteti i cili do të bashkonte të gjitha tokat e banuara me shqiptarë.¹² Kufinj të Shqipërisë së vitit 1921, kishin lënë gati gjysmën e popullit jasht, popullatë kjo identiteti i cë cilës me

të drejtë është karakterizuar si "Shqiptarë" jasht shtetit shqiptar. Gati një gjysmë milioni shqiptarë ishin banorë të Mbretërisë serbe –kroate dhe sllovene dhe rreth 70,000 ishin vendosur në Greqi. Duket qartë se shqiptarët, etnik nuk ishin të vetmit thellësisht të pakënaqur me rivizatimin dhe ricaktimin e kufinjëve nga ana e Evropës pas luftës së dytë botërore, dhe si rrjedhojë një shqetësim dhe trazirë e vazhdueshme ka filluar si shkak i ri-konfigurimit të hartës së kontinentit për dekadat që pasuan. Kjo ka bërë të ditur, se kufinj të caktuar nga Fuqitë e Mëdha e kanë lënë Shqipërinë ashtu siç ka thënë një komandant "nga të gjitha këndvështrimet, shtetin më të prapambetur në Evropë."¹³ Ushtu si VMRO-ja maqedonase si dhe lëvizja ustashe kroate, Komiteti për Kosovën mori ca përkrahje nga Italia, përkrahje kjo si pjesë e strategjisë së përgjithshme të Romës për destabilizimin e mbretërisë me qendër në Beograd. Sidoqoftë, një grup i tillë është mposhtur ushtarakisht në vitin 1924, dhe Ahmet Zogu (më pas, mbreti Zogu), i cili erdhi në fuqi me ndihmën e Beogradit i cili mbeti në pushtet deri sa Shqipëria iu aneksua Italisë në vitin 1938.

Nacionalizmi shqiptar e ngriti kokën prap gjatë luftës së dytë botërore. Gjatë okupimit italoanogjerman ka ekzistuar vërtetë një formë e "Shqipërisë së madhe" për katër vite me radhë gjatë luftës. Pjesë të Kosovës dhe të territoreve të banuara me shqiptarë të Maqedonisë Perëndimore ishin bashkuar me Shqipërinë nën pushtimin Italian.¹⁴ Në vet Shqipërinë, dy grupe rezistuese, grupi i dominuar nga Toska, Fronti Nacional Çlirimtar komunist dhe grupi nationalist kryesisht Gegë- Balli Kombëtar, ishin bindur nga aleatët që të luftojnë për çlirimin e Shqipërisë "etnike", e cila do të përfshinte edhe Kosovën. Më qëllim të bindjes së shqiptarëve, që t'i bashkangjiten luftës kundër fashizmit, komunistët shqiptarë dhe jugosllav, organizuan një konferencë në dhjetorin

¹³ L.S. Stavrianos, Ballkani që prej vitit 1453 (Londër: 1958), p. 731.

¹⁴ Rrethet e Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit, (tani në Kosovë), Tetova, Debari, Kicevo dhe Struga, (tani në Maqedoni), dhe Ulqini, Tuzi, dhe Plava (tani në Mal të Zi) ishin bashkangjitur me pjesën e Shqipërisë nën Italinë, ndonëse prefekturat e Mitrovicës, Vushtrrisë, Gjilanit dhe Podujevës (tani në Kosovë) ishin lënë nën Serbinë e okupuar gjermane. Kështu minierat e pasura të Trepçës mund të eksploatoheshin më shumë nga Berlina sesa nga Roma. Për jugun dhe lindjen, rrethet e Shkupit, Kumanovës dhe Prespës, (tani në Maqedoni), Kaçaniku (tani në Kosovë), dhe Presheva (tani në Serbi) i ishin aneksuar Bullgarisë.

¹⁰ Për detaje lidhur me këtë periudhë kohore shih: Miranda Vickers, *Shqiptarët – Një histori moderne*, I.B.Tauris, 1999. Manastiri tanimë i referohet Bitolës, në Maqedoninë Jugore; Janina në Greqinë veriore cila është shkruar si Ioannina.

¹¹ Siç është vlerësuar nga Komisioni Carnegie – shih faqen e fundit të *Luftat tjera ballkanike*, Carnegie Endowment, 1993 (1913).

¹² Lidhja e mëherëshme e Prizrenit ka kërkuar vetëm autonomin regjionale, unike brenda Perandorisë Osmane.

e vitit 1943, në fshatin Bujan, në kufirin Shqiptaro-Kosovar. Konferenca u përmbyll me përfundimin kryesor se: “mënyra e vetme e arritjes së lirisë është nëse të gjithë popujt do ta kenë mundësinë e vendosjes së fatit të tyre, me të drejtën e vetvendosjes, përfshirë edhe ndarjen”. Komunistët jugosllav e pranuan këtë, si mundësinë e vetme për arritur përkrahjen në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Sidoqoftë, ata e ndërruan politikën në vitin 1945, në Konferencën e Prizrenit, kur një grupacion njerëzish “vendosi”, në emër të Partisë Komuniste të Kosovës, që Kosova të jetë pjesë e Serbisë dhe jo e Shqipërisë. Për këtë shkak, shqiptarët e Kosovës kurr nuk e panë Jugosllavinë si një shtet të cilit lirshëm kanë pranuar t’i bashkohen¹⁵.

Komunistët Shqiptarë dhe Jugosllav besuan se çështja shqiptare mund të zgjidhet miqësisht (paqësisht) pasi që forcat krejsore të ishin mposhtur. Mirëpo, ishte e paevitueshme që shumica e kushteve të vendoseshin nga ana e Jugosllavisë, gjë kjo e cila në Shqipëri solli komunistët në pushtet me Enver Hoxhën në krye, në vitet 1944-45 (sikurse Ahmet Zogu që ishte sjellur në pushtet me anë të intervenimit ushtarak nga ana e Serbisë, dy dekada më herët). Në fakt, Tito, i cili udhëhoqi Jugosllavinë nga Lufta e Dytë Botërore deri në vdekjen e tij, në vitin 1980, fillimisht shpresonte që ta integroj në Jugosllavi jo vetëm Shqipërinë, por edhe Bullgarinë. Sidoqoftë, Tito prishi marrëdhëniet me udhëheqësin Soviet, Jozef Stalinin, në vitin 1948, kështu që kufiri Jugosllavo-Shqiptarë, atëher u mbyll, duke ndarë komunitetin Shqiptar.

Shqiptarët në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi janë klasifikuar në mesin e grupeve të shumta të minoriteteve në Jugosllavi dhe kanë vuajtur nga diskriminimi i vazhdueshëm, në fushat e gjuhës, fesë (besimit) dhe qasjes në mundësitë e shkollimit. Vetë Shqipëria ishte udhëhequr nga Enver Hoxha, deri në vdekjen e tij në vitin 1985 dhe gjatë pushtetit të tij, Shqipëria u bë njëri ndër regjimet komuniste më të izoluar dhe represive në botë. Shqipëria mbeti e dobët, e prapambetur, skajshmërisht e varfër dhe e injoruar me të madhe nga Bashkësia Ndërkombëtare.

Izolimi i Shqipërisë nën komunizëm, statusi i pa zgjidhur i rajoneve të banuara me Shqipëtarë, në ish Jugosllavi dhe mungesa e përgjithshme e shpresës, ishin këto që ndrydhën ndjenjat mbarë Shqiptare në shekullin XX.

B. PAS RËNIES: KAOSI DHE ASPIRATAT E REJA

Rënja e Bashkimit Sovjetik dhe nryshimet dramatike që, rrjedhimisht, përshkruan Evropën Qendrore dhe Lindore, ringjallen “çështjen Shqiptare”, në atë mënyrë që pak kush do të mund t’a parashihte. Në tërë Ballkanin, aplikimi i komunizmit solli deri tek prodhimi masiv i hartave, që tregonin bazat “historike” dhe “etnike” për aspiratat territoriale të grupeve ekstremiste, që i përkisnin njëres apo kombësisë tjetër. Hartat Shqiptare të këtij lloji, tregojnë “Shqipërinë e Madhe”- ose “Shqipërinë Etnike” siq preferojnë t’a quajnë Shqiptarët- që përbënin shtetin Shqiptar së bashku me Kosovën, Maqedoninë Perëndimore, Malin e Zi Jug-lindor dhe rajonin e Epirit të Greqisë, i njohur për shqiptarët si Qamëri¹⁶. Shqiptarët e Kosovës gjithashtu iu përgjigjen suspendimit të autonomisë së tyre, nga ana e Beogradit, duke zëvendësuar partitë dhe organizatat e tyre të vjetra Marksist-Leniniste, me entitete të reja politike dhe liderë të rinjë. Ndër këto, më e rëndësishmja ishte Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova.

Shqiptarët nuk ishin grupi më energjik, për t’a përqaftuar agjendën e “nacionalistit madh” derisa Jugosllavia shpërbëhej. Programi (plani) i Serbisë së Madhe – *Nacertanie*- është përjetësuar me memorandumimin famëkeq të Akadimsë së Shkencave dhe Arteve, në vitin 1986 dhe shërbeu si platformë ideologjike për përpjekjet e Sllobodan Millosheviqit në krijimin e Serbisë së Madhe, duke pastruar etnikisht pjesë të mëdha të territoreve. Në vitin 1990, presidenti Kroat, Franjo Tugjman, gjithashtu përqafoi nocionin “Kroaci e Madhe”, me rezultate të njëjta. Nacionalizmi ekspansionist pati ri-shfaqje edhe në Rumani dhe Greqi dhe dhuna në Jugosllavi duket se ka definuar për botën rrezikun e ri-lindjes së përçarjeve të grupeve etnike të shtypura për një kohë të gjatë gjithandej në shtetet ish-komuniste.

Kur komunizmi kishte kollapsuar në Shqipëri në vitin 1991, Bashkësia Ndërkombëtare më shumë e shpërfillte problemin sesa që ndihmonte zgjidhjen me përfshirjen në të. Paqëruajtësit italian ishin vendosur në Shqipëri nga shtatori i vitit 1991 deri në dhjetor të vitit 1993 si pjesë e të ashtuquajturit *Operation Pelican*. Si Italia ashtu edhe Greqia

kishin shprehur një padurim ndaj vërshimit të refugjatëve nga Shqipëria dhe një ndihmë me furnizime humanitare ishte derdhur në vendin, aktualisht të katandisur si jo më keq nga varfëria. Politikisht, sido që të jetë Shqipëria ishte injoruar mjaft shumë nga Bashkësia Ndërkombëtare me ç'rast ishte lënë pas dore me mundësitë vetanake të mbijetimit.

Në fillim të viteve 1990, një numër i shqiptarëve të Kosovës të cilët ishin krijues të opinioneve për zhvillimet e përgjithshme kishin filluar të argumentojnë dhe të flasin hapur se si të gjitha "territoret etnike" do të duhej të përfshiheshin brenda kufinjëve të Shqipërisë atëherë kur ajo ishte krijuar më 1912. Kjo pakënaqësi e re e fashitur si flaka e mbajtur me prush përbrenda ishte nxitur nga politika e ashpër e udhëhequr nga Beogradi kundrejt minoritetit shqiptar.¹⁵ Kjo ka shkatuar paraqitje të situatave zhvillimesh të tjera të rëndësishme në rajon me ç'rast u paraqit një radikalizëm në rritje në diaporën thënë Kosovare në SHBA, Gjermani dhe Zvicërr. Kur filloi dezintegrimi i Jugosllavisë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e përbërë nga elita politike e shqiptarëve të Kosovës u paraqit në Konferencën e Komisionit Evropian të vitit 1992 lidhur me Jugosllavinë. Cfarëdo që të ishte zëri politik i shqiptarëve të Kosovës, ai vullnet për ngritje të zërit u ndje shumë shpejt i frustruar pasi që përfaqësuesit shqiptarë ishin vendosur në një dhomë të ndarë të ndërtesës së konferencës ku krejt ngjarja me të cilën ata kishin qenë të ndërlidhur ishte një qasje për përcjelljen e konferencës në një monitor.¹⁶ Shqiptarët e Kosovës u ndjenë shumë të fyer nga kjo ngjarje. Si rezultat, në vitin 1993, u themelua Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), si dhe grupe të tjera si Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK), filluan të rriten.

Shpresat e Shqiptarëve të Jugosllavisë filluan të shëndërrohen në një qëndrim të vendosur në dhjetor të vitit 1992, atëherë kur presidenti i parë Bush, në dhjetor të vitit 1992, në javët e tij të fundit të qëndrimit të tij në zyrën e presidentit dha deklaratën e cila u bë e njohur si "Paralajmërim

për Krisht", me ç'rast i ishte thënë Millosheviçit se SHBA ishte e gatshme që të angazhonte forcat ushtarake kundër Serbisë dhe pasurisë së saj" në rast se veprimet serbe do të provokonin konfliktin në Kosovë.¹⁷ Sidoqoftë Kosova ishte lënë gati tërësisht jashtë nga agjenda e Konferencës së Paqes së Dejtonit të vitit 1995 e cila i kishte dhënë fund konfliktit në Bosnje. Shqiptarët, vërtetë nuk ishin konsideruar lojtarë të rëndësishëm të lojës që luhej atëherë në Ballkan. Këto zhvillime i kishin lënë shqiptarët e Kosovës në mëshirën e një ndjenje fyese e cila në mënyrë të drejtëpërdrejtë kishte kontribuar në radikalizimin e vazhdueshëm të kërkesave të popullatës.

Në Mars të vitit 1997, ishte bërë një kthesë e madhe në Shqipëri, ajo që detyroi botën të kthente vëmendjen nga Shqipëria. Pas kollapsit të serive të skemave piramidale bankare në Shqipëri, disa javë trazirash bënë që të binte krahu i djathtë i qeverisë së Sali Berishës. Gjatë kësaj periudhe, ishte shkatërruar komplet rendi dhe ligji, arsenale të tëra ushtarake brenda shtetit shqiptar dhe vendi si dhe si dhe fqinjët e tij ishin vërshuar me shumë se gjysmë milioni armë të plaçkitura. Një forcë ndërkombëtare e përbërë prej tetë shteteve evropiane kishin arritur në Shqipëri në prill të vitit 1997, me qëllim të ri-vendosjes së rendit dhe se në atë kohë, pas zgjedhjeve parlamentare të qershorit, pushtetin e mori Partia Socialiste.

Në ndërkohë, në popullatën shqiptare të Kosovës ishte rritur thellësisht ndjenja e frustrimit nga mungesa e suksesit të rezistencës politike jo-violente të ushtruar nga lidershipi i Ibrahim Rugovës. Anarkia në Shqipëri furnizoi themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me armë dhe me hapsirë në pjesën e pa-qeverisur të Shqipërisë Veriore për ushtrime të forcës guerile. Në vitin 1998, shpërtheu konflikti i hapur në mes të UÇK-së dhe forcave të sigurisë jugosllave.¹⁸

UÇK-ja është kuptuar nga shumë qarqe si idhtarë e Shqipërisë së madhe. Në korrik të vitit 1998, zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqi publikisht deklaroi se qëllimi i UÇK-së është bashkimi i të gjitha territoreve të banuara me

¹⁵ Pasi shfuqizimit të statusit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, puntorët shqiptarë duke përfshirë shërbimet shëndetësore dhe mësuesit ishin përjashtuar nga vendet e tyre të punës. Një politikë e serbizimit në kulturë dhe sistem arsimor kishte përshkuar provincën të kulturës dhe një numër i madh i ushtarëve të armatosur jugosllav kishte filluar të patrollojnë nëpër rrugët e Kosovës.

¹⁶ Intervistat e ICG-së me zyrtarë të LDK-së, Londër, 1992.

¹⁷ Shih Tim Judah, *Kosovo: Lufta dhe hakmarrja*, Yale University Press, 2000, pp. 73-4.

¹⁸ ICG-ja raportoi lidhur me zhvillimin: shih raportin e ICG-së për *Kosovën*, 17 shkurt, 1998, and ICG Briefing, *Kosovo Crisis Key Issues*, 12 tetor 1998.

shqiptarë.¹⁹ Në natën e Vitit të Ri - 1998, përderisa në televizionin kombëtar shqiptar, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së apeloj që “vitet 1988-1999 të jenë vite të bashkimit të shqiptarëve dhe vite të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës”.²⁰

Përderisa lufta në Kosovë kishte eskaluar edhe më shumë në vitin 1999, me ç’rast po rritej numri i vërshimit të refugjatëve nga Kosova në Shqipëri dhe Maqedoni, NATO filloi operacionet ushtarake kundër qeverisë së Millosheviqit. Në qershor të vitit 1999, Milosheviq ishte detyruar që të pranoj, afatin për dhënien fund të konfliktit në Kosovë, nën mbikqyrjen një numri të madh të ushtarëve të forcave paqëruajtëse të NATO-s me ç’rast u vendos një protektorat ndërkombëtar me statusin final politik ende të pazgjidhur.

UÇK-ja është shkatërruar edhe zyrtarisht pas konfliktit të vitit 1999. Por, shumë nga anëtarët e sajë kanë ardhur në përfundim se nëse luftimet do të vazhdonin në Luginën e Preshevës së Serbisë Jugore në mes të shqiptarëve etnik dhe serbëve etnik, NATO do të duhej edhe njëherë të vinte deri tek shpëtimi dhe lirimi i Preshevës nga kontrolli Serb, duke i aneksuar këtë pjesë Kosovës së administruar nga OKB-ja. Ata ishin gabuar. Pas rënies së Sllobodan Millosheviqit në tetor të vitit 2000, dhe zëvendësimit të tij me Qeverinë e re në Beograd, Përdimimi u përpoq që të ndërtonte një marrëdhënie të re positive me Serbinë, dhe se përgjithësisht konflikti në Preshevë në esencë ishte zgjidhur sipas kushteve të palës në Beograd. NATO bëri të qartë se ajo nuk kishte për qëllim ridefinimin e kufinjëve dhe se provokacionet ushtarake nga ana e grupeve militante shqiptare do të trajtoheshin si kërcënim direkt i sigurisë.²¹

Në mënyrë të ngjajshme, gjatë vitit 2001, kryengritësit shqiptar etnik në Maqedoni ishin përballur me përpjekjet e vazhdueshme të Unionit Evropian dhe SHBA-ve të ndërmjetësojnë në arritjen e një marrëveshjeje lidhur me të drejtat e shqiptarëve etnik në mes të shqiptarëve etnik dhe qeverisë maqedone brenda kufinjëve ekzistues të Maqedonisë. Lënja pas dore e brengave legjitime lidhur me të drejtat kulturore dhe arsimore ka

shpjer deri tek përkrahja e verpimeve ushtarake nga disa qarae brenda komunitetit Maqedono-shqiptar. Lidhjet e qarta në mes të militantëve shqiptarë të Luginës së Preshevës dhe në Maqedoni me strukturat e ish-UÇK-së së Kosovës kanë bërë shumë vëzhgues të ngjarjeve të shprehin frigën lidhur me ardhjen në shprehje të ambicjeve dhe qëllimeve më të gjera të shqiptarëve në ish – Jugosllavi.²² Një hisorian i dalluar e paraqet nacionalizmin shqiptar si ideologjinë e vetme të fundit të lëvizjes ekspansioniste në rajon.²³

Sodoqoftë, justifikimi moral për çfarëdo lloj fushate që do të përmbante dhunë tani më në masë të madhe ishte zhdukur – me largimin e kontrollit të Beogradit ndaj Kosovës, Planin i Coviqit për Serbinë Jugore, si dhe Marrëveshjen e Ohrit në Maqedoni, veprime këto të cilat janë duke iu ofruar shqiptarëve që jetojnë jasht Shqipërisë perspektiva të reja pa bërë ndërrimin e kufinjëve. Konteksti i integritit evropian tani ka potencialin e ndryshimit të dinamikës së politikës në gjithë rajonin. Nëse, dhe kur shtetet e rajonit t’i jenë bashkangjitur Unionit Evropian, shqiptarët do të jenë pjesë e strukturës së njëjtë politike për herë të parë që nga vitit 1912, pa ndonjë barrierë ekonomike dhe me liri të plotë lëvizjes. Çështja qëndron në atë se a do të jetë momenti fillimit të këtij procesi mjaft i përmbajtur ndaj çdo veprimi dhe mendimi të zgjidhjes së këtyre çështjeve me mejte të tjera.

²² Veçanërisht për pamjen alarmuese serbe të rrezikëshme shih *Shqipëria – konceptet dhe pasojat e mundëshme*, Instituti për studime gjeopolitike, Beograd, 1998.

²³ “Iredentizmi duket të jetë më i fuqishëm në mes të shqiptarëve në krahasim me shumicën e popujve të Evropës Jug-lindore që prej vitit 1992], ndoshta për arsye se ata ishin të deprivuar nga liria e tyre për një kohë aq të gjatë. ... Referimii i rastësishëm grek lidhur me ‘Epirin Verior’ (p.sh. Shqipëria Jugore), Ëndërrat bullgare për Maqedoninë’, Nostalgjia rumune për Bessarabian dhe Moldavinë tani kanë mbetur pa kuptim dhe jehonë, çështje këto të cilat para një shekulli kishin provokuar lufra të tëra dhe invazione: qarqet politike atje kanë pushuar së gravituari rreth ekspanionizmit dhe lavdisë e krenarisë kombëtare. Kanë mbetur vetëm nacionalistët shqiptarë ata që duhet të braktisin ëndërrat të cilat tanimë janë braktisur nga fqinjët e tyre.”. Mark Mazower, *Ballkani*, Londër: Weidenfeld & Nicolson, 2000, pp. 126, 134-5.

¹⁹ Der Spiegel, N° 28/1998, pp122-123

²⁰ Deklarata politike N°22 e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, rrjeti televiziv i TVSH-së, (Tiranë), 31 dhjetor, 1998

²¹ Shih raportin e ICG-së N°116, *Paqja në Preshevë: Përmirësim i shpejtë dhe zgjidhje afatgjate*, 10 gusht 2001, dhe raportin evropian N°152, *Paqja e brishtë në Serbinë Jugore*, 9 dhjetor 2003.

II. NGRITJA DHE RËNIA E AKSH-SË

Ngjarja për Armatën Kombëtare Shqiptare tregon se sa e vështirë mund të jetë analiza rresh pan-Shqiptarizmit. Ky është një rrëfim i pandrikuar (errët), bazuar në disa vëzhgues që kanë bërë disa raporte të besueshme. Shumë njerëz në Serbi janë të prirur që të zmadhojnë lidhjet e strukturave zyrtare në Kosovë me terrorizmin; partitë opozitare në Maqedoni dëshirojnë që të mbledhin sa më shumë të dhëna lidhur me “dështimin” e Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001, përderisa UNMIK-u, KFOR-i dhe palët qeveritare: ajo maqedone dhe shqiptare të gjitha bashkarisht janë të interesuara të krijojnë një përshtypje se situata në përgjithësi është në kontroll të plotë. Komunikatat për shtyp dhe adresa e internetit e publikuar nga ana e krahut të supozuar politik të AKSH-së janë të dyshimta, kontradiktore dhe ngandonjëherë demonstrativisht të pavërteta. Ato në vazhdim paraqesim një përmbledhje të fakteve të njohura, të mbledhura nga hulumtimet e ICG-së në teren si në Serbi, Kosovë, Maqedoni dhe Bruksel.

Gjatë konfliktit në Maqedoni të vitit 2001, Armata Kombëtare Shqiptare (AKSH) kishte gjasa të jetë formuar nga një grup i vogël njerëzish të besueshëm ‘të nëntokës’ të dalë nga Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK), shumica luftëtarë shqiptarë të udhëhequr nga Ali Ahmeti. AKSH ishte fajësuar për disa incidente të dhunëshme si menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit – sulmi me bombë i Manastirit në gusht, dhe më pastaj sulmi ndaj policisë maqedonase në nëntor – por organizata duket të mos ketë zëdhënës të qartë, dhe strategji jo të qartë dhe të dukshme dhe disa vëzhgues kanë bërë pyetje së mos ky front nuk është thjesht i papranueshëm nga UÇK-ja e Ali Ahmetit, me ç’rast për këtë të fundit supozohet se është shpërndarë për arsye të pjesëmarrjes në procesin e paqes, ose vetëm thjesht ashtu mbulojnë krijuesit e problemeve në Forcat Maqedone të Sigurimit.

Bashkësia Ndërkombëtare ka qenë mjaft e shqetësuar me ç’rast ka paraqitur kërkesën ndaj SHBA-ve që të impononte ndalimin e udhëtimeve për AKSH-në dhe krahun e saj të ashtuquajtur politik, Komitetin Nacional për Çlirimin dhe Mbrojtjen e Tokave Shqiptare (KNÇMTSH) më 4 dhjetor të vitit 2001. Në atë kohë, AKSH-ja lëshoi një komunikatë e cila paraqiste kërcënim për përhapje të konfliktit në janar të vitit 2002, dhe

ishin fajësuar për sulm me armë në drejtim të Shtabit të Përgjithshëm të Ali Ahmetit në Tetovë më 25 mars.²⁴ Me këtë rast, komandantët e UÇK-së diskredituan AKSH-në për përbërje vetëm nga 20 anëtarë, përderisa forcat maqedone të sigurisë mendonin se ajo përbënte bga 100-150; por të dyja palët u pajtuan se ajo nuk ishte e organizuar mirë, nuk paraqiste kërcënim serioz për Maqedoninë, dhe një pjesë e madhe e antarsisë së saj e kishte selinë në Kosovë.²⁵

Në gusht të vitit 2002, dy rezervist ushtarak të Maqedonisë ishin mbytur në një sulm të ngarkuar AKSH-së, dhe në fund të muajit pati gjithashtu edhe një incident të dyshimtë kindapimi. Një javë para zgjedhjeve të shtatorit të vitit 2002, një polic ishte vrarë në një atak në stacionin policor afër Tetovës. Një sulm me granadë mbi parlamentin e ri të zgjedhur në nëntor ishte pohuar të ketë qenë i kryer nga AKSH –ja dhe nga një organizatë tjetër ekstremiste maqedonase. Për të shtuar më shumë konfuzionin, AKSH-ja nuk kishte marrur përgjegjësisë për një sulm tjetër me bombë në Tetovë, po në të njëjtin muaj.

Bashkësia Ndërkombëtare në dhjetor të vitit 2002, dha një sinjal të qartë dhe serioz kundër AKSH-së, me ç’rast autoritetet e UNMIK-ut arrestuan dy persona nga rrethi i Vitisë në Kosovë me akuzat për terrorizëm, përfshirje në një grup terrorist, nxitje të urrejtjes racore dhe posedim ilegal të municionit dhe armëve. Ata kanë qenë arresuar gjatë verës së kaluar, së bashku me një person të tretë i cili ishte liruar në mungesë të të dhënave, dhe me atë rast ky veprim ishte shikuar si një ngadhënjim i përgjithshëm ndaj ekstremistëve. Në të dhënat përshkruese të ngjarjeve të UNMIK-ut lidhur me të arrestuarit thuhej se arrestimi i anëtarëve të AKSH-së ishte indikacioni i parë konkret i aktiviteteve të AKSH-së jashtë Maqedonisë.

AKSH-ja reagoi në fund të vitit 2002 duke shprehur një ofendim publik.²⁶ Komiteti Nacional për Çlirimin dhe Mbrojtjen e tokave shqiptare KNÇMTSH), tani edhe zyrtarisht u bashkua me

²⁴ Organizata ishte gjithashtu e implikuar nga autoritete maqedone lidhur me rastin ende të paqartë të shtatë aziatikëve të vrarë nga policia maqedone me dy mars të vitit 2002.

²⁵ Jolyon Naegle, “Maqedonia: Ish kryengritësit lider bëjnë përpjekje për të çuar vendin përpara”, Radio Evropa e lirë / Radio Liria, 12 prill 2002.

²⁶ Organizata mbikqyrë një faqe të internetit të copëzuar, aktualisht me adresën <http://ëëë.ifrance.com/akshalb/>.

Partinë e Unitetit Kombëtar me seli në Tiranë (PUK) për të formuar Frontin e Bashkimit Kombëtar Shqiptar (FBKSH), të udhëhequr nga persona të padëgjuar më parë: “Valdet Vardari”, “Alban Vjosa” dhe “Vigan Gradica”.²⁷ Agjenda e AKSH-së dhe FBKSH ishte thjesht ribashkimi i të gjitha teritoreve shqiptare në një shtet të vetëm. Ata argumentuan se marrëveshjet që u bënë pas konflikteve në rajon (aluduar në planin e Qoviqit dhe Marrëveshjen e Ohrit të dyja të nënshkruara në vitin 2001, pas përfundimeve të konflikteve në Serbinë Jugore dhe në Maqedoni) nuk kishin treguar rezultate të kënaqëshme kështu që parashikuan që viti 2003 të “shënonte një fazë vendimtare për ri-bashkimin e të gjitha trojeve etnike të banuara me shqiptarë në një shtet shqiptar në Ballkan për të cilin është pritur një kohë shumë të gjatë.”²⁸

“Vardari” dhe “Vjosa” iu dhanë një numër intervistash mediave në gjuhën shqipe në fillim të vitit 2003, dhe në shkurt pati një seri incidentesh në rrethinën e Bujanofcit, në Serbinë Jugore. Ndonëse jo të gjitha këto incidente janë pohuar të jenë shkaktuar nga AKSH-ja, ekzistonin gjithashtu thashetheme se organizata ishte aktive në Kosovën Jugore dhe Lindore si dhe në një sulm që ishte kryer në Maqedoninë Jug-perëndimore, qyteti i Strugës për të cilin marrja e përgjegjësisë ishte shumë konfuze. Ekzistonte një zbrapje e Organizatës në mars, me dy njerëz të vrarë nga policia serbe në Bujanofc të cilët ishin duke kurdisur një bombë, si dhe me disa të tjerë të arrestuar nga autoritet kosovare.²⁹

Incidenti më alarmues që ndodhi në gjashtmuajorin e parë të vitit 2003 – dhe veprimi i parë violent në Kosovë –ndodhi në Zveçan më 12 prill, atëherë kur dy anëtarë të AKSH-së ishin vrarë derisa po bënin përpjekje të hedhnin në erë një hekurudhë

²⁷ Këta tre emra u shëndërruan në pseudonime; shih më poshtë.

²⁸ Shih: “AKSH-ja paralajmëron një ‘Verë të nxehtë’ në rajon”, KosovaLive, 27 dhjetor, 2002, marrë nga një intervistë e cila duket të ketë qenë intervista e parë e gjerë e realizuar me përfaqësues të ANA-së

²⁹ Militanti nga Lugina e Preshevës Shefqet Musliu, që u arrestua nga forcat e KFOR-it në prill të vitit 2003, dhe që ende gjendet në arrest në Kosovë, ka kundërshtuar përfshirjen e tij në AKSH dhe nga ana tjetër edhe AKSH kishte kundërshtuar se ai ishte njëri nga anëtarët e sajë. Megjithatë, burime të policisë së UNMIK-ut i kishin thënë ICG-së në nëntor të vitit 2003, se ata kishin vërejtur një lidhje në mes të AKSH-së dhe të ish- UÇPMB-së.

kyçe që lidhte Kosovën me Serbinë. Të dy personat e vrarë ndodhën të kenë qenë pjestarë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Kjo pati për rrjedhojë fillimin e investigimeve të menjëherëshme lidhur me lidhjet në mes të pjestarëve zyrtarisht të sanksionuar të TMK-së nga njëra anë dhe AKSH-së nga ana tjetër, me ç’rast kjo ë fundit është shpallur si terroriste nga Përfaqësuesi Special i Kombeve të Bashkuara në Kosovë Michael Steiner. Sanksionet e SHBA-ve kundër AKSH-së ishin intensifikuar dhe ato kishin arritur të përfshijnë edhe FBKSH-në.³⁰ Disa muaj pas instalimit të bombës në vijën-hekurudhore të urës ishte konkluduar se duhej intensifikuar përpjekjet për të ngritur fonde në emër të AKSH-së. Burimet e Policisë raportuan raste të rrëmbimeve nëpër tërë Kosovën. Mbetet e paqartë se sa nga këto veprime ishin vërtetë të kryera nga AKSH-ja kur dihet se ajo ishte në kundërshtim me adoptimin e kriminelëve dhe etiketimin e vet AKSH-së. Shpesh, vihej në pah përpjekja për krijimin e rrejtit raketor mbrojtës për kërkimin e një identiteti të ri.³¹ Mbishkrime të AKSH-së tani më ishin përhapur gjithandej Kosovës, veçanërisht duke u bërë të adhuruar në mbishkrimet e tabelave të autobusëve të vendeve rurale.³²

Tani më sekreti ishte hapur lidhur me identitetin e vërtetë të lidershit të FBKSH-së, kështu me sa duket edhe të AKSH-së, dhe se ata ishin: Gafurr Adili (“Valdet Vardari”), ish shoqëruar is Ali Ahmetit nga Kışeva e Maqedonisë;³³ ish gjenerali i

³⁰ SHBA-ja apriori nuk mundi të përcjell linjën e UNMIK-ut në deklarim se AKSH-ja është “organizatë terroriste” sepse aktivitetet e saj nuk janë të drejtuara në mënyrë eksplicite kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

³¹ Intervistat e ICG-së, Prishtinë, nëntor, 2003.

³² Në disa zona termi AKSH ishte alternues me “Ukshin Hotin”, një profesor i filozofisë së Univerzitetit të Prishtinës dhe lider i partisë UNIKOMB-it, e cila përkrahte qëndrimin e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Një gjykatë serbe e kishte burgosur Hotin më 1994, me akuzë të shkeljes së rendit kushtetues. Ai ishte rrëmbyer nga burgu i Dubravës në Kosovë nga rojet serbe të burgut në maj të vitit 1999, gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s për të mos u parë më kurrë. Mbishkrimet ishin vendosur për të paraqitur AKSH-në si një shoqatë që përbënte intelektualët me qëndrime të rrepta të një kualiteti enigmatik i cili do të kishte qarkulluar në rrethin Hoti nga i cili rreth ishte ai. Hoti ishte shkëputur dhe marrë që heret për t’u zhdukur në mënyrë misterioze dhe për të mos ditur asgjë për fatin e tij.

³³ Në mënyrë mjaft interesante, në intervistën e dhënë më 27 dhjetor të vitit 2002 në KosovaLive, “Valdet Vardari”

Armatës Shqiptare Spiro Butka (“Vigan Gradica”); dhe Idajet Beqiri (“Alban Vjosa”). Beqiri kishte qenë lider për disa vite i një partie shumë të vogël - Partia e Unitetit Komëtar në Shqipëri. Nën dyshimin për kërcënim ndaj Presidentit të atëhershëm Z. Berisha, ai ishte arrestuar dhe burgosur për gjashtë muaj në vitin 1993-1994. Po ashtu nën dyshimin e keqpërdorimit të pozitës derisa kishte punuar si gjykatës në vitet e 80-ta,³⁴ ai burgoset prapë, ku pas kolapsit të qeverisë së Berishës në vitin 1997 dënimi ndaj tij anulohet. Që ajo kohë, Beqiri ka nënshtetësi Belge

Gjatë muajve në vazhdim, më shumë janë vërejtur të ndodhin arrestime dhe procese gjyqësore ndaj anëtarëve të dyshuar se i takonin AKSH-së në Maqedoni dhe Kosovë sesa incidente përgjegjësitë e të cilave do t'i ishin mveshur kësaj organizate. Kjo gjendje arriti kulmin kur, Gafurr Adili, të cilit në mars i ishte ndaluar hyrja në Shqipëri, u arrestua më 1 korrik të vitit 2003 nga Policia Shqiptare në aeroportin e Tiranës pas hyrjes ilegale nga shteti i Maqedonisë. Ai dhe kolegu i tij ishin akuzuar për posedim të dokumentacionit të falsifikuar, kalim ilegal të kufirit, nxitje të urrejtjes ndër-etnike dhe krijim të organizatave terroriste. Ky veprim ishte veprimi i parë i dukshëm i forcave të sigurisë dhe autoriteteve shqiptare kundër AKSH-së. Muaji tjetër, ai i korrikut ishte relativisht i qetë.

Sidoqoftë, gushti i vitit 2003, shënoi një rritje të dukshme të dhunës. Viktimat përfshinë civil serb dhe pjestarë të Policisë ndërkombëtare në Kosovë si dhe civil shqiptarë dhe pjestarë të forcave serbe të sigurimit të Serbisë Jugore. Kah fundi i muajit, një incident kindapimi që kishte ndodhur në Maqedoni i kryer nga Avdyl Jakupi (“Komandant Çakalla”), i cili kishte puhuar të jetë lider i AKSH-së, dhe bashkpunëtori i tij Hamdi Bajrami (“Komandant Breza”), ka shpjer deri tek operacioni masovik i sigurimit më 7 shtator, në të cilin dy nga përkrahësit e Brezas ishin vrarë.

Beqiri, sidoqoftë i mohoi ICG-së që Çakalla dhe Breza të ishin antarë të AKSH-së dhe i përshkroi ata si “element kriminal dhe jo-patriot”.³⁵

Problemet e tij me këtë rast filluan të shtoheshin, pasi që Shqipëria lëshoi një fletë-arrest ndërkombëtar për të me akuzë për nxitje të urrejtjes religjioze dhe ndër-etnike, dhe se për më shumë të dyshuar të tjerë se i takonin AKSH-së, ishin burgosur në Kosovë nga KFOR-i.

Asnjë incident nuk ishte shkaktuar për një kohë që nga sulmi në patrullën serbe të policisë afër Bujanovcit më 24 shtator, 2003. Gafurr Adili ishte dënua në gjykatoren e Tiranës në nëntor, por i liruar me kusht për zhvillimin e procedurës hetimore, dhe ai mbetet në Tiranë por lëvizjet e tij janë të kufizuara pasi që ai nuk posedon dokumente valide të udhëtimit. Idajet Beqiri ishte arrestuar nga një fletë arrest i shpallur shqiptaro-ndërkombëtar derisa po kalonte nga Gjermania në Zvicërr më 16 dhjetor dhe edhe tani gjindet në arrest në Konstanz. Edhe autoritetet zviceriane kanë paralajmëruar se kanë arrestuar njërin prej njerëzve të rëndësishëm të ngritjes së fondit për AKSH-në, më 28 janar 2004. Një çështje e tillë tanimë duket të jetë e përfunduar.

Vazhdon të mbetet natyrisht rreziku që vjen nga grupet e vogla. Në nëntor të vitit 2003, Çakalla dhe një kolegë i tij kishin publikuar një letër të hapur për të paralajmëruar formimin e “Njësitit të vdekjes”, me ç'rast akuzuan Ali Ahmetin dhe DUI-në për tradhëti ndaj interesave të shqiptarëve në Maqedoni. Ata e përshkruan AKSH-në si një zbulim të Ali Ahmetit dhe kryeministrit maqedon Branko Crvenkovski. Sidoqoftë, kjo iniciativë nuk ishte jetë gjatë; Çakalla dhe kolegu i tij ishin rrethuar dhe zënë nga KFOR-i më 30 janar, 2004, dhe tani gjinden në arrest të Policisë së UNMIK-ut përderisa kërkesa maqedone për ekstradimin e tij për momentin është duke u shqyrtuar.

Pse AKSH-ja dështoi në ndezjen e konfliktit në kontrast me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) më 1997-98, Ushtrinë Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc (UÇPMB) në vitet 2000-2001, dhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) në Maqedoni në vitin 2001. Konspiracioni i terroristëve do të shushuriste lidhur me mungesën e përkrahjes për AKSH-në

në mënyrë eksplicite kishte kundërshtuar se Gafurr Adili ishte njëri nga individët i cili qëndronte prapa AKSH-së.

³⁴ Rasti Idajet Beqirit ishte ngritur nga Amnesty International në vitin 1996. Njëri nga të burgosurit e tjerë të asajë kohe ishte Fatos Nano, tani kryeministër i Shqipërisë.

³⁵ Intervisë e ICG-së, Bruksel, 23 shtator të vitit 2003. The FBKSH publikoi një komunikatë për shtyp më vonë të

njëjtën ditë duke përshkruar atmosferën, kohëzgjatjen dhe temat e bisedimit (me saktësi dhe tolerancë duke përfshirë edhe të dhënë se ICG-ja nuk u pajtua me analizat e tyre në një numër çështjesh), dhe Beqiri më pastaj ishte cituar nga mediat e Beogradit duke në bërjen e deklaratave rreth dekorit të zyrës sonë (NIN, 9 tetor 2003).

nga ana e Bashkësisë Ndërkombëtare (p.sh. Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e sajë), por e vërteta qëndron në atë se UÇK-ja arriti të fitojë përkrahjen ndërkombëtare vetëm pasi që Beogradi kishte filluar të vepronte si tërësi kundër marrëveshjeve me Bashkësinë Ndërkombëtare kah fundi i vitit 1998, ndërsa UÇPMB-ja dhe UÇK-ja nuk kishte pasur përkrahje ndërkombëtare fare.³⁶ Është gjithashtu e vërtetë se AKSH-së i mungonte numri anëtarësh dhe organizimi por është gjithashtu e vërtetë se historia më e herëshme e sajë kishte treguar para-ardhës më të suksesëshëm.

Tre faktorët vendimtarë që kanë shpjer në dështimin e AKSH-së:

Së pari rrethanat ishin shumë më pak të favorshme për një luftë të armatosur. Duke pasur parasysh vitet e intensifikimit të represionit nga Beogradi në Kosovë, gjëja më retrospektive dhe befasuese e shpejtësisë së veprimit të sajë është se konsolidimit të radhëve të sajë iu kishte dashur një kohë e gjatë. Fushata e mëpastajme e UÇPMB-së, e degëzuar në shumë mendime të paraqitura rreth qëllimeve të Bashkësisë Ndërkombëtare kur po vazhdonin poashtu politikat e Millosheviqit, doli në sipërfaqe si befasi. Dhe përderisa paraqitja e UÇK-së në vitin 2001 ishte predikuar nga një numër i vogël njerëzish, e vërteta është se qeveritë përkatëse maqedone dhe ajo që është më e rëndësishme përfaqësuesit shqiptar të zgjedhur në këto qeveri kanë dështuar në arritjen e ndonjë përmirësimi në drejtim të minoritetit më të madh etnik të vendit.

Në anën tjetër, perspektiva politike për shqiptarët e Maqedonisë, Serbinë Jugore dhe Kosovën që prej kur AKSH-ja kishte filluar operacionet në vitin 2001, ka treguar përmirësime mesatare mos të thuhet ngandonjëherë zhgënjime komplete. Presheva dhe Bujanovci tani kanë kryetarë komunash me përkatësi shqiptare; komuna shqiptare (në të vërtetë të gjitha komunat) nëpër tërë Maqedoninë janë duke fërkuar duart lidhur me pritjen me padurim për të marrur më shumë pushtet

nëpërmjet të decentralizimit, por në të njëjtën kohë duke rezistuar çdo lloj shkrirjeje me komunat fqinjë të çfarëdo lloj etnicitetit; dhe energjia politike e Kosovës, tani për tani është absorbuar në masë të madhe në zënkat e Parlamentit dhe OKB-së. Në veçanti, potenciali për telashe dhe probleme në Maqedoni është neutralizuar si rezultat i disa të arriturave të caktuara simbolike nga ana e BDI-së së Ahmetit, si përdorimi i gjuhës shqipe në Parlament dhe në pasaporta, e posaqërisht legalizimi i Universitetit të Tetovës. Këto të arritura kanë ndihmuar Ahmetin- dhe procesin e Ohrit si tërësi, që të kursethet nga kritikantët në aspekte zhgënjuese lidhur me implementimin e marrëveshjes sic është punësimi.

Së dyti, AKSH dështoi në arritjen e ushtrimit të ndikimit të madh në opinionin publik. Natyrisht, duhet të kemi kujdes në dhënjën e vlerësimeve që kanë të bëjnë me “përkrahjen popullore” për AKSH-në në kohën e mbretërimit të një qetësie relative. Shumica e shqiptarëve dhe maqedonase besuan se nuk ekzistonte ndonjë përkrahje popullore për UÇK-në në Maqedoni në Fillim të vitit 2001. Sidocoftë, pas ndezjes së konfliktit dhe fillimit të zhvendosjes etnike të stilit ballkanik, ndjenjat etnike u polarizuan me shpejtësi të madhe dhe popullariteti i UÇK-së u rrit në mënyrë dramatike. AKSH-ja nuk ishte në gjendje të arrijë këtë sukses. Individët e përfshirë në të nuk janë të popullarizuar dhe dështuan në përfitimin e entuziazmit të shqiptarëve në rajon dhe në diasporë. (Një ish-komandant i UÇPMB-së kishte cituar “Kush janë këta njerëz të cilët befasisht kishin filluar të kërkonin bashkimin e tokave shqiptare? Ne nuk i njohim ata”³⁹ – (ky është një vend i vogël. “) Vendimi i liderëve të saj për filluar fushatën e daljes së tyre në opinion me pseudonime kishte mbjellur pabesueshmëri që nga fillimi , dhe menjëherë pas kësaj, kur ishte bërë e ditur se në veçanti Beqiri ishte i përfshirë, kredibiliteti i potencialit të vet Organizatës ishte shkatërruar. Konfuzioni i vazhdueshëm rreth së cilët incidentet e dhunshme i ishin mveshur AKSH-së ose për shkak se cilët nga militantët e rajonit ishin zyrtarisht anëtarë të saj, dhanë sinjale se ishte fjala për një Organizatë me një identitet shumë të pasigurtë dhe të paqartë. Duke pasur parasysh lojalitetin difuziv të militantëve të ndryshëm shqiptarë në rajon si dhe vështirësitë e përvojës së tyre në komunikim është e qartë se çdo shpërthim i ardhshëm i natyrës ushtarake do të ishte vetëm një koalicion i përkohshëm i vullnetit.

³⁶ Duhet të theksohet se me gjithë pohimet e rastësishme të kundërta me Beogradin, deklaratimet më të fundit të bëra nga Momir Stojanovic, kryetar i agjencionit për siguri ushtarake të Serbisë dhe Malit të Zi në shkurt të vitit 2004, tregojnë se ekzistojnë pak të dhëna lidhur me ndonjë lidhje të fortë në mes të AKSH-së dhe grupacioneve të tjera militante ballkanike dhe se ekziston një përhapje më e madhe e rrjetit islamik siç është ai i Alkaidës.

Oportunistët e ardhshëm të cilët synojnë të paraqesin dhunshëm agjendën për pan-Shqiptarizëm mund të kenë më shumë fat në aspekte kohore dhe mund të jenë më të menqur në pikëpamje të përpilimit të strategjisë së komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm. Megjithkëtë, ata nuk do të jenë në gjendje të bëjnë asgjë lidhur me problemin e tretë të AKSH-së, e që është ideja për përdorimin e forcës për ribashkimin e të gjithë shqiptarëve në një shtet të vetëm përderisa kjo ide është vërtetë jo-popullore. Edhe pse të rëndësishëm ishin edhe faktorë të tjerë, është e pa kontestueshme se në vitin 1988 dhe prapë në vitin 2001 UÇK në Kosovë dhe UÇK në Maqedoni filluan seriozisht të fitojnë mbështetjen në popullatë vetëm atëherë kur u larguan nga qëndrimi për “Shqipërinë e madhe” dhe janë përcaktuar për opcionin për pavarësinë e Kosovës dhe përkatësisht për reformën konstituive të Maqedonisë. Në anën tjetër, sa më tepër që parashikimet e AKSH-së të kenë retorikë pan-Shqiptarizmi, aq më pak suksese ushtarake do të arrihen.

III. SHQIPËRIA: VËSHTRIME NGA TIRANA

Që prej përfundimit të konfliktit në Kosovë, Shqipëria e ka vënë veten në pozitë, si pikë logjike referuese për shqiptarët etnik të vendeve fqinje. Në përgjithsi, Politikanët e Shqipërisë kanë mbrojtur lidhjet e ngushta politike, ekonomike, dhe kulturore në mes të shqiptarëve të tërë rajonit por kurrë nuk kanë ndërmarrur tentativën për të bërë thirrje për ndërrimin e kufinjëve. Më shumë se ri-vizatimin e teritoreve, liderët shqiptarë kanë pasur për qëllim që të dëshmojnë se ekzistimi i kufinjëve nuk kanë penguar lidhjet e shqiptarëve etnik në përgjithësi. Në këtë plan, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë disa hapa të vogël lidhur me përkrahjen e lidhjeve andej kufirit, duke përfshirë këtu edhe hapjen e një “zyreje informative” në Prishtinë, Kosovë, më 1999. Duke sfiduar një mori faktorësh të brendshëm Shqipëria vështirë se do të udhëheqte lëvizjen për bashkim të shqiptarëve. Vetëm Partia për Unitet Kombëtar, tani pjesë e Frontit për Bashkim Kombëtar Shqiptar e udhëhequr nga Idajet Beqiri, përkrahë një iniciativë të tillë dhe përkrahja popullore është treguar gjithmonë e vockël. Angazhimi i Shqipërisë për stabilitet në rajon dhe qëndrimi kundërt ndaj përkrahësve militant të pan-Shqiptarizmit është shprehur qartë gjatë muajve të fundit me qëndrimin e fuqishëm

kundër këtij grupi dhe Armatës Kombëtare Shqiptare me të cilën ky grup është i lidhur.

Përderisa politikanët e Shqipërisë i janë shmangur në mënyrë të përgjithëshme përshtypjes së referimit dhe dhënies së përshtypjes zyrtare lidhur me advokimin për bashkim, lidhur me këtë temë ka pasur disa përjashtime. P.sh. Akademia e Shkencave të Shqipërisë ka argumentuar në “Platformën për zgjidhjen e çështjes së pazgjidhur shqiptare” të vitit 1998 se “aspirata e drejtë e të gjithë shqiptarëve është bashkimi i të gjitha trojeve etnike dhe tokave shqiptare në një shtet të vetëm”.³⁷ Akademia, e cila ka përjetuar një zbehje të prestigjit të sajë pas rënies së komunizmit, po përdorte nacionalizmin si mjet për të rifituar ndikimin e sajë të humbur. Me atë rast ajo i është kthyer platformës së marrë nga e kaluara por dokumenti si i tillë ka mbetur kontraverz dhe trazues për shtetet fqinje dhe si i tillë ka ndihmuar të ushqej një atmosferë të dyshimit e cili vazhdon të mbizotërojë edhe sot.³⁸

Deklaratë tjetër e vetme e llojit të tillë e bërë nga ndonjë zyrtarë shqiptarë është bërë nga Arben Imami, kryetar i Aleancës së Moderuar Demokratike, partnere e qeverisë së koalicionit e cila përbën disa nga intelektualët më të sofistikuar të Shqipërisë, është bërë me rastin deklarimit publik se bashkimi i Kosovës me Shqipërinë është objektiv i subjektit të tyre politik. Qarqe të tjera më të gjera politike³⁹ duke përfshirë edhe partinë e tij, kanë kritikuar pozicionimin e tij i janë shmangur paraqitjes para fushatës elektorale. Brenda ca ditëve, kuvendi i përgjithshëm i Aleancës Demokratike ka hedhur poshtë deklaratën e liderit të tyre dhe mëpastaj kjo aleancë ka ulur tonin e fjalëve në pajtim me programin zgjedhor duke bërë thirrje dhe duke kërkuar në vend të bashkimit zyrtar të Kosovës me Shqipërinë –“rivendosjen e marrëdhënieve” Sido që të jetë ky reagim i menjëhershëm ka pakësuar shqetësimet e vet vendeve fqinje të Shqipërisë.

Fatos Nano, i cili u bë Kryeministër i Shqipërisë për herë të tretë në korrik të vitit 2002, ka apeluar

³⁷ Platformë për Zgjidhjen e Çështjes Kombëtare Shqiptare, Tiranë, 1998, p.3.

³⁸ Akademia e shkencës dhe e arteve të Maqedonisë ka lëshuar një dënim në atë kohë me ç’rast ka deklaruar se luftimet në Maqedoninë Perëndimore në pranverë të vitit 2001, paraqitën implementimin e kësaj Platforme.

³⁹ Reuters, 13 prill, 2001. Arben Imami, udhëheqës i partisë bëri një deklaratë në vigjilie të zgjedhjeve të vitit 2001 election.

për zhvillimin e bashkpunimit politik dhe ekonomik në mes të shqiptarëve në Ballkan, por ai në deklarin e tij insiston në mos ndryshimin me forcë dhe detyrim të kufinjëve. Nano gjithashtu vazhdon të qëndroj besnik prapa qëndrimit se aplikimi i lirisë së lëvizjes nëpër regjion është mënyra më e mirë për ti mënjeluar thirrjet nacionaliste për një Shqipëri të madhe. Nano ka theksuar, “Duhet të koncentrohemi në promovimin e lëvizjes së lirë ndërmjet njerëzve të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës, veprim i cili do të ndihmonte në mënjanimin e ideve të ndërlydhura me Shqipërinë e madhe. Kjo ka të bëjë me krijimin e rrugëve të reja për bashkjetesë, së pari ndërmjet Shqiptarëve, ashtuqë që të dukemi si të emancipuar, demokratik dhe si faktor për stabilitet në Ballkan”.⁴⁰ Në realitet, në kushtet e tregut të lirë, në Jugosllavinë post Millosheviqiane, pjesa më e madhe e programit të Nanos bazohet në zhvillimin e domosdoshëm ekonomik.

Ish presidenti Sali Berisha, i cili ka mbetur lider i Partisë Demokratike opozitare, në përgjithësi e ka heshtur debatin në lidhje me pan-Shqiptarizmin gjatë viteve të fundit. Ngurrimi i tij për tu involvuar në këtë qështje mund të sqarohet pjesërisht me mospajtimet të cilat i ka pasur me politikanët Shqiptarë të Kosovës në lidhje me këtë temë. Kur së pari u emërua President në Mars të vitit 1992, Berisha ka deklaruar se njëri nga qëllimet e tij kryesore ishte bashkimi i Shqiptarëve⁴¹. Megjithatë, deri në fund të atij viti, Berisha e ka ndryshuar tërësisht mendimin, duke deklaruar publikisht se “koncepti për Shqipërinë e Madhe nuk trajtohet seriozisht në qarqet politike shqiptare”.⁴² Kjo ka shpjer adresimin e kritikave nga ana e Akademikut të njohur kosovar Rexhep Qosja, i cili në një leter të hapur kishte deklaruar se “Shqipëria kurre nuk i ka pranuar kufinj të ekzistues dhe është përpjekur t’ua kujtojë qarqeve ndërkombëtare se këta kufinj janë të padrejtë dhe se kanë bërë ndarjen e tokave shqiptare në dy pjesë. Në të vërtetë, kjo ndarje kalon në mes të zemrës së popullit shqiptar”.⁴³ Sidoqoftë, politikanët në Shqipëri, me përjashtimet e bëra më lart, kanë pasë qëndrime të ndryshme.

Shkëmbimi i ideve Berisha-Qosja është shembull tipik i një numri të debateve që janë zhvilluar gjatë viteve të 90-ta në mes të nacionalistëve të mëdhenj (gati të gjithë me prejardhje nga Kosova ose diaspora) dhe të politikanëve dhe akademikëve relativisht të moderuar të Shqipërisë. Historikisht dhe në pikëpamje kulturore, Shqipëria është në fokus të shqiptarëve që jetojnë në vende të tjera dhe ajo mbetet faktor lidhës për historinë dhe riafirmimin e ndërngjejes së tyre kombëtare. Që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, me përmirësimin e gjendjes së përgjithshme të sigurisë, është shënuar rritje e numrit të turistëve që vinin nga diaspora shqiptare duke përfshirë edhe ata nga Kosova që vizitonin bregdetin Jug-Perëndimor të Shqipërisë-“Rivierën Shqiptare” dhe duke udhëtuar nëpër vendet e shenjta kombëtare, përfshirë këtu edhe Muzeun e Skënderbeut në Krujë dhe Sheshin e Pavarësisë në Vlorë.⁴⁴

Qeveria e Shqipërisë gjithashtu ka përkrahur elementet kredencial nacionalistë, duke punuar për krijimin e një forumi të përbashkët të partive politike shqiptare nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Në vitin 1999, Fatos Nano (asokohe jashtë ushtrimit të detyrës) filloi të përpilote draftin me një agjendë politike të përbashkët në mes të Tiranës, Prishtinës dhe Tetovës me Hashim Thaçin, ish themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili tani drejton Partinë Demokratike të Kosovës. Nano gjithashtu, e futi në listë edhe Arben Xhaferin, lider i partisë Demokratike Shqiptare në Maqedoni. Të tre kishin për qëllim që të përpilonin një strategji pan-nacionale që do të integronte të gjithë shqiptarët. Siq kiste sqaruar Nano, “Kjo nuk do të jet një lëvizje që do të mbështeste Shqipërinë e madhe por do t’u shërbente gjerësisht Evropianëve Shqiptarë”.⁴⁵ Në Prill të vitit 2000, Nano inicoi një dialog nën mbishkrimin “Forum Politik për Stabilitet dhe Integrit” me liderë shqiptarë nga spektri i gjerë politik. Ibrahim Rugova, marëdhëniet e të cilit me Partinë Socialiste kurrë nuk kanë qenë të mira, refuzoi të mirrte pjesë në këtë Forum. Nano planifikon një takim tjetër me Partinë shqiptare në Mars të vitit 2004.

⁴⁰ Reuters –intervistë me Fatos Nanon, 6 dhjetor, 1999.

⁴¹ BBC, SWB, EE/1336, B/3, 23 March 1992.

⁴² Raportuar në gazetën *Bujku*, 19 dhjetor, 1992: “Idetë për një Shqipëri të Madhe janë ide të cilat absolutisht nuk mbështeten në qarqet dhe forcat politike shqiptare.”

⁴³ Gazeta Shqiptaro-amerikane *Iliria*, 3 shkurt 1993, p. 5.

⁴⁴ Sipas ministrit shqiptar për turizëm, numri i turistëve që kanë vizituar Shqipërinë është llogaritur në disa mija. Vizitorët nga Kosova kryesisht vijnë në Shqipëri në korrik dhe gusht kryesisht në qytetet bregdetare të Sarandës, Pogradecit, Durrësit dhe Tiranës.

⁴⁵ Intervista e ICG-së me Fatos Nano-n, Tiranë, dhjetor, 1999.

Sidoqoftë, ka pasur një numër takimesh të tjera të organizuara nga Nano që kanë qenë më pak zyrtare, në të cilat kanë marrë pjesë liderë politik nga pjesë të ndryshme të Ballkanit, sic ishte ai në Pogardec në shkurt të vitit 2003, takim ky i cili mbledhi: gazetarin kosovar Veton Surroi dhe liderët politik shqiptarë nga Maqedonia Ali Ahmetin dhe Arbën Xhaferin. Sipas komunikatës për shtyp, ata “riafirmuan bashkëpunimin e të gjithë shqiptarëve në procesin e integritimit evropian dhe u pajtuan në fuqizimin dhe bashkëpunimin e partive politike shqiptare me partitë e vendeve të tjera për të forcuar institucionet demokratike”.⁴⁶ ICG ka kuptuar se në të vërtetë disa nga pjesëmarrësit dëshiruan që të krijojnë një koncensus lidhur me mundësitë e tjera të veprimit në rast se Marrëveshja e Ohrit do të dështonte, por Ahmeti, i vetmi përfaqësues aktual i përfshirë në implementimin e kësaj marrëveshje, refuzoi të përfshihet në një spekulim të tillë.⁴⁷

Brenda për brenda Shqipërisë, ekziston një përkrahje e vogël për lëvizjet seperatiste shqiptare si në Serbinë Jugore poashtu edhe në Maqedoni. Ndonëse ekziston një përkrahje publike për pavarësinë e Kosovës, kjo ndodhë për arsye të ekzistimit të një simpatie për gjendjen e shqiptarëve të Kosovës më shumë sesa që qëndrojnë aspiratat për bashkimin me Kosovën ose Maqedoninë. Tirana ka shënuar një entuziazëm të vogël për bashkimin e qëndrimeve politike me Kosovën dhe shumë politikan shqiptarë frigohen se një qëndrim i tillë mund të lëvizë nga Tirana në Prishtinë.⁴⁸ Më një Shqipëri të tillë të zgjeruar, pushteti decidivisht do të kalonte Nga Toska në Gegë, të cilët tani do të bëheshim shumicë dhe gegët e Shqipërisë veriore do të kalonin në epërsi përnga numri, bashk me Gegët e Kosovës.

Ekziston gjithashtu një përshtypje e përgjithshme se e ardhmja e Kosovës do të përcaktohet me një “Fuqi të madhe” politike, arenë kjo në të cilën Shqipëria nuk ka pasur kurr ndikim. Qeveria e tanishme

shqiptare ka kufizuar qëllimet direkte për përmirësimin e lidhjeve tregtare me Kosovën, dhe komentet e platformës së partisë Socialiste në pushtet lidhur me këtë thonë se “Qëllimi i ardhshëm i të gjithë shqiptarëve është krijimi i një zone cila do të përfshinte të gjitha pjesët e banuara me shqiptarë të Evropës jug-lindore e cila do të integrohej në strukturat euro-atlantike.”⁴⁹ Qeveria ka vlerësuar lartë se prosperiteti i së ardhmes së Shqipërisë do të përmirësohej më së miri me integrimin e gjithmbarshëm me pjesën tjetër të Evropës, duke përfshirë këtu edhe Kosovën. Kjo do të thot se opinioni i gjerë si tërësi, është më shumë në favor të bashkimit dhe sigurisht që fuqishëm përkrahë pavarësinë e Kosovës. Sidoqoftë, nga rezultatet e zgjedhjeve është bërë e qartë se popullata ka prioritetet e tjera dhe se ka shumë pak mbështetje për çfarëdo lloj fushate të dhunshme për të arritur një synim të tillë.

Jashtë Tiranës, veçanërisht në rajonin kufitar të veriut, ekziston një mbështetje e fuqishme për bashkim me Kosovën, kryesisht për shkak të besueshmërisë se shkatërrimi i kufirit do të sillte benificione ekonomike dhe sociale të menjëhershme. Në të vërtetë, ndryshime pozitive në sferën ekonomike tanime janë dëshmuar me rastin e hapjes së 5 vijave të reja kufitare gjatë 5 viteve të fundit. Më tutje, në jug të Shqipërisë, ku popullata vendore Toskë ka më pak gjëra të përbashkëta historike, kulturore dhe shoqërore me shqiptarët e ish Jugosllavisë, përkrahja për vetëvendosje është paksa më e dobët.

Edhe pse përçarja veri-jug në Shqipëri është duke u bërë gjithnjë e më pak e dukshme, tensionet në mes të spektrit politik të majtë dhe të djathtë dhe çështja e nxehtë e Kosovës, janë ende tema bosht të debateve. Qeveria Socialiste e Shqipërisë humbi një pjesë të madhe të kredibilitetit në mesin e shqiptarëve të Kosovës pasi që Fatos Nano kishte mbajtur një takim jo të arsyeshëm me presidentin Jugosllav Slobodan Milosevic në vitin 1997. Ndonëse

⁴⁶ Fakti, 10 shkurt, 2003.

⁴⁷ Intervistat e ICG-së në Maqedoni dhe Kosovë, prill dhe qershor, 2003.

⁴⁸ Sipas një intelektual shqiptar, “ekziston një rritje stresi në relacionet në mes të klasës politike të Kosovës dhe homologen e sajë në Shqipëri. Ekziston një formë e shprehur e elitizmit në Kosovë – ata dëshirojnë të jenë në qendër të ngjarjeve – ata n’a konsiderojnë neve të prapambetur”. Diskutimet e ICG-së me intelektual shqiptarë, Tiranë, maj 2002.

⁴⁹ Paskal Milo, “Shqipëria” – Në mes të fiksacionit dhe realitetit, Tiranë, 2001, p 45. Megjithatë ministri i punëve të jashtme të Shqipërisë, Paskal Milo në mënyrë të qartë ka theksuar se prioritet dhe qëllim për vendin e tij është bashkimi me Evropën e jo me Kosovën. “Në qëndrimin e politikës zyrtare të Qeverisë Shqiptare nuk ka dhe as nuk ka pasur ndonjë referencë ose ndonjë qëllim të krijimit të Shqipërisë së madhe. Në të kundërtën, ka pasur deklarime të qarta lidhur me atë se një ide e tillë është kontra-produktive dhe në kundërshtim me objektivat e Shqipërisë për integrim në Evropën e bashkuar..”.

Shqipëria para syve të shumë shqiptarëve të Kosovës e ka shpague veten me ofrimin e ndihmave humanitare dhe të vendstrehimeve për mijëra refugjatë të shqiptarëve të Kosovës në vitin 1999, prapsepër mbetet një skepticizëm i madh në mesin e shqiptarëve të Kosovës për shkak të qëndrimeve nacionaliste të Politikanëve Socialist në Shqipëri. Në ndërkohë, anëtarë të kryesisë së LDK-së së Ibrahim Rugovës ruajnë relacione të afërta me ish-presidentin shqiptar Sali Berisha dhe Partinë e tij. Përkudër kësaj, Partia Demokratike e Kosovës e Hashim Thaçit ka relacione më të mira me majtistët e Shqipërisë dhe Lidhshin e partisë së qendrës.

Qështja e përkrahjes së Shtetit Shqiptar për militantët shqiptarë që veprojnë në Kosovë, Maqedoni dhe Serbinë Jugore, ka qenë dhe është brengë e Bashkësisë Ndërkombëtare. Natyrisht, para dhe gjatë luftës në Kosovë, do të paraqiste veçvrasje Politike për Qeverinë nëse do të përfshihej në aktivitet e guerilës së UÇK-së në Shqipëri. Gjatë konfliktit të vitit 2001 në Maqedoni për shembull, Qeveria Shqiptare nuk ishte e gatshme të arrestoj publikisht aktivistë të Armatës Kombëtare Shqiptare që vepronin nga Shqipëria, ose të kufizoj aktivitetet e tyre. Armët vazhdojnë të qarkullojnë – më shumë se ushqimi – për në Kosovë dhe Maqedoni që vijjnë nga grumbuj armësh të fshehura në Shqipëri.⁵⁰ Edhepse Qeveria e Tiranës është duke marrë asistencë ndërkombëtare për të ndaluar kontrabandën, gjithmonë do të jetë vështirë të kontrollohet terreni i papërshtatshëm malor që ndanë Shqipërinë me Kosovën. Me një polici relativisht joefikase, me simpati të gjerë për qëllimet rrebeluese dhe me ndieshmëri të lartë korruptuese, qeveria poashtu është e penguar nga grupe të vogla por me shumë ndikim brenda ushtrisë Shqiptare dhe shërbimeve të intelegjencës të cilat simpatizojnë grupet kryengritëse në Preshevë dhe Maqedoni. E përbërë nga një linjë e fortë e personelit ushtarak socialist, anëtarë të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe ish anëtarë të Shërbimit të Sigurimit të Shqipërisë të cilët janë edhe aktualisht anëtarë të të njëjtit shërbim kanë përcjellur me kënaqësi kontrabandën e armëve. Një pjesë e madhe e kësaj kontrabande gjithashtu është

zhvilluar me motivin e profitit.⁵¹ Kontrabanda mbetet çështje financiare, rast për furnizim dhe kërkesë dhe se si e tillë ka të bëjë shumë pak me nacionalizmin dhe në anën tjetër ka të bëjë shumë me çështjet ekonomike dhe lidhjet gjeografike të tregëtisë së zezë.

Sidoqoftë, duket se vullneti politik për t'u marrë me problemin ekziston aktualisht në Tiranë. Është me rëndësi të thuhet se edhe pse në kontekstin e performancës së Shqipërisë në relacionet me Unionin Evropian në mënyrë të përgjithësuar vërehet një zhgënjim, në lëminë e përforcimit të aplikimit të ligjit është parë një vend që në veçanti lidhur me këtë natyrë të aktivitetit ka pasur sukses.⁵² Duhet gjithashtu të theksohet se qeveritë përkatëse të Shqipërisë kanë zgjedhur strategjinë e partnershipit me Maqedoninë pasi që të dyja aspirojnë që anëtarësohen në NATO dhe në Unionin Evropian. Edhe më shumë interesant, është fakti i intervenimit krucioz në çështjen dhe tregimin lidhur me AKSH-në –lidhur me arrestimin e Gafurr Adilit dhe shkresa lidhur me arrestimin ndërkombëtar e lëshuar për Idajet Beqirin –iniciativa këto të dyja të ndërmarra nga Qeveria e Tiranës.

⁵⁰ Një numër i madh i armëve janë gjetur në janar dhe gusht të vitit 2002, në pjesën veriore të Shqipërisë në kufirin që ndanë Kosovën me Shqipërinë. Ka gjasa që të ekzistojnë grumbuj të tjerë armësh të fshehura në rrethinat e vijës kufitare.

⁵¹ Grupet etnike kryengritëse shqiptare kërkojnë një furnizim me armë shumë më shumë nga ndonjë shtet tjetër në Ballkan ose përgjithësisht në Evropën Lindore sesa furnizimi dhe paisja nga shqiptarët. Në vllugun e luftës, UÇK kishte blerë shumë më shumë armë nga serbët.

⁵² Intervistat e ICG-së me zyrtarë të komisionit evropian dhe diplomat të shteteve anëtare, janar dhe shkurt të vitit 2004.

IV.KOSOVA: PËRÇARJET E BRENDËSHME

Përderisa pjesa e popullatës shumicë të Kosovës nuk e përkrahë aktualisht krijimin e një shteti politikisht të integruar shqiptar, një numër i vogël i tyre qëndrojnë fuqishëm prapa kësaj ideje. Ashtu sikurse edhe në Shqipëri, edhe këtu pjesa më e madhe a partive politike i është shmangur retorikës inkurajuese lidhur me krijimin e një Shqipërie të madhe, duke ditur mirë se kjo do të shkaktonte armiqësinë me Bashkësinë Ndërkombëtare, faktor ky në të cilin Kosova vazhdon të mbështetet. Partitë politike nga të dyja anët e kufirit gjithashtu kanë arritur të kuptojnë se Shqipëria e madhe do të thoshte një gjë politike e parëndësishme –pse të garohet me partinë tjetër politike për vota përderisa është shumë gjë e vështirë të fitohen votat kundër kandidatëve të tanishëm. Sido që të jetë grupe të vogla radikale në Kosovë vazhdojnë të përkrahin bashkimin kombëtar.⁵³

Shqiptarët, si ata brenda Kosovës poashtu edhe ata jasht sajë argumentojnë se pavarësia e Kosovës do të ishte stabilizim për rajonin e Ballkanit, në veçanti duke marrë parasysh edhe përpjekjet për implementim e marrëveshjeve ekzistuese për përmirësimin e të drejtave të shqiptarëve etnik në Serbinë Jugore dhe në Maqedoni. Duke qëndruar prapa kësaj arsyeje të fuqishme, ata mendojnë se pavarësia në mënyrë efektive do të bënte neutralizimin e tendencave ekstremiste të grupacionave kryengritëse dhe të diasporës. Të dy shtetet shqiptare, Kosova dhe Shqipëria më pastaj do të ishin në gjendje që të koncentroheshin në ndërtimin e institucioneve civile dhe politike me qëllim të përgaditjes për integrim eventual në strukturat evropiane dhe se relacionet në mes të shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të Kosovës nuk do të paraqitnin kërcënim për shtetet fqinje.⁵⁴

Pasiguria lidhur me statusin final të Kosovës do të vazhdojë të prishë rehatinë e shteteve fqinje thënë së paku deri në zgjidhjen e çështjes së pazgjidhur për momentin. ICG-ja për një kohë të gjatë ka

prezentuar argumentin lidhur me atë se gjëja më e pëlqyeshme dhe e dëshirueshme e zgjidhjes së çështjes së pazgjidhur për Kosovën do të ishte marrja e një “pavarsie të kushtëzuar” duke përfshirë në këtë kushtin për zotimin lidhur me moskërkimin e zgjerimit të kufinjëve dhe bashkimin me Shqipërinë.⁵⁵ Sidoqoftë, Bashkësia Ndërkombëtare kërkon përsheptimin e adresimit të çështjes së statusit final për Kosovën; doktrina e tanishme lidhur me këtë ka të bëjë me atë se çështja do të mund të fillojë të diskutohet nga mesi i vitit 2005, nëse do të jetë bërë një progress i mjaftueshëm në plotësimin e standardeve.

Ndonëse idesë për Shqipërinë e madhe i mungon një çasje serioze nga ana e institucioneve politike të Kosovës, megjithatë nga vera dhe vjeshta e vitit 2003, kjo ide ka filluar të gjejë prehjen e sajë në kulturën ekologjike të Kosovës. Aktivist të LPK-së duke mbledhur nënshkrime janë paraqitur në pjesën e qytetit afër Grand Hotelit mu në zemër të Prishtinës. Prezentimi i librit të ri të Dr Paulin Kola “Në kërkim të Shqipërisë së madhe” ka mbledhur auditoriumin në bibliotekën kombëtare. Në mënyrë ironike, duke iu referuar hulumtimeve të tij ai kishte konkluduar: “Nuk e kam gjetur projektin për Shqipërinë e madhe askund-as në histori, as në kohërat moderne.” Titulli i librit të tij në SHBA “Miti për Shqipërinë e madhe” ka potencuar po të njejtën gjë. Sidoqoftë me gjithë pakapshmërinë, “Shqipëria e madhe” si frazë ose refren po demonstronte fuqinë e sajë.

Historikisht, shqiptarët e Kosovës kanë osciluar (luhatur) në mes të bashkangjitjes idealistike me shtetin e Shqipërisë nga njëra anë dhe zhgënjimit me pozicionimin aktual të Tiranës lidhur me çështjet e pan-Shqiptarizmit nga ana tjetër. Ndonëse ata kanë qëndrime përgjithësisht pozitive ndaj qytetarëve të Shqipërisë, ata kanë përbuzur elitën politike të Tiranës. Gjatë pushtetit të Enver Hoxhës p.sh shqiptarët e Kosovës kanë pasur bindjen se qëndrimi ndaj Kosovës në vazhdueshmëri nuk ka qenë i mirë.⁵⁶ Tensionet në mes të intelektualëve të Kosovës dhe liderëve politik shqiptar gjatë viteve të para të viteve të 90-ta kanë analizuar një çështje të tillë. Këtu duhet të

⁵³ Milo, *op.cit.*, p. 52. Sipas Milos, këto përfshijnë: Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK), Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKCK), Partia Republikane e Kosovës (PRK), dhe Parita Nacional Demokratike (PNDSH).

⁵⁴ Diskutime të ICG-së me activist shqiptar të Kosovës, Prishtinë, Maj 2002

⁵⁵ Shih raportin e ICG-së për Ballkan N°108, *Pas Millosheviqit: Një agjendë praktike për vazhdimin e paqes në Ballkan*, 26 prill 2001, pp 127-128.

⁵⁶ Në fillim të viteve të 1980-ta mbretëronte thënia se “Enver Hoxha duhet të kujtoj se ai është kryetar i shtetit dhe kryetar i partisë, por jo kryetar i kombit”.

theksohet se zhgënjimi në Shqipërinë buron kryesisht nga mungesa e interesimit për të vepruar nga ana e Shqipërisë, si një shtet sovran, për të bërë më shumë presion për më shumë të drejta për shqiptarët jashtë Shqipërisë. (më shumë sesa mungesa e interesimit të Shqipërisë për bashkim) Prejardhja politike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës qëndronte në një grup njerëzish të quajtur “Enverist” me qëndrim në ekzil të cilët bënin thirrje për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, grup ky i njerëzve të cilët ende përfaqësohen me Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK).⁵⁷ Ky grup pohon se ndonëse UÇK ka pasur përkrahjen popullore si brenda në Kosovë ashtu edhe në diasporë, qëllimi i saj politik ka lëvizur nga diç tjetër në kërkesën për pavarësi të Kosovës. Që prej konfliktit të viteve 1998-99, partitë politike të cilat kanë dalur nga UÇK-ja, Partia Demokratike e Kosovës e Hashim Thaçit (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e Ramush Haradinajt (AAK) – kanë qenë veq më të moderuara në shumë çështje sesa LDK-ja e Ibrahim Rugovës. LPK-ja dhe një parti tjetër e vogël me emrin Lëvizja Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK) – vazhdojnë të bëjnë presion për pavarësi të Kosovës dhe bashkim të mundshëm (përfundimtar) me Shqipërinë. Të dy lëvizjet nacionaliste, Balli Kombëtar dhe Fronti Nacional, të vendosura me bazat e tyre njëra në Shqipëri dhe tjetra në Kosovë, dhe Lidhja e dytë Shqiptare e Prizrenit me seli në Nju Jork dhe Prishtinë në mënyrë tradicionale kanë bërë fushatë për Shqipërinë e madhe.⁵⁸ Në zgjedhjet e vitit 2002 nga 920 ulëse në 31 këshille komunale në Kosovë, LPK ka fituar katër ulëse, Balli Kombëtar –dy ulëse

⁵⁷ Shih në veçanti Tim Judah, *Kosovo: Lufta dhe hakmarrja* (Yale, 2000) dhe pjesën e fundit të Paul Hokenos, *Vendëlidhja thërret: Patriotizmi në ekzil dhe luftat ballkanike* (Cornell, 2003).

⁵⁸ Balli Kombëtar ishte Lëvizje resistente e fuqishme anti-komuniste e themeluar në Shqipëri në vitin 1942, me qëllim të ri-bashkimit të të gjitha teritoreve etnike shqiptare. Lidhja e dytë e Prizrenit ishte formuar në Prizren në vitin 1943 nga anëtarë të Ballit Kombëtarë të cilët në bashkëpunim me autoritetet okupatore gjermane, kishin për qëllim që të koordinonin aktivitetet të ndryshme të grupeve të ndryshme nacionaliste shqiptare për bashkimin e fushatës për bashkimin etnik. Lidhja e parë e Prizrenit ishte formuar më 10 qershor të vitit 1943, me çrast u takuan lider nationalist shqiptar në qytetin Prizrenit në Kosovë. Qëllimi themelor i Lidhjes së Prizrenit ishte të organizonte kundërshtimin politik dhe ushtarak ndaj copëtimit të teritoreve të banuara me shqiptarë dhe të kërkonin nga Porta e Lartë bashkimin e katër vilajeteve, atë të Janinës, Manastirit, Kosovës dhe Shkodrës në një njësi të vetme politike dhe administrative.

ndërsa LKÇK asnjë. Rezultati I përgjithshëm I tyre prej 1.2% kishte nga rezultati jo –impresionues 2.2% i zgjedhjeve të Nëntorit të vitit 2001. Peshat politike është më e lartë në mes të njerëzve në mes të shqiptarëve në diasporë dhe shumë më e ulët brenda në Kosovë

Rrymat politike që veprojnë në Kosovë nuk përfshijnë mbështetjen për Shqipërinë e madhe. LDK nuk mbështet krijimin e Shqipërisë së madhe dhe nuk është farë e disponuar të bëjë ndonjë lëvizje drejt bashkimit. Gjithashtu, PDK dhe AAK-trashëgimtarët politik të ish UÇK-së nuk e përkrahin Shqipërinë e madhe ndonëse dy dyja këto parti kanë lidhje të ngushta me Armatën Çlirimtare në Preshëvë, Medvegjë dhe Bujanovc (UÇPMB) me veprim në Serbinë jugore dhe me Armatën Kombëtare Shqiptare në Maqedoni. Ty dyja këto parti si AAK ashtu edhe PDK e kuptojnë se se më shumë mbështetje aktive për idenë për Shqipërinë e madhe do të iu kushtonte atyre në marrëdhëniet me Bashkësinë Ndërkombëtare në të cilën ende besojnë për mbështetje. Kur trashëgimtari i frontit Leka Zogu u kthye, ai vizitoi Kosovën në fillim të qershorit të vitit 2003, me ç’rast bëri përpjekje që të forcoj pozicionin e tij me deklarinimin për mbështetje të krijimit të Shqipërisë etnike dhe se turmat e njerëzve që i aplauzuan nuk patën një jehonë të madhe

Përderisa LDK-ja i është shmangur idesë për Shqipërinë e madhe, ajo mbetet zëdhënësjë më e madhe për pavarësinë e Kosovës.⁵⁹ Edhe para dezintegritit të Jugosllavisë, Ibrahim Rugova kishte bërë thirrje që statusit të Kosovës t’i ipej Republika brenda Jugosllavisë. Rugova gjithashtu kishte pohuar se pas konfliktit në Kosovë, Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit e cila i kishte dhënë fund luftës ishte thjesht një “kompromis i madh për të arritur deri tek përfundimi i luftës në Kosovë, por kjo nuk e kufizon të ardhmen për pavarësi. Çdo gjë tjetër përveq pavarësisë është e papranueshme për ne.”⁶⁰

Në gjashtmuajorin e dytë të vitit 2003, politikanët Kosovarë kanë filluar që të gurmajnë instrumentalizimin lidhur me kërcënimin për Shqipërinë e madhe si shtytje me të cilën donin të

⁵⁹ Për çështje dhe diskutime të plota të bëra lidhur me statusin final të Kosovës shih: Harta rrugore e Kosovës (I): *Adresimi i statusit*, dhe Harta rrugore në Kosovë (II): *Etapat e brendëshme*, Raportet e ICG-së për Ballkan N°124 dhe N°125, 1 mars, 2002.

⁶⁰ *Der Spiegel*, 17 prill, 2000.

bindnin Bashkësinë Ndërkombëtare që të pajtohej me dhënien e pavarësisë së Kosovës. Mesazhi që e bartnin përmbante sa vijon: “Nëse ju nuk n’a jipni pavarësinë ne mund të ngritemi për diç me shumë Në një kontekst të tillë, pavarësia e Kosovës do të mund të prezentohej si diç që prishte ndryshimet, thjesht një kompromis. Ibrahim Rugova e paraqiti me retorikën e tij një mesazh në fund të shtatorit të vitit 2003, duke paralajmëruar se nëse pavarësia e Kosovës nuk do të pranohej, shumë më heret pa e lënë për t’u bërë vonë, ekstremistët do të mund të pritëshin të formonin një shtet të bashkuar shqiptar.⁶¹ Kryesia e Parlamentit të Kosovës dërgoi një sinjal të ngjajshëm në nëntor të vitit 2003, normalisht sinjali ishte dërguar pa pjesëmarrjen e LPK-së dhe peticionit të sajë për shtetin e bashkuar me Shqipërinë, i cili deri atëherë kishte mbledhur përafërsisht 46,000 nënshkrime. Anëtar i kryesisë Hydajet Hyseni vlerësoi se: ‘peticioni i LPK-së do të përfshihej në agjendë si një nga opsionet prezente të jetës sonë politike,’ sepse: “vullneti i popullatës do të duhet të gjejë rrugën për të arritur deri tek institucionet”.⁶²

Përderisa Rugova vazhdon të theksoj se pavarësia e Kosovës është pjesë ecentrale e programit të LDK-së, PDK për dallim prej kësaj në mënyrë taktike ka konkluduar se Bashkësia Ndërkombëtare nuk është e përgaditur për të hapur këtë çështje për momentin dhe ka kërkuar që të paraqes këtë problem “me përgjegjësi” për dallim prej Rugovës dhe LDK-së. Në prill të vitit 2003, Hashim Thaçi propozoi një moratorium lidhur me statusin final të Kosovës, “për një kohë të caktuar”, pozicion ky plotësiht në vijë të njejtë me atë të Bashkësisë Ndërkombëtare.⁶³ Sodoqoftë, të dyja edhe PDK edhe partia më e vogël AAK, esencialisht pajtohen me pozicionin e Rugovës se Kosova tani më është veç e pavarur, dhe se ajo është vetëm thjesht duke pritur për t’u pranuar nga Bashkësia Ndërkombëtare.

Ka ekzistuar një debat vitin e kaluar në Kosovë lidhur me konceptit të ndarjes së Kosovës. Arben Xhaferi (kryetar i DPA-së në Maqedoni) është njëri nga politikanët që kritikon në mënyrën më të egër këtë ide, dhe është njëri nga promotorët

kryesor të unifikimit të territoreve të banuara me shqiptarë. Por edhe për Xhaferin, argumenti për pan-shqiptarizmin është një mënyrë veprimi më shumë sesa një fund- I cili nënkupton se duke bërë lidhjen e fateve të shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë dhe Luginës së Preshevës, këto njësi të ndara do të mund të kishin një rast më të volitshëm për të arritur deri tek një marrëveshje më e mirë

Kryengritja shqiptare në Maqedoni në verë të vitit 2001 ishte përkrahur fuqishëm në Kosovë. Suksesi relativisht i madh i shkathtësive ushtarake dhe taktikave të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare – përkundër trazirave të vitit 2000 në Preshevë ka ngritur moralin për përkrahje nga ana e akterëve të politikës shqiptare në Kosovë. Konflikti gjithashtu vuri në pah një potencë të mbetur nga tradita e UÇK-së dhe kjo bëri që shumë vëzhgues ndërkombëtarë të konkludojnë se Kosova ishte ndërlihdhëse e eksportit të radikalizmit dhe ekstremizmit. Politikanët e sofistikuar në Kosovë kuptojnë se një vështrim i tillë ndërkombëtar ka dëmtuar kredibilitetin e Kosovës, me c’rast është dëmtuar edhe potenciali për zhvillim të fqinjësisë së mirë dhe për arritje të pavarësisë. Nuk kishte ndonjë përkrahje të dukshme për Armatën Kombëtare Shqiptare nga asnjëri nga akterët e politikës kosovare.

Duke pasur të njohur ndjeshmërinë e akuzave ndaj shqiptarëve të Kosovës për ekstremizëm, Kryeministri serb Zoran Djindjic vizitoi Britaninë e Madhe në Prill të vitit 2002, me c’rast deklaroi se pavarësia e Kosovës do të mund të shoqërohej me një nxitje të armiqësisë nga ana e shumë vendeve fqinje të saj, dhe kështu do të krijohet një kaos i ri në rajon, “Pasojë e parë do të ishte kriza në Maqedoni dhe shkatërrimi i mundshëm i shtetit Maqedon”. Pasojë e dyte do të mund të ishte Bosnja dhe e ardhmja e shtetit boshnjak. Pasojë e tretë do të ishte përhapja e krizave gjithandej në forcat demokratike në Serbi. Pyetja qëndron në ate se a e vlenë të krijohet një shtet i dytë shqiptar në Ballkan dhe a e vlenë të rrezikohet nga gjithë këto pasoja?”⁶⁴ Pasardhësi i tij, Zoran Zhivkoviç, paralajmëroi se ndarja e Kosovës “do të mund të krijonte një rrezik të paparashikueshëm. Në ate rast të gjithë kufijtë e Ballkanit do të kërkonin ri-organizim”.⁶⁵ Liderët serb, natyrisht janë duke bërë c’është e mundur për

⁶¹ Agjensia e lajmeve Beta, Beograd, 19 shtator, 2003, ka cituar nga një intervistë dhënë radios çeke më 18 shtator, 2003.

⁶² Kosova në një shikim të shpejtë (ang. Kosovo at a Glance V.I.P. Daily New Report, 19 nëntor, 2003.

⁶³ Intervistë me stacionin e televizionit të Jagodinës, Palma Plus, e paraqitur së pari në *Epoka e Re*, 7 prill, 2003

⁶⁴ BBC intervistë me, 15 prill 2002

⁶⁵ *Der Spiegel*, 17 Maj 2003, faqe. 128.

të ndaluar ndonjë veprim unilateral të Bashkësisë Ndërkombëtare për Pavarësinë e Kosovës

Në ndërkohë, integrimi ekonomik dhe kulturor në mes të Shqipërisë dhe Kosovës vazhdon, dhe është në rritje në të gjitha nivelet. Nënshkrimi i marrëveshjes për tregtinë e lirë në mes të Shqipërisë dhe Kosovës në maj të vitit 2003 konsiderohet si një e arritur e rëndësishme e këtij procesi. Megjithatë, mardhëniet politike në mes të dy etnitetëve shqiptarë vazhdon të shënojë një frustrim dhe mosbesim të heshtur, duke mënjanuar çdo lloj momenti dhe zhvillimi që do të shpiente në idenë për pan-Shqiptarizëm. Ish-ministri i jashtëm i Shqipërisë Ilir Meta, refuzoi “të ipte ndonjë mendim dhe formulë për statusin e Kosovës” pak para dorëheqjes së tij.⁶⁶ Oferta që Tirana ka bërë kohëve të fundit për ndërmjetësim në mes të Kosovës dhe Shqipërisë nuk u prit me entuziajzëm as nga ana e Beogradit e as nga Prishtina. Shqiptarët e Kosovës gjithmonë janë mbështetur shumë më shumë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës se sa në Shqipërinë dhe ky fakt nuk duket se do të ndryshojë.

III. MAQEDONIA: A DUHET TË QËNDROJMË APO TË SHKOJMË

Situata në Maqedoni ndryshon në mënyrë të konsiderueshme nga ajo në Kosovë dhe në Luginën e Preshevës të Serbisë jugore. Pas vitit 1989, shqiptarët e Maqedonisë filluan të kenë kushte ekonomike relativisht më të mira dhe më shumë të drejta politike në krahasim me të gjithë shqiptarët në ish-Jugosllavi. Por, kështu nuk ndodhte gjithmonë. Gjatë viteve 1950 dhe 1960, shqiptarët e Maqedonisë përjetuan persekutime të shkallës së njejtë të spastrimit etnik nga Ministri jugosllav për Punë të Brendëshme Aleksandar Rankovic ashtu siç kishin vuajtur shqiptarët e Kosovës.⁶⁷ Prap, në mes të viteve 1980-të shkollat në gjuhën shqipe

ishin mbyllur dhe muret tradicionale për rreth shtëpive të shqiptarëve ishin shkatërruar. Shumë shqiptarë gjithashtu ishin burgosur me akuzë të përfshirje të tyre në “nacionalizëm” dhe u ndërmorr një numër aktivitete që përfshinte edhe përcjelljen e pjesëmarrjes së shqiptarëve në dasmat e tyre.⁶⁸

Pas dezintegrimit të Jugosllavisë, në fillim të viteve 1990, shqiptarët në Maqedoni nuk ishin shumë të entuziazmuar me krijimin e shtetit të ri. Edhe politikanët maqedon, si p.sh. kryeministri aktual Branko Crvenkovski pranon se farat e pakënaqësisë ishin mbjellur me suspendimin e kushtetutës nga pjesa shumicë e Maqedonëve etnik, pas deklarimit për pavarësi nga Jugosllavia më 1991. Kushtetuta e re zyrtarisht largoi mbrojtjen e shqiptarëve, gjë të cilën me marrëveshje e garantonte kushtetuta Jugosllave dhe, siç pohon Crvenskovski, shqiptarët refuzuan të votojnë për te. Në të vërtetë, rrethe të banuara me shqiptarë të Maqedonisë Perëndimore organizuan një referendum në vitin 1992, i cili aprovoi “autonominë territoriale” dhe bashkimin eventual me Kosovën. Një “Republikë Autonome e Iliridës” është shpallur më pastaj në disa komuna, por për gjëra të tilla më pas nuk është vazhduar të flitet. Elita shqiptare e Maqedonisë ishte e vendosur në një formë të participimit në Qeveri dhe për të dizajnuar patronazhin e mundshëm për minoritetin etnik.⁶⁹ Partia për Prosperitet Demokratik përfaqësoi shqiptarët në Qeverinë e Maqedonisë nga koha e marrjes së Pavarësisë deri në zgjedhjet e vitit 1998, kur ata ishin zëvendësuar nga Partia Demokratike e Shqiptarëve (DPSH) të cilët sipas rendit ishin zëvendësuar me kohë nga Unioni Demokratik për Integrim (UDI) në vitin 2002. Edhe pse, liderët e PDSH-së ishin ndarë nga PPD më 1994, për shkak se ata synonin që të ndiqnin agjendën me karakter më shumë nationalist, asnjëra nga këto parti nuk e ngriti çështjen territoriale para konfliktit të vitit 2001. Në vazhdim, Ali Ahmeti, i cili udhëhoqi Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare gjatë zhvillimit të konfliktit dhe që tani është lider i UDI-së, në mënyrë të vazhdueshme ka deklaruar se zotim i partisë së tij është integriteti territorial i Maqedonisë.

⁶⁶ Intervistë me Deutsche Welle, 16 qershor 2003, një ditë më pas e cituar në *Epoka e Re dhe Kosova Sot*.

⁶⁷ Aleksandar Rankovic ishte nënkryetar i Jugosllavisë dhe në disa vende është prezentuar si trashëgimtar i Titos. Ai udhëhoqi Forcat e Policisë së Sigurimit Jugosllav (UDBA). UDBA ishte përgjegjëse për keqpërdorime serioze të popullsisë shqiptare me pretekst të shtypjes së iredentistëve shqiptar, UDBA-ja iu ka bërë presion shqiptarëve që të emigrojnë. Në mes të viteve 1954 dhe 1957, rreth 195,000 shqiptarë e kanë lëshuar Jugosllavinë dhe me dëbimin e Rankoviqit shifrat kanë arritur në 235,000.

⁶⁸ Elez Biberaj, *Shqipëria në tranzicion. Rruga shkëmbore deri tek demokracia*, Westview Press, Boulder, Colorado, 1998, p. 256.

⁶⁹ Shih raportin e ICG-së për Ballkan N°133, Sekret i publik i Maqedonisë: *Si ndikon korrupsioni në rënien e një shteti*, 14 gusht, 2002.

Fillimisht, Xhaferi dhe politikanët shqiptarë të establishmentit në Maqedoni, në mënyrë aktive kanë kundërshtuar kryengritjen e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në pranverë të vitit 2001. DPSH edhe publikisht përkrahi reagimin e forcave ushtarake maqedone. Pas ndërmyjetësimeve të ndërmarra nga Ambasadori i SHBA-ve Robert Frowick, në Prizren është arritur nënshkrimi i një deklarate të përbashkët nga liderët shqiptarë të Maqedonisë duke përfshirë edhe UÇK-në e Ali Ahmetit. Kjo deklaratë premtoi anashkalimin e armiqësive, me ç'rast si rezultat i kësaj shqiptarëve të Maqedonisë do t'u ipeshin më shumë të drejta. Edhe pse përpjekjet e Ambasadorit Frowick ishin mohuar menjëherë nga Komuniteti Ndërkombëtar, megjithatë marrëveshja formoi bazën për marrëveshjen paqësore që pasoi.

Marrëveshja e Ohrit e nënshkruar në gusht të vitit 2001, ka bërë ndryshime fundamentale në kushtetutën Maqedone, për sigurimin e më shumë të drejtave për shqiptarët, për të ndikuar në çështjet legislative, si çështje më me rëndësi siç janë: arsimimi në gjuhën shqipe dhe rritja e përfaqësimit shqiptar në Qeveri dhe në forcën policore. Marrëveshja gjithashtu, përfshinte kërkesat ndaj UÇK-së për çarmatim dhe shpërbërje.⁷⁰ Ali Ahmeti dhe shumica e atyre që luftuan përkrah tij, duket të kenë zgjedhur shtegun e qartë, tani për tani, dhe suksesi i aktivitetit të tyre gjatë vitit 2001 i ka vendosur shqiptarët e Maqedonisë në një situatë shumë më të pranueshme.⁷¹

Zbulimi i qëllimit të vërtetë të shqiptarëve të Maqedonisë, bazuar vetëm në deklaratat publike të tyre është situatë sfiduese. Sdoqoftë, përpjekjet për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit kanë ofruar një barometër të kënaqshëm me të cilin do të mund të gjykonim qëllimin e akterëve në vendin e ngjarjes. NATO dhe vëzhgues të tjerë ndërkombëtarë potencojnë përkrahjen e vazhdueshme të Ahmetit për Marrëveshjen e Ohrit, duke përfshirë edhe përkrahjen e tij për kthimin e Ushtrisë dhe Policisë maqedone në vendet e konfliktit si e dhënë që flet se qëllimet e tij janë të orientuara më shumë në drejtim të zgjerimit të të

drejtave politike se sa në ndarjen e vendit përgjatë linjave etnike. Kundërshtimi i tij i hapur ndaj AKSH-së e cila në mënyrë eksplicite përmbante agjendën për ndryshimin e kufinjëve është një indikator tjetër pozitiv.

Pjesa më e madhe e shqiptarëve të Maqedonisë, edhe pas konfliktit të vitit 2001, ende e identifikojnë veten si qytetarë të Maqedonisë dhe se dëshirojnë që shteti i Maqedonisë të mbijetoj. Qëndrimi i përgjithshëm i shqiptarëve atje mund të llogaritet nga fjalët e një gazetari të ri Maqedono-shqiptar i cili iu drejtua ICG-së me këto fjalë: "Maqedonia është shteti im, por neve duhet të kemi integritet politik dhe të drejta të standardeve evropiane. Maqedonia duhet të jetë shtet i përbërë prej dy komuniteteve – Maqedonët dhe shqiptarët dhe vetëm atëherë do të mund të mbijetoj".⁷² Qarqe të ndryshme pohojnë se përderida shumica e shqiptarëve në Maqedoni favorizojnë idenë për bashkimin politik të shqiptarëve në Ballkan në kuadër të një shteti, disa përkrahin bashkimin nëqoftëse ky proces përcillet me luftime.⁷³ Një indikator vendimtar në këtë plan ishte dështimi i Armatës Kombëtare Shqiptare për të përfituar përkrahjen e shqiptarëve të Maqedonisë. Partia e vetme politike e cila e përkrahi "federalizimin" ishte PDK e udhëhequr nga Kastriot Haxhirexhi, e cila parti aktualisht ka vetëm një ulëse në Parlament.

Çfarëdo që të ishte "qëllimi i vërtetë" i shqiptarëve në Ohër, ata pranuan një marrëveshje që kishte për qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre pa ndikuar në ndryshimin e hapsirave territoriale. Përkundër marrëveshjes së Dejtonit, nuk ekzistonte asnjë koncension për ri-organizimin federal që do t'u mundësonte shqiptarëve "kontroll" zyrtarë të pjesëve të caktuara të vendit. Natyrisht se ekzistojnë qëndrime të përkohëshme për ri-organizimin e kufinjëve komunal sipas teorisë për decentralizim të përgjithshëm të mandatuar në Ohër. Përderisa ky proces ka vënë në pah brengën e thellë për krijimin (ose njohjen) *de facto* të territoreve "etnike shqiptare", është me rëndësi të kujtohet se vet Ohri nuk i përshkruan dhe nuk cakton ndarjet territoriale.

⁷⁰ Shih *Maqedonia: Plotësimi i vakumit të sigurisë*, Raport i ICG-s për Ballkanin, 8 shtator, 2001 dhe *Maqedonia: No Room for Complacency*, Raport evropian i ICG-sw N°149, 23 tetor, 2003.

⁷¹ Shih gjithashtu James Pettifer, *FYROM Pas misionit Concordia*, Qendra për studime dhe hulumtime të konflikteve, dokumenti G129, shkurt, 2004.

⁷² Bisedime të ICG-së me Arsim Sinanin, Prishtina, maj, 2002

⁷³ Zyra për hulumtime, departamenti i shtetit të SHBA-ve, analiza të opinioneve, 8 maj 2002; 73 përqind kanë përkrahur idenë për bashkim, por vetëm 30 përqind ishin në favor të kësaj ideje në qoftëse do të përfshiheshin edhe shtetet fqinje.

Për një numër arësyesh sociale dhe politike, shqiptarët e Maqedonisë mbesin më afër shqiptarëve të Kosovës në krahasim me afërsinë që kanë ndaj shqiptarëve që jetojnë në shtetin shqiptar. P.sh., shumica e shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni ndajnë dyshimin e thellë me shqiptarët e Kosovës në lidhje me marrëdhëniet e Tiranës me Greqinë, dhe në lidhje me marrëdhëniet në mes të Shkupit dhe Beogradit. Gjatë konfliktit në Maqedoni, në verë të vitit 2001, Qeveria e Shqipërisë u paraqit si e dezinformuar lidhur me gjendjen ushtarake të Armatës Kombëtare Shqiptare dhe dyshoi (sikur edhe shumë vëzhgues të tjerë) se autoritetet e Shkupit do të mund të shtypnin kryengritjen. Për më tepër, liderët shqiptarë të Maqedonisë në Tetovë, kanë qenë gjithmonë shumë anti-komunist dhe në mënyrë tradicionale kanë pasur marrëdhënie të varfëra me socialistët në Shqipëri të cilët kanë qenë në qeveri që nga viti 1997.⁷⁴ Përderisa Tirana mos të ketë rol më aktiv për çështjen e Kosovës ose Maqedonisë, nuk do të ketë lëvizje të dukshme nga ana e liderit shqiptar në Maqedoni për të forcuar çfarëdo lidhje tjetër me Shqipërinë, përpos lidhjeve kulturore dhe ekonomike. Përkundër kësaj, një histori e përbashkët e qytetarëve të ish-Jugosllavisë e kombinuar me lidhje të forta familiare në mes të shqiptarëve në Maqedoni dhe atyre në Kosovë ndërlidhë këto dy etnitet shqiptare në një mënyrë të veçantë në krahasim me ndërlidhjet etnike të këtij lloji në Shqipëri, Mal të Zi dhe Greqi.

Edhe gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2002, PDSH-ja ka lëvizur drejt nacionalizmit radikal, duke apeluar në mënyrë të hapur për një "Shqipëri etnike" dhe duke vënë në dyshim vazhdimisht zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Ohrit si zgjidhje për bregat e shqiptarëve. Përkundër qortimeve të diplomatëve të lartë të Unionit Evropian dhe SHBA-ve, lideri Arben Xhaferi vazhdimisht ka theksuar se shqiptarët etnik në Maqedoni duhet të posedojnë të drejtën për vetvendosje dhe se ai është i thhtar i Shqipërisë federale pasi që shqiptarët etnik dhe maqedonët duhet të kenë rrugët e veta të ndara.⁷⁵ Zëvendësi i tij, Menduh Thaçi ka bërë një

deklaratë provokative në korrik të vitit 2002, duke thënë, "...Kur sllavët kanë disa shtete, pse shqiptarët nuk mund të integrohen si një komb?"⁷⁶ Shqiptarët e Maqedonisë kanë përkrahur një mënyrë të integritimit ose krijimit të një konfederate me Kosovën dhe nëse Maqedonia do të përparonte ekonomikisht ose nëse Marrëveshja e Ohrit do të ngeçete, atëherë integrimi më i gjerë me Shqipërinë, do të ishte edhe më i dëshirueshëm. Një masë e gjerë në Maqedoni e të gjitha etnitetëve ende besojnë se Bashkësia Ndërkombëtare nuk është seriozisht e vendosur për të ruajtur integritetin e shtetit. Insistimet evropiane dhe amerikane për implementimin e Marrëveshjes së Ohrit janë një rivërtetim i rëndësishëm i asaj se nuk do të ketë ndryshime të tjera drastike të kufinjëve të shtetit apo të Kushtetutës. Implementimi është poashtu i rëndësishëm pasi që marrëveshja do të siguroj benificione praktike për qeveritë lokale pasi të bëhet decentralizimi i premtuar i pushtetit. Por më shumë siguri mundet dhe duhet të ipet; emri i shtetit është mezi i pranuar nga akterët ndërkombëtarë.⁷⁷ Aspiratat e Maqedonisë për të hyrë në NATO dhe në BE duhet të trajtohen seriozisht dhe me simpati.

⁷⁴ James Pettifer, *FYROM -Pas Ohrit*, qendra për hulumtime dhe studime të konfliktit, mars, 2002, p 5

⁷⁵ Për pikpamje të Arben Xhaferit lidhur me situatën me të cilat përballen shqiptarët në Maqedoni, shih tregimin e tij *Sfidat drejt demokracisë në shtetet multi-etnike*, [http://aacl.com/challenges_to_democracy .htm](http://aacl.com/challenges_to_democracy.htm), 16 maj, 2001, dhe analiza të tjera në *Maqedoni: Nuk ka hapsirë për*

vetkënaqësi, Raport i ICG-së për Evropë -N°149, 23 tetor, 2003

⁷⁶ Menduh Thaçi duke folur në një konferencë të rinisë së DPA-së, Tetovë, 3 korrik, 2002

⁷⁷ Shih raportin e ICG-së për Ballkan N°122, *Emri i Maqedonisë: Pse ekzistojnë çështjet konfliktuoze dhe si të zgjidhen ato*, 10 dhjetor, 2001.

IV. MALI I ZI, SERBIA JUGORE DHE GREQIA

A. A ËSHTË QETË NË FRONTIN PERËNDIMOR?

Ri-shfaqja e tregimit të njejët gjatë disa viteve të fundit që ishte befasi e një grupi guerilësh shqiptarë të cilët kërcënonin për destabilizim të Malit të Zi, pasoi me zhdukjen e menjëherëshme të tyre. Incidenti i fundit ndodhi në janar të vitit 2004, kur një faqe në internet ishte publikuar me emrin interesant “Armata Kombëtare e Malit të Zi”. Ajo kishte paralajmëruar se “eksperimentimi me fatin e shqiptarëve në Mal të Zi” do të shpiente “në aksione që do të kishin caqe, interesat dhe ndërtesat vitale të Malit të Zi”. Liderët shqiptarë hodhën poshtë çfarëdo lloj lidhje dhe njohurie me këtë organizatë, si dhe kanë vënë në pah një numër gabimesh gramatikore që ishin bërë në deklaratat për të cilat përgjegjësitë i kishte marrë kjo armatë. Faqja ishte zhdukur nga interneti, duke provokuar një vërshim të mediave në Mal të Zi dhe në vendet fqinje, gjë që me sa duket ishte qëllim dhe objektiv i autorit të tyre.

Komuniteti shqiptar në Mal të Zi është i koncentruar në jug-lindje të vendit, bashkangjitur me Shqipërinë veriore. Përkundër protestave të fuqishme nga ana e Shqiptarëve Muslimanë dhe Katolikë, rajoni i është dorëzuar Malit të Zi pas Kongresit të Berlinit në qershor të vitit 1878. Kjo u përcoll me një model të asimilimit të vazhdueshëm qoftë me forcë, qoftë me dashje, dhe nëpër zona me popullatë shumicë sllave, pasoi emigrim i konsiderueshëm i komunitetit shqiptar. Në përgjithësi, ekzistonte një tolerancë më e madhe ndaj shqiptarëve etnik pasiqë numri i tyre ishte relativisht i vogël dhe nuk kishte ndonjë fushë bashkëveprimi shoqëror ndërmjet malazezëve dhe Shqiptarëve. Dy popullsitë kanë ndarë struktura të ngjajshme klanore dhe tradita, dhe nuk kishte martesat ndërmjet tyre, sidomos në rajonet kufitare. Niveli i asimilimit është aq akut saqë në disa rajone shumë shqiptarë nuk e flasin më gjuhën e tyre amëtare. Sipas një ankete të realizuar kohëve të fundit disa shqiptarë të Malit të Zi iu kanë bashkangjitur partive politike të Malit të Zi dhe disa të tjerë kanë bashkëpunuar me forcat e sigurimit të qeverisë si dhe me Policinë Speciale në monitorimin e popullatës shqiptare.

Në ish- Jugosllavi, shqiptarët e Malit të Zi i kanë ikur shqetësimit të vuajtur nga bashk-kombasit e tyre në Kosovë dhe Maqedoni. Sipas regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të bërë në vitin 2003, shqiptarët përbëjnë 7 për qind të popullsisë së Malit të Zi ndërsa në vitin 1991 shqiptarët përbënin 6.5 për qind të popullsisë, shifra këto që tregojnë për një shtim shumë të vogël të popullsisë. Kjo është njëra nga zonat e ish Jugosllavisë ku Shqiptarët njihen absolutisht si minorite, dhe ku tensionet kanë qenë minimale. Shqiptarët e Malit të Zi kanë shkolla në gjuhën shqipe, gazeta ditore, revista dhe organizata kulturore që funksionojnë në gjuhën shqipe. Radio Podgorica emeton program në gjuhën shqipe e poashtu atje funksionon edhe një stacion televiziv në gjuhën shqipe. Megjithatë, ende ka shumë zona në Mal të Zi në të cilat shqiptarët ndihen të dis-avancuar dhe të diskriminuar. Në saje të numrit të vogël të popullsisë ata nuk presin nga shteti të sigurojnë funksionimin e një univerziteti në gjuhën shqipe, shqiptarët e Malit të Zi besojnë se një kolegji ku mësohet gjuha shqipe do të mund të krijohej vetëm në zonat e banuara me shqiptarë për të trajnuar mesuesit e shkollave fillore dhe të mesme. Tani, është një numër tepër i vogël i mësuesëve të trajnuar të gjuhës shqipe dhe një numër shumë i vogël i studentëve që i vijnë studimet.⁷⁸

Një faktor tjetër që ka shkaktuar fyerje në mesin e shqiptarëve, është edhe konfiskimi i tokave të shqiptarëve, në të cilat janë vendosur sllavët me qëllim të ndryshimit të përbërjes etnike, në veçanti në rajonet kufitare. Sipas Anton Lajçit- profesor në Tuz, 1,200 sllavëve iu janë dhënë banesa dhe janë punësuar në fabrika në tokat e konfiskuara në mes të Tuzit dhe Podgoricës.⁷⁹ Nuk është i pakët numri i atyre rrefyesve të pakënaqur të cilët tregojnë për pronarë të tokave të shqiptarëve të cilëve iu janë konfiskuar tokat nga shteti pa ndonjë kompenzim adekuat. Në përgjithësi, besohet se ekziston një mentalitet i përhapur thellësisht racist në qeverinë e tanishme të Malit të Zi, që të bën të kuptosh se për momentin, në nivelin qeveritar nuk ekziston vullneti që të sigurohen më shumë të drejta politike, ekonomike, dhe kulturore për minoritetin shqiptar. Partitë politike të shqiptarëve në Mal të Zi janë duke

⁷⁸ Shih intervistën me Nailj Draga, MINA –agjension i lajmeve, 20 janar 2004

⁷⁹ “Mali i Zi: Një shtet i aparteidit në zemër të Evropës, Misioni i Lidhjes qytetare Shqiptaro-Amerikane në Mal të Zi me kongresmenin Tom Lantos, të publikuar në shtator , 2003, p. 2

tentuar që të krijojnë një agjendë të përbashkët e cila do të përfashinte kërkesat për emërim të shqiptarëve në pozita të larta të strukturave qeveritare të Podgoricës, si dhe kërkesën për një komunë të ndarë për qytetin me shumicë shqiptare të Tuzit (tani pjesë e komunës së Podgoricës).⁸⁰

Edhe pse disa shqiptarë të Malit të Zi do të dëshironin të siguronin një shkallë të autonomisë, ende ekziston një nivel i ulët i përkrahjes për bashkim politik me Shqipërinë apo Kosovën. Megjithkëtë, tani kur statusi i Malit të Zi mbetet çështje e hapur, shqiptarët e Malit të Zi janë më tepër të preokupuar me përmirësimin e statusit të tyre brenda Republikës. Pasiqë ata përbëjnë një grup të vogël, shqiptarët e Malit të Zi tentojnë që të asocohen politikisht me pjesën muslimane numerikisht më të madhe të cilët përbëjnë rreth 14% të popullsisë së Republikës. Lidhjet kulturore me Shqipërinë janë të forta dhe televizioni shtetëror shqiptar ka ndikim dominant. Shumë shqiptarë të Malit të Zi kanë lidhje familiare me klanet veriore të rajonit të Hanit të Hotit në Shqipëri, sikurse edhe me shqiptarët e Kosovës, dhe në këtë mënyrë këto lidhje kanë qenë në gjendje të luajnë një rol kyç në rritjen e lidhjeve tregtare ndërkufitare dhe nëpërmes liqenit të Shkodrës. Raporte e tyre kohëve të fundit janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme me hapjen e dy vijave të reja kufitare ndërmjet të Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Eksistojnë dy parti politike kryesore shqiptare në Mal të Zi: Unioni Demokratik i Shqiptarëve dhe Aleanca Demokratike e Shqiptarëve. Të dy partitë përkrahin koalicionin udhëheqës të premierit malazës Milo Djukanoviq dhe qëllimin e tij për pavarësi. Shqiptarët e Malit të Zi, tradicionalisht kanë pasur marrëdhënie më të mira me fqinjët e tyre sllav sesa shqiptarët në Kosovë, në Serbinë Jugore apo në Maqedoni. Kjo ka rezultuar në mënyrë parciaisë nga fakti se përafërsisht një e treta e këtyre shqiptarëve janë katolik të Romës duke i mundur popullsisë shqiptare me besim të krishter të veprojnë si një lloj ure në mes të sllavëve ortodoks dhe komunitetit shqiptar me besim musliman. Kjo poashtu paraqitet si rrejdhojë e ngjajshmërive kulturore tradicionale ndërmjet shoqërive malazeze dhe shqiptare.

Liderët shqiptarë në Mal të Zi janë ankuar se qeveria shqiptare iu ka kushtuar më pak vëmendje

në krahasim me shqiptarët në Kosovë. Qeveria shqiptare megjithkëtë ka qenë e interesuar në ndërtimin e lidhjeve më të gjera politike dhe ekonomike me Malin e Zi dhe nuk ka qenë e interesuar që të duket se po ndërhyjnë në çështjet e brendshme të Malit të Zi. Në vend të kësaj, Tirana ka potencuar nevojën e shqiptarëve për t'u përfshirë në procesin e demokratizimit dhe stabilizimit të Malit të Zi. Gjatë vitit të fundit, një numër i iniciativave bilaterale kanë ndihmuar në përmirësimin e raporteve Shqipëri- Mal i Zi. Përveq vijave të reja kufitare, Qeveria Shqiptare ka marrur vendim të ngris numrin e bursave për studentët e Malit të Zi.

Megjithëse e pranojnë se ardhmëria e tyre politike është brenda Malit të Zi, shqiptarët e Malit të Zi poashtu dëshirojnë të forcojnë lidhjet e tyre ekonomike dhe kulturore me shqiptarët e pjesëve të tjera të Ballkanit. Shqiptarët e Malit të Zi janë shumë të interesuar që të shohin një implementim të shpejtë të sistemit arsimor pan-shqiptar. Presidenti i Unionit Demokratik të Shqiptarëve në Mal të Zi Luigj Junçaj thot: “Ne kërkojmë një plan-program të njejtë për të gjithë shqiptarët në Ballkan. Gjuha, literatura dhe historia janë më të rëndësishmet për ne, sepse me këto tri subjekte mund të forcohet dituria për kulturën, trashëgiminë shqiptare dhe vetëdijen kombëtare.”⁸¹ Ky deklaram vjen pas një thirrjeje të bërë vitin e kaluar nga lideri i Unionit Demokratik Shqiptar, Fuad Nimani, i cili për BBC-në tha: “Partia jonë kërkon që programet arsimore të shqiptarëve në Mal të Zi të unifikohen me të gjithë shqiptarët në Ballkan.”⁸²

Edhe pse ekziston një përkrahje e vogël për pan-Shqiptarizmin në Mal të Zi, ka një rritje të dëshirës në mes të shumicës së shqiptarëve në Mal të Zi për një shkallë administrative dhe kulturore të autonomisë të tillë sikurse që e ka gëzuar Kosova sipas kushtetutës jugosllave të vitit 1974. Kjo është potencuar më shumë pas krijimit të federates së re jugosllave të krijuar vetëm nga Serbia dhe Mali i Zi, që është bërë në maj të vitit 2000. Paraprakisht, popullata shqiptare e Malit të Zi ka qenë përkrahëse e fushatës së ish-presidentit Milo Djukanoviq për pavarësi dhe janë përmbajtur nga kërkesat nacionaliste për çështjen e ndieshme për autonomi. Në të vërtetë Djukanoviq ka paralajmëruar për rrezikun e heshtjes së përkrahësve musliman dhe shqiptar pro-pavarsisë në shkrimin e tij në

⁸⁰ Shih “Ferhat Dinosa: Ne do të kërkojmë zyra në shtatë ministri të tjera”, *Publika*, 5 nëntor, 2004

⁸¹ Intervistë e ICG-së me Junçaj, Podgorica, shtator 2000.

⁸² UPI, 13:09, 6 shtator, 1999

Washington Post, “Minoritet muslimane dhe shqiptare gjithmonë kanë qenë pjesë e bllokut demokratik, e kanë parë Malin e Zi si shtet të tyre dhe kanë marrë pjesë në punët e qeverisë për arritjen e pavarësisë. Nëse shumica malazeze favorizon pavarësinë, dhe minoritetet nacionale janë të privuara nga e drejta e deklarimit politik, atëherë do të mund të kemi gjendje të luftës civile në atë shkallë sa që do të mund të destabilizojë edhe Mali i Zi edhe fqinjët e tij”.⁸³

Bërthama e agjitacionit nacionalist vjen nga zonat e banuara gati tërësiht me shqiptarë si Ulqini dhe nga diaspora e këtyre zonave, e cila është e vendosur më së shumti në bregun Lindor të Shteteve të Bashkuara. Mbetet të shihet sesi shqiptarët e Malit të Zi i përgjigjen statusit të vazhdueshëm të tyre si minoritetet në një ri-përbërje tjetër të Jugosllavisë dhe se, sa ata do të mbesin të kënaqur.

B. LUGINA E PRESHEVËS NË SERBINË JUGORE

Lugina e Preshevës është koridori i vetëm kalues veri-jug, që shtrihet ndërmejt maleve të gadishullit Ballkanik, duke paraqitur kështu një rëndësi strategjike për një rajon relativisht të izoluar. Pozita e popullatës etnike shqiptare në Luginën e Preshevës në Serbinë Jugore reflekton jo vetëm tensionet në mes të banorëve shqiptarë të Luginës dhe popullit serb, qeverisë dhe forcave të armatosura, por gjithashtu reflekton tensionet në Kosovën dhe Maqedoninë fqinje nga njëra anë dhe nga agjendat politike të akterëve ndërkombëtar dhe vendor në rajon nga ana tjetër.⁸⁴ Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të popullsisë (2002), shqiptarët përbëjnë shumicën në komunat e Preshevës (90 %) dhe Bujanovc (54.5 %), dhe janë pakicë në komunën e Medvegjës (26%). Edhe pse kanë qenë shumicë në popullsinë e Luginës, në kohën e regjimit të Millosheviqit, shqiptarët kanë qenë të përjashtuar nga punësimi në arsim dhe shëndetësi, kanë qenë të përjashtuar nga kompanitë shtetërore, nga policia dhe nga sektore të tjera publike. Aktualisht, rajoni është relativisht i qetë, edhe pse incidente të herë pas herëshme të izoluara

vazhdojnë të nxjerrin në pah brishtësinë e marrëveshjes paqësore.

Ngjajshëm me pjesë të tjera të Ballkanit, Lugina e Preshevës i është nënshtruar spastrimit etnik gjatë konflikteve të kaluara e më së shumti pas luftës së Dytë Ballkanike (1912), dhe prap gjatë dhe pas Luftës së parë dhe të dytë botërore. Historitë gojore të këtyre ngjarjeve janë përcjellur tek secila gjeneratë dhe kanë grumbulluar radikalizëm në rajon si tek serbët ashtu edhe tek shqiptarët.⁸⁵ Edhe pse trazirat më të reja në Luginën e Preshevës u shfaqën pas luftës në Kosovë në vitin 1999, një vendim i marrur në vitin 1946 nga qeveria jugosllave për të ndarë komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës nga Kosova dhe për t'i vendosur ato nën juridiksionin direkt të Republikës së Serbisë ka krijuar pakënaqësi të cilat vazhdojnë të ndezin pasione tek shqiptarët vendor.

Në mars të vitit 1992, shqiptarët etnik mbajtën një referendum jozyrtar në të cilin ata votuan gati unanimisht për të ri-bashkuar luginën e Preshevës me Kosovën. Menjëherë pas hyrjes së trupave të NATO-s në Kosovë në vitin 1999, shumë forca të sigurimit serb u tërhoqën nga Kosova dhe u vendosën përgjatë kufirit në Luginën e Preshevës. Prezenca e këtyre forcave të sigurisë shumë shpejt rezultoi me një tensionim të lartë dhe me një antagonizëm në mes të serbëve dhe shqiptarëve, e poashtu rezultoi në një varg incidentesh dhe shkeljesh të të drejtave njerëzore. Deri në mars të vitit 2000, mëse 7,000 shqiptarë kanë lëshuar Serbinë Jugore dhe kanë shkuar në Kosovën fqinje dhe në Maqedoni. Në mes të trazirave, një grup i ndarë i UÇK-së që e quante veten Ushtria Çlirimtare për Medvegje, Preshevë dhe Bujanovc, (UÇPMB), filloi të atakonte forcat e sigurimit serb⁸⁶

UÇPMB-ja kishte për qëllim të internacionalizonte gjendjen e vështirë të shqiptarëve në Serbinë Jugore, me synim që të siguronte intervenimin e NATO-s për çështjen e tyre. Ky ishte model që UÇK-ja e kishte përdorur në Kosovë dhe UÇPMB-ja arësyetoi se një metodë e tillë do të mund të

⁸³ *Washington Post*, 20 gusht 2002

⁸⁴ Për një analizë të detajizuar të situatës në Luginën e Preshevës, shih *Paqja e brishtë në Serbinë Jugore*, Raport Evropian i ICG-së N°152, 9 dhjetor, 2003.

⁸⁵ Për hollësi të prejardhjes së tensioneve aktuale në Luginën e Preshevës, shih Bob Churcher, *Kosova Lindore/Presheva, 1999-2002*, Qendra për studime dhe hulumtime të konflikteve, mars, 2002.

⁸⁶ Shih raportin e ICG-së për Ballkan N°116, *Paqja në Preshevë: Përmirësimi i shpejtë dhe zgjidhja afatgjate*, 10 gusht, 2001.

përdorej edhe në Preshevë. Në mes të një numri prej 700 dhe 1,000 pjestarë guerilë të UÇPMB-së filluan të operojnë brenda Zonës tokësore të sigurisë –tri-milëshe (GSZ), e krijuar nga marrëveshja ushtarako-teknike e nënshkruar nga NATO-ja dhe Beogradi në qershor të vitit 1999. Këta guerilë parapëlqyen mbrojtjen *de facto* të miratuar nga dekreti i NATO-s në lidhje me qarkullimin e armëve të rënda brenda kësaj zone. Me eskalimin e luftimeve në pranverën e vitit 2001, dhe me trazirat në Maqedoni, u bë e qartë se kryengritësit shqiptarë në Serbinë Jugore dhe në Maqedoni po shfrytëzonin zonën e demilitarizuar për të zhvilluar sulmet e tyre dhe kontrabandat me armë. Si rrjedhojë, ekstremistët nga të dyja palët në Serbinë Jugore patën për qëllim që të provokojnë njëra tjetrën dhe të shkaktojnë pasoja si në një tërësi ashtu edhe në palën tjetër.

Në mes të marsit dhe majit të vitit 2001, menjëherë pas diplomacisë intenzive të NATO-s dhe SHBA-ve, Bashkësia Ndërkombëtare ndërmjetësoi me një marrëveshje në mes të shqiptarëve dhe serbëve që ka shpër në çarmatimin e UÇPMB-së (Marrëveshja e Konçulit), ri-hyrjen e forcave serbe të sigurimit në zonën e sigurisë, dhe krijimin e komponentës së fuqishme civile të njohur me emrin –Plani i Qoviqit – sipas së cilit do të bëheshin një numër investimesh të rëndësishme ndërkombëtare dhe vendore në Luginën e Preshevës. Plani gjithashtu kishte paraparë caktimin e zgjedhjeve në komunat e përfshira nga konfliktet, si dhe krijimin e një force policore multi-etnike dhe integrimin e shqiptarëve në institucionet publike siç janë administrata qytetare dhe drejtësia.

Që prej nënshkrimit të marrëveshjes së Konçulit, “Plani i Çoviqit” – Plani dhe Programi i Zgjidhjes së Krizave në Komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës është implementuar me ç’rast janë arritur rezultate të përziera. Për të vërtetuar se shqiptarët kishin një përfaqësim adekuat në nivelet lokale, ishin planifikuar të mbaheshin zgjedhjet komunale në rajon si dhe për të vërtetuar se listat e votuesve reflektonin përbërjen reale demografike, një regjistrim i përgjithshëm është bërë dhe mbikqyrur nga OSBE në fund të prillit të vitit 2002. Zgjedhjet – të monitoruara nga OSBE/ODIHR u mbajtën më 28 korrik, 2002 dhe se duket të ishin të drejta dhe të lira. Partia Shqiptare për Veprim Demokratik (PDD) fitoi në komunat e Preshevës dhe Bujanovcit, përderisa një koalicion serb kishte fituar në komunën e Medvegjës.

Plani i Qoviqit kishte arritur një progres në një numër zonash. Ishin formuar njësi multi-etnike, dhe se ishin mbajtur zgjedhjet e reja lokale, përderisa liria e mediave po funksiononte shumë mirë: tani ekzistojnë stacione televizive në gjuhën shqipe dhe shtypshkronja të mediave Ende kërkohen të ndërmerren hapa të rëndësishëm në drejtim të integritetit në fusha të tjera, veçanërisht në drejtësi. Shumë shqiptarë ankohen lidhur me atë që ata e quajnë ngadalshmëri në implementim, veçanërisht lidhur me ekonominë. Edhe pse forcat policore vendore janë bërë multi-etnike, prezenca e tyre është e lënë nën hije nga gjandarmëria serbe dhe nga një prezencë e dukshme e ushtrisë, e simbolizuar me një konstruktivitet të një baze të re. Reformat në arsim dhe ofrimi i shërbimeve të përgjithshme publike duhet të fuqizohen. Rajoni është i varfër dhe i pazhvilluar, me shumë pak mundësi për punësim. Në tërë këtë gjendje, paqja është e brishtë dhe e varur nga donacionet dhe mbikqyrja ndërkombëtare. Ajo poashtu varet drejtpërsëdrejti nga kreu i Qendrës Koordinuese, Nebojsa Qoviq, pozita e së cilit, duke pasur parasysh krizat e tanishme politike në Serbi, mund të mos jetë e sigurt.

Kryengritësit e UÇPMB-së nuk ishin duke luftuar për një Shqipëri të madhe. Në vend të kësaj, ata kishin zgjedhur opcionin për largimin e kontrollit serb dhe për t’u integruar Luginën e Preshevës në Kosovë.⁸⁷ Shfaqja e UÇPMB-së koïncidoi poashtu me rritjen e dhunës në qytetin e ndarë të Mitrovicës në Kosovën Veriore, ku serbët-të hidhëruar nga spastrimi etnik i serbëve nga shqiptarët e Kosovës- filluan të bëjnë *de facto* ndarjen e Kosovës. Shqiptarët e Luginës së Preshevës ishin të vetëdijshëm se ata do liheshin anash gjatë çfarëdo diskutimi për statusin final të Kosovës në të ardhmen, dhe dëshironin që t’u lidhnin fatin e Luginës me Marrëveshjen finale për Kosovën. Si rezultat, Lugina e Preshevës paraqiti një mmonedhë pazarllëku që pati për qëllim kundërbalancimin e përpjekjeve serbe për ndarje të Kosovës.

Shumica nga incidentet e armatosura që ndodhën në Luginën e Preshevës në verën e vitit 2003, u shfaqën si përpjekje për të përfshirë Preshevën në përgaditjen e diskutimeve në mes të Beogradit dhe Prishtinës (tetor 2003). Ata paraqitën problemet e vazhdueshme në rajon, si dhe vështirësitë për

⁸⁷ Shih hartën në Appendix I.

implementimin e planit të Qoviqit. Ata dërguan një mesazh të qartë se edhe Beogradi, edhe komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojnë t'a mbajnë vëmendjen tek Lugina, në mënyrë që aty të krijohet paqe dhe t'a zvogëlojnë tensionin.

Përderisa shumica dërmuese e shqiptarëve në Serbinë Jugore dëshirojnë që të shohin rajonin e tyre të integruar me Kosovën, ata do të preferonin që kjo të bëhet përmes mjeteve politike dhe jo të atyre ushtarake. Ekziston një simpati e vogël për kryengritje të armatosur dhe nuk duket të ketë ndonjë ambicie për ndonjë pan-Shqiptari të madhe në Luginë.⁸⁸ Pasi që fushata e NATO-së e vitit 1999 kundër Serbisë vendosi një protektorat të OKB-së mbi Kosovën, e poashtu pasiqë ekziston mundësia që negociatat për statusin final të Kosovës të rezultojnë në Pavarësi, ri-vendosja e kufinjëve administrativ nuk mbetet çështje e brendëshme e strukturave shoqërore. Në vend të kësaj, ekzistojnë konotacione për ndryshime të kufinjëve ndërkombëtarë. Kjo poashtu paraqet mundësinë që Serbia të humbë më shumë teritore.

Paraqitja e AKSH-së duket të ketë radikalizuar skenën politike shqiptare në Serbinë Jugore. Si rezultat i kësaj, politikat vendore janë bërë më nacionaliste, me më pak hapsirë për manovrimet politike, bashkëpunim apo për kompromis në mes të Beogradit dhe politikanëve shqiptarë të moderuar siç është Riza Halimi i PDD-së. Ekziston një pakënaqësi e dukshme lidhur me ngadalsinë e implementimit të Planit të Qoviqit, poashtu edhe me mungesën e progresit në përmirësimin e gjendjes ekonomike.

Në ndërkohë, shqiptarët e Luginës së Preshevës vazhdojnë të shikojnë përtej maleve në Kosovë ku ata shohin prospektin e një shteti të pavarur të kontrolluar nga shqiptarët, pa ndërhyrje të serbëve. Për ta, kjo është shumë më shumë e rëndësishme sesa çështja e të qenurit minoritet shqiptar në një shtet me shumicë sllave.

C. ÇËSHTJA GREKE

Ekzistojnë dy grupe të shqiptarëve, të formuara shumë heret që jetojnë në Greqi. E para, e njohur si Arvanit, që ka emigruar nga Shqipëria gjatë

shekujve 13 deri 15, duke u vendosur fillimisht në krahinat greke të Peloponezit, ishujt Atika dhe Aegean. Këta emigrant më të hershëm shqiptarë në masë të madhe tani janë asimiluar në popullatë greke. Grupi i dytë, të njohur si Çamët, jetojnë në Greqinë Veri-perëndimore, në afërsi me kufirin shqiptar. Që nga dëbimi i popullsisë myslimane Çame në vitin 1945 nga Greqia, Çamët e mbetur ortodoks poashtu janë asimiluar.

Ekziston poashtu edhe një grup i tretë i shqiptarëve në Greqi, i cili për afërsisht konsiderohet të jetë rreth 400.000, sipas Ministrisë për punë të jashtme të Shqipërisë- të cilët kanë punuar atje si punëtor sezonal dhe rezident që nga viti 1992. Edhe pse shumica e këtyre individëve janë të vendosur në Athinë, komunitetet shqiptare mund të gjenden nëpër tërë Greqinë, përfshirë edhe ishujt. Tani për tani këta punëtorë emigrant nuk janë të organizuar politikisht, por kërkesat e tyre për krijimin e kushteve më të mira për jetesë janë duke u rritur. Ky grup do të dëshironte të kishte punë zyrtare dhe të fitonte leje-qëndrimi, e poashtu do të dëshironte të kishte paga më të mira dhe kushte të përmirësuar për punë duke përfshirë qasjet në mundësitë për sigurim dhe kredi. Këta shqiptarë poashtu ndihen se shpesh janë të kërcënuar nga policia për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe poashtu ata do të donin të formonin shkolla në gjuhën shqipe.⁸⁹ Shkollat shqipe nuk janë çështje të hapura ashtu siç janë në vendet e tjera, sepse, numri i fëmijëve shqiptarë që jetojnë në Greqi mbetet relativisht i vogël dhe atje ka një asimilim të dukshëm. Megjithkëtë, kjo situatë është duke ndryshuar me rritjen e popullsisë shqiptare, me rritjen e numrit të familjeve të cilat iu bashkohen të afërmeve të tyre që kanë qëndrim të përhershëm në Greqi. Shqiptarët në Greqi janë të etur për të mënjeluar insistimet e nacionalistëve vendor të cilëve iu duket se shqiptarët po kërkojnë të drejta të veçanta. Qeveria e Greqisë brengoset në lidhje me potencialin e terrorizmit shqiptar, dhe qeveria ka investuar shumë në ekonomitë e tri vendeve fqinje në veri me qëllim që të promovoj stabilitet rajonal.

Megjithkëtë, numri i familjeve shqiptare që po vendosen në Greqi është duke u rritur. Pa asnjë shkollë në gjuhën shqipe, shumë fëmijë shqiptarë flasin vetëm greqisht dhe nuk janë në gjendje të shkruajnë në gjuhën shqipe. Shumë nga shqiptarët në Greqi mendojnë se është detyrë e qeverisë së

⁸⁸ Intervista të ICG-së me shqiptarë të Preshevës dhe Bujanovcit, mars-nëntor, 2003.

⁸⁹ Intervistë e ICG-së me antarë shqiptarë të komunitetit të Athinës, shtator, 2001.

Shqipërisë që t'i prezentoj më mirë interesat e tyre në Greqi. Ata kanë potencuar se pa përkrahje më të fortë nga ana e Qeverisë së Shqipërisë, ata nuk do të kenë zgjidhje tjetër pos të krijojnë forumet e veta politike, të cilat si rezultat do të tërheqin vëmendjen e elementeve politike shqiptare kudo në Ballkan. Partitë kryesore politike të Shqipërisë dhe Kosovës –Partia Socialiste, Partia Demokratike dhe Partia Demokratike e Kosovës tanimë kanë formuar zyrat e tyre në Greqi.

Fokusimi qendror i këtyre grupeve politike ka qenë ngritja e profileve të tyre në vendet amë duke krijuar përkrahje solide në mes të numrit në rritje të shqiptarëve që jetojnë në Greqi. Aktivistët e Partive kanë ndihmuar për të ngritur dhe legjitimuar kërkesat e grupeve të ndryshme emigrante-shqiptare, për përmirësimin e të drejtave të njeriut e poashtu edhe për ri-definimin e çështjes Çame. Çamët janë popullatë shqiptare e rajonit të Verilindjes së Greqisë, i njohur për shqiptarët si Çamëria.⁹⁰ Ndërmjet të viteve 1921 dhe 1926, qeveria greke ka deportuar shqiptarët musliman nga Çamëria, në mënyrë që tokat e tyre t'ua jipte grekëve të cilët ishin deportuar nga Minori i Azisë gjatë revolucionit të Kemal Atatürkut. Më vonë, në vitin 1944, Qeveria greke bëri një masakër në rajon me ç'rast 35,000 Çamë u dëbuan për në Shqipëri dhe Turqi. Autoritet greke mëpastaj aprovuan një ligj për sanksionimin e shpronësimit të pasurisë së Çamëve duke cituar bashkëpunimin e këtij komuniteti me forcat okupuese gjermane. Ky ligj mbetet në fuqi edhe sot. Megjithëse zhvendosja e dhunëshme e popullatës në tërësi në mesin e shqiptarëve ka lënë një ndjenjë të vazhdueshme të padrejtësisë së ushtruar ndaj shqiptarëve në përgjithësi, prap se prap asnjë qeveri shqiptare e pasluftës nuk e ka vendosur çështjen Çame në rend të ditës së politikës së jashtme me Athinën. Sot, çështja Çame nga shumë shqiptarë është parë si edhe një tjetër mospërfillje –çështje e pa -adresuar e historisë, dhe se një gazetar shqiptar e ka barazuar gjendjen e vështirë të çamëve me atë të palestinezëve: “Disa nga ata, ende i kanë çelësat e shtëpive të tyre. Ata nuk do të jenë në gjendje të harrojnë prej nga erdhën, dhe se ne gjithashtu nuk duhet të harrojmë”.⁹¹

V. EMIGRANTËT, IDENTITETI DHE FUQIA E DEMOGRAFISË

A. DIASPORA: POLITIKA DHE KRIMI

Kryengritjet e shqiptarëve që kanë vepruar gjatë gjashtë viteve të fundit, janë mbështetur fuqimisht për përkrahje politike, morale dhe financiare në një milion emigrant shqiptarë. Diaspora shqiptare ka pasur jehonë në shtruarjen e temave lidhur me padrejtësitë historike që iu janë bërë shqiptarëve, dhe gjithashtu me vigjilencë kanë avansuar argumentin se “kombi” shqiptar është ndarë në mënyrë të padrejtë. Komunitetet më signifikante të emigrantëve gjinden në SHBA, Gjermani dhe Zvicërr. Aktualisht në SHBA vlerësohen të jenë 400,000 shqiptarë, 350,000-400,000 shqiptarë që jetojnë në Gjermani dhe rreth 160,000 në Zvicërr. Numri i shqiptarëve në Turqi vlerësohet të jetë më shumë se 1 milion, por shumica prej tyre janë asimiluar dhe se shumë prej tyre vetëm tani së voni kanë filluar t'i ri-përtërijnë kontaktet me Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë. Kanë ekzistuar gjithashtu komunitete shqiptare në Greqi dhe Itali që nga kohërat e Mesjetës, por ato kanë filluar të dalin në skenë dhe të zgjerohen vetëm pas kollapsit të shtetit një-partiak të Shqipërisë më 1991. Komunitete më të vogla gjithashtu ekzistojnë në Belgjikë, Mbretërinë e Bashkuar, Skandinavi, Holandë dhe Francë.

Megjithëse ekzistojnë relacione të ngushta në përgjithësi në mes të shqiptarëve në diasporë që vijnë nga vende të ndryshme të Ballkanit, ekzistojnë tensione të ngritura të herëpashërëshme në mes të shqiptarëve nga Kosova dhe shqiptarëve nga Shqipëria. Në një anketë të Bankës Botërore të diasporës kosovare në Gjermani, shumë shqiptarë të Kosovës kanë pohuar se shqiptarët e Shqipërisë ishin përgjegjës për imigjin e krijuar për shqiptarët në shtetet perëndimore- për një shprehje të përhapur kriminale lidhur me shqiptarët në përgjithësi. Në mes të dy grupeve, ekzistojnë gjithashtu ndryshime politike, disa prej tyre shumë të thella.⁹²

Është vlerësuar gjithashtu se para vitit 1941, diku rreth 200,000 dhe 300,000 shqiptarë ishin detyruar të emigronin nga Jugosllavia për shkak të humbjes

⁹⁰ Një zonë e Epirit e zgjeruar në mes të Butrintit dhe grykës së lumit Acheron River dhe vazhdon në drejtim të lindjes deri në malet Pindus.

⁹¹ Intervista me Ilir Haxhiun, Tiranë, maj, 2002

⁹² Raport i bankës botërore, “Diaspora kosovare e shqiptarëve në Gjermani”, Barbara Balaj, 2000

së tokave të tyre gjatë periudhës së kolonizimit, me ç'rast shumica kanë shkuar në SHBA dhe Turqi.⁹³ Më vonë, shqiptarët u shpërngulën nga Jugosllavia gjatë viteve të 60-ta, për të ikur nga persekutimet e policisë sekrete të Alexander Rankoviçit, mëpastaj prap pas viteve 1981 dhe 1989, gjatë trazirave në Kosovë, dhe më së voni gjatë epokës së Pushtetit të Millosheviçit. Edhe tani një numër i madh emigrantësh u vednosën në SHBA, dhe gjithashtu një numër i madh i tyre shkuan në Gjermani dhe Zvicër.

Pikërisht në përbërjen e këtyre komuniteteve mund të gjindet shkalla më lartë e entuziazmit dhe mbështetjes së organizative për pan-Shqiptarizëm. Një argument i tillë bazohet në dy faktorë: Pikësëpari për arsye se këto komunitete janë themeluar qysh më heret dhe se janë komunitete relativisht më prosperuese në krahasim me grupet më të varfëra të komuniteteve të krijuara më vonë siç janë ato në Greqi, Itali dhe vende të tjera të Evropës. Së dyti, emigrantët në SHBA, Gjermani dhe Zvicër kanë prejardhje nga ish-Jugosllavia, përderisa pjesa më e madhe e diasporës shqiptare e vendeve të tjera ka përbërje të qytetarëve të Shqipërisë, të cilët gjatë dekadës së fundit kishin shkuar për të kërkuar punë. Grupi i fundit mund të konsiderohet si grup punëtorësh emigrant sezonal të cilët kthehen shpesh në Shqipëri ku vazhdojnë të jetojnë familjet e tyre.

Përkundër kësaj, shqiptarët në New York, Stuttgart dhe Zurich janë shpesh gjenerata e dytë ose e tretë e shqiptarëve të komuniteteve përkatëse, të cilat kanë qenë në gjendje të krijojnë organizata sociale, kulturore dhe politike të themeluara mirë. Organizatat e tilla më me ndikim janë Këshilli Nacional Shqiptaro-Amerikan (NAAC) dhe Lidhja Qytetare Amerikano-Shqiptare e cila ishte themeluar në vitin 1986, dhe e cila kishte për qëllim që të bashkonte grupe të ndryshme, me ndikim, Shqiptaro-Amerikane për të zhvilluar fushatë në emër të shqiptarëve në Jugosllavi me qëllim që të tërhiqej vëmendja e Kongresit amerikan për Kosovën. Këto organizata kanë qenë aktive në lobimin, financimin dhe debatimin e gjerë të çështjeve pan-shqiptare. Por edhe në mesin e këtyre grupeve me nam, është tepër e pazakont të dëgjohet

që deri më tani ndokush të ketë ngritur çështjen e bashkimit të të gjitha territoreve të banuara me shqiptarë. Në vend të kësaj, si çështje primare vlerësohet të jetë përqëndrimi në ndikimin për pavarësinë e Kosovës, aktualisht qëllimi i vetëm më i rëndësishëm i diasporës shqiptare.

Diaspora shqiptare ishte një element vendimtar i radikalizimit të politikës shqiptare të Kosovës. Shumë nga këta radikalist të cilët kishin përjetuar dhunë nga autoritetet jugosllave, shkuan jashtë vendit ku formuan grupe të reja politike përballë horizontit të Lidhjes konzervative Demokratike të Kosovës të dominuar nga Ibrahim Rugova. Këto grupe që vepronin jashtë, siç ishte Lidhja Popullore e Kosovës, luajtën një rol kyç në themelimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe në njërën apo mënyrën tjetër këto grupe kishin lindur në diasporë.⁹⁴

Pa mbështetjen e diasporës do të ishte vështirë që kryengritësit në Maqedoni, Serbinë Jugore dhe Kosovë të financonin operacionet e veta. Në SHBA, ekziston një lob i fuqishëm i shqiptarëve me seli në Capitol Hill, dhe organizatat shqiptare në mënyrë efikase kanë zhvilluar ndikim tek Kongresi nëpërmjet të një rrejtë të ngjeshur të kontakteve, parasëgjithash në Partinë Republikane. Grupet e emigrantëve janë gjithashtu thellësisht të ndara përgjatë linjave politike dhe ekonomike të cilat shpesh sjellin përçarje për rajonin. Lidhja Demokratike e Kosovës, për shembull vepron nëpërmjet të Federatës amerikane pan-Shqiptare - Vatra, përderisa Lidhja Qytetare Shqiptaro-Amerikane është e lidhur më afër me presidentin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinajn.

Konflikti në Kosovë shkaktoi ndarje të mëdha në komunitetet në diasporë ndërmjet të përkrahësve të Ibrahim Rugovës dhe Hashim Thaçit. Në Gjermani p.sh. pjesa më e madhe shqiptarëve të Kosovës para vitit 1999 kishin përkrahur Rugovën. Gjatë luftës, sidoqoftë, komuniteti ishte ndarë përfundimisht haptazi për shkak të përkrahjes për Rugovën ose Thaçin, dhe për më keq kishte edhe grindje ndërmjet të përkrahësve të të dy fraksioneve. Klube të tëra shqiptare ishin ndarë gjatë luftës dhe disa kanë mbetur të tilla edhe sot e kësaj dite. Që prej përfundimit të luftës, pjesa më e

⁹³ Zamir Shtylla, *Analizë historike e Kosovës*, no. 3, Tiranë, 1994, p. 20. Duhet të theksohet se historian të tjerë kanë vlerësuar se kjo ka pasur numër më të vogal; Noel Malcolm, për shembull sygjeron se 90,000 deri në 150,000 e kanë lëshuar Kosovën gjatë kolonizimit.

⁹⁴ James Pettifer, *Ekonomia dhe shoqëria e Kosovës pas vitit 1945*, Qendra për hulumtime dhe studime të konfliktit, mars 2002

madhe e shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në vende të tjera vazhdojnë të përkrasin Rugovën.⁹⁵

Portretizimi më i madh i grupeve të diasporës është Këshilli Nacional Shqiptaro-Amerikan (NAAC), i cili ka provuar që të ushtroj një ndikim të moderuar në mesin e fraksioneve të ndryshme politike, veçanërisht në Kosovë. Në fillim të vitit 2002, NAAC iu bëri thirrje liderëve shqiptarë të Kosovës për koncesione me qëllim të krijimit të qeverisë së Kosovës. Në një deklaratë, Këshilli deklaroi se është koha e fundit që liderët e Kosovës të harrojnë interesat e tyre personale dhe të bashkëpunojnë në krijimin e një qeverie stabile.⁹⁶ Kjo, megjithatë është fytyra e pranueshme e politikës së ushtroar në diasporë. Prapa skenës, një numër nacionalistësh vazhdojnë të veprojnë dhe ata janë të gatshëm të kenë ndikimin politik në NAAC dhe AACL, përderisa përqëndrohen në planet strategjike dhe logjistike të vazhdimin të luftës në Ballkan. Këto grupe mbajnë takime të rregullta lidhur me ngritjen e fondit për luftë të armatosur, dhe në të njëjtën kohë ato i koordinojnë veprimet e tyre me njerëzit në rajon. Faktor kryesor dhe motivues për radikalizim në mesin e këtyre grupeve është arsyeja se shumë nga këta veprimtarë kanë kaluar kohë nëpër burgjet jugosllave për veprimtari nacionaliste ose kanë pasur një të afërm të burgosur ose të vvarë nga forcat jugosllave të sigurimit. Për këta njerëz, ende duhet të bëhen llogaritë kryesisht për shkak të dëshirës së tyre që djeg në shpirt për të arritur pavarësinë e Kosovës.

Diaspora gjithashtu ka mbjellur farën e grupeve kriminale. Problemi lidhur me ekzistimin e grupeve të organizuara kriminale në Evropën Perëndimore, është bërë tani më i njohur dhe serioz. Sipas Europolit, këto grupe janë të përfshira në trafikimin e njerëzve si dhe në kontrabandën me drogë, si dhe janë “avansuar” nga thjesht, të qenurit furnizues dhe ofrues të shërbimeve në posedues, zakonisht nëpërmjet përdorimit ekstrem të dhunës.⁹⁷ Është shumë e qartë se këto përfitime fitimprurëse dhe ilegale shkojnë më parë në drejtim privat dhe personal të

“bosëve” kriminelë sesa që përdoren për qëllime politike. Fakti që përfshirja e shqiptarëve të Kosovës në tregtinë me drogë u publikua në të njëjtën kohë kur kriza në Kosovë e kishte arritur kulmin ishte parë si domethënëse nga shumë komentues të ngjarjeve; ishte një numër i madh (jo të gjithë) përjashtuar ata që kishin studiuar çështjen. Paul Hockenos, për shembull konkludon se “burimet dominuese të parave dhe armëve të UÇK-së nuk vinin nga kriminelët e kohës por vinin nga popullata e diasporës së cilës, politika e Millosheviqit në Kosovë i kishte mohuar të drejtën elementare për jetë dhe votë.”⁹⁸ Ndiheja jashtë për vendosjen e rendit dhe të ligjit ka një prioritet të lartë; Misioni të policisë së Unionit Evropian aktualisht ka edhe në Maqedoni, edhe në Bosnje dhe Hercegovinë.

Megjithë ekzistimin e vullnetit politik në rajon,⁹⁹ trafikimi i njerëzve do të jetë vështirë të ç’rrenjose tërësisht përderisa BE t’u lejoj kriminelëve që të thyejnë ligjin mbi emigracionin. Do të ishte e favorshme që të adresohet problemi i dyfishtë i Evropës Lindore lidhur me punësimin jo të mjaftueshëm dhe bilancin e popullatës, aftësinë për punë në përgjithësi në Ballkan duke bërë libelarizimin e dhënies së vizave. Kjo do të ishte e mundur të vendoset në një rënë anë dhe në anën tjetër duhet të punohet në drejtim të aplikimit të sistemit të plotësimin të administratës nacionale në vendet përkatëse në mënyrë që të arrihet kualifikimi për çasje në marrje të lirë të vizave në BE. Në të njëjtën kohë, skemat ekzistuese lidhur me marrjen e vizave për një afat të shkurt ose të mesëm, pa marrë parasysh a ekziston afati i tillë për studime apo për punësim, duke përfshirë këtu edhe punësimin në vet institucionet e BE-së –do të duhej të libelarizoheshin.¹⁰⁰ BE ka filluar të lëvizë në këtë

⁹⁵ Anketa e bankës botërore: Diaspora kosovare e shqiptarëve në Gjermani, nga Dr. Barbara Balaj, 2000

⁹⁶ *Monitorimi i OSBE-së*, 16 janar, 2002.

⁹⁷ Europol’s 2003 Raport mbi krimin e organizuar i BE-së f. 14, përmend kriminelët shqiptarë të organizuar në grupe kriminale nga pjesë të tjera të ish-Jugosllavisë, Rusisë, Turqisë, Nigerisë, Marokut, Colombisë, Kinës dhe Vietnamit “si kërcënime kryesore ndaj BE-së.”.

⁹⁸ Hockenos, *Hvendlindja thërret*, f. 255; shih gjithashtu Tim Judah, *Kosovo: Lufta dhe hakmarrja*, f. 70.

⁹⁹ Departamenti i shtetit i SHBA-ve, qershor, 2003 Raport mbi trafikimin e njerëzve deklaroi se përderisa qeveritë e Shqipërisë, Serbisë dhe Malit të Zi nuk kanë plotësuar as minimumin e standardeve për eliminimin e trafikimit, ato nuk janë duke u orvatur shumë për të arritur këtë; Qeveria maqedone duket të jetë e pajtuar me “Veprimin për mbrojtjen e viktimave të trafikuar” të SHBA-ve të vitit 2000, lidhur me minimumin e standardeve të kërkuara.

¹⁰⁰ Shih raportin e ICG-së për Ballkan *Thessaloniki dhe më pas I: Agjenda ballkanike e BE-së*, 20 qershor 2003, dhe gjithashtu raportin Fabian Society/Oxfam nga Russell King, Nicola Mai dhe Mirela Dalipaj, *Explotimi i migrimit të miteve: Analizat dhe rekomandimet e BE-së, Mbbretëria e bashkuar dhe Shqipëria*, (Londër dhe Oxford, 2003).

drejtim duke bërë hapjen e disa programeve këmbëse arsimore, por mund të bëhet dhe duhet të bëhet më shumë.

B. DIMENZIONI DEMOGRAFIK

Debati lidhur me shkallën e lartë të lindshmërisë të popullatës shqiptare ishte çështje kryesore lidhur me konfliktin në Kosovë, dhe kjo temë gjithashtu është shfaqur aktualisht në debatet në Maqedoni. Gjashtë milion shqiptarë etnik të Evropës Jug-lindore janë një popullatë e re, me lindshmërinë më të lartë në Evropë –një kontrast i shënuar me moshën dhe shkallën e ultë të lindshmërisë në vendet fqinje në Ballkan veçanërisht në Italinë fqinje. Për një kohë të gjatë, fqinjët ortodoks të shqiptarëve kanë pohuar se shkalla e lartë e lindshmërisë tek shqiptarët paraqet një plan të përbashkët sistematik për pushtimin e territoreve me formën e “bombës popullzuese”. Realiteti është më kompleks, dhe se shkalla e lartë e lindshmërisë vjen më shumë si pasojë e mungesës së zhvillimeve ekonomike dhe arsimore sesa si pasojë e ndonjë shkakut tjetër. Në shumicën e studimeve të mënyrave globale të popullzimit njerëzor, është zbuluar se faktorë kryesor në përcaktimin e madhësisë së familjes është niveli i arsimimit të gruas. Faktorë e tjerë, janë të lidhur me zonat rurale dhe banorët që jetojnë atje në krahasim me ata të zonave urbane, përkatësitë religjioze, dhe në përgjithësi zhvillimi ekonomik i një rajoni të caktuar. Ballkani jugor nuk duket të jetë i përjashtuar nga këto trende të përmendura më lart.

Gra të arsimuara nga Prishtina, mesatarisht kanë shumë më pak fëmijë sesa gratë nga vendet rurale. Ngjajshëm, një grua e arsimuar nga Tirana, ka mesatarisht 2.7 fëmijë, krahasuar me mesataren e fëmijëve të familjeve më të varfëra të fshatrave të rajonit të veri-lindjes së Shqipërisë ku në mesatarisht një familje ka gjashtë-shtatë fëmijë.¹⁰¹ Përkatësia religjioze gjithashtu luan një rol me rëndësi që ndikon në madhësinë e familjes. Shqiptarët e besimit Musliman kanë shkallë më të lartë të lindshmërisë në krahasim me ata të besimit Katolik të cilët kanë më shumë fëmijë se sa shqiptarët e besimit Ortodoks. Thënë shkurt, kurr nuk ka ekzistuar një konspiracion ndër-kombëtar në mesin e shqiptarëve lidhur me lindjen e shumë fëmijëve për të fuqizuar përkatësinë e një teritori të caktuar. Në vend të kësaj, numri i fëmijëve që ka një grua shqiptare përcaktohet ashtu si në çdo vend

tjetër të botës, nga niveli i arsimimit, përkatësia religjioze dhe nga vendet rurale apo urbane të banimit. Në ish-Jugosllavi zonat e banuara me shqiptarë jo vetëm që ishin zonat më të pa-zhvilluara ekonomikisht, por ato gjithashtu ishin edhe zonat me më së paku arsimim. Shqiptarët filluan të arsimohen më shumë vetëm nga fundi i viteve 1960, dhe të gjitha statistikat që nga viti 1970, tregojnë një rënie të shkallës së lindshmërisë së shqiptarëve.

Askund çështja e lindshmërisë nuk është më e diskutuar se sa në Maqedoni, ku politika demografike është një çështje më një rëndësi shumë të madhe politike. Në regjistrimin e popullatës së vitit 1994, Sllavët maqedonas kanë përbërë 66.7 përqind ndërsa popullata shqiptare 22.7 përqind. Por shqiptarët të cilët vazhdojnë të jetojnë në një shoqëri tradicionale dhe konzervative në të cilën gratë shumë rrallë punojnë, vazhdojnë të kenë një shkallë të lartë të lindshmërisë. Në një raport të Fondit për fëmijë të Kombeve të Bashkuara, shkalla e lindshmërisë për shqiptarët në vitin 1994, ishte 2.7 për 100 njerëz të popullatës, përderisa ishte vetëm 1.3 për pjesën tjetër shumicë. Statistika të sakta është shumë vështirë për të siguruar (dhe se ende nuk janë prezentuar shifra nga regjistrimi i fundit në Maqedoni i zhvilluar në vitin 2002), por maqedonët duket qartë të jenë shumë të brengosur për arësye të mundësisë ekzistuese që të bëhen minoritet në vendin e tyre.

Sipas Pande Lazarevskit të Institutit për Sociologji, Politikë dhe hulumtime të drejtësisë, investimi në gratë –nëpërmjet të dhënies së mundësive lidhur me arsimimin dhe zhvillimin ekonomik të tyre, do të rezultonte në një zgjidhje paqësore e cila përfundimisht do të sillte përfitim për të gjithë maqedonët. Ai vazhdon se “Ajo që përballemi ne tani është gjetja e mënyrës së luftimit të një shoqërie tradicionale, se si t’i çlirojmë dhe mësojmë gratë shqiptare që mos të jenë vetëm makina të lindjeve.”¹⁰² Në një artikull të kohëve të fundit lidhur me atë se si shkalla e lindshmërisë së shqiptarëve është duke demoralizuar sllavët maqedon, një grua shqiptare përshkruan se si menjëherë pas lindjes së vajzës së sajë të tretë ajo menjëherë do të provonte të lindëte edhe një djalë. “Djemtë bëjnë që familja të vazhdojë të ekzistoj”, - kishte deklaruar ajo “Vajzat i bëjnë familjet e tjera të vazhdojnë të ekzistojnë.”¹⁰³

¹⁰¹ Shifrat nga regjistrimi i përgjithshëm në Shqipëri në vitin 2001

¹⁰² *The New York Times*, 11 gusht, 2001.

¹⁰³ *Ibid.*

B. INTEGRIMI EKONOMIK

Hapja e kufirit në mes të Shqipërisë dhe Kosovës në vitin 1999, ka pasur një ndikim dramatik në rrethinat e afërta, duke ri-paraqitur në skenë një numër të konsideruar të çështjeve tregtare. Zona për-rreth Kosovës p.sh. qyteti i Gjakovës, tradicionalisht ka pasur lidhje të ngushta ekonomike me Shqipërinë veriore, duke përfshirë edhe bagëtinë, lëkurën dhe tregëtinë e metaleve. Prishja e marrëdhënieve në mes të Titos së Jugosllavisë dhe Enver Hoxhës së Shqipërisë i prishi njëkohësisht edhe këto lidhje ekonomike duke ndarë të dy këto pjesë të hapsirave rajonale ekonomike nga njëra tjetra. Sidoqoftë, brengat e paraqitura lidhur me kalimin e kufirit të ekstremistëve dhe kontrabandës kanë bërë UNMIK-un që të jetë i ngadalshëm në hapjen më të shpesht të kufinjëve.¹⁰⁴

Liderët shqiptarë kanë ndërmarrë një numër të iniciativave socio-ekonomike me qëllim të përmirësimit të tregtisë në mes të Shqipërisë dhe, dhe se Shqipëria shpreson se rrethet e sajë të varfëra të Veri-lindjes do të përfitojnë nga biznesi i rritur me Kosovën Duke qenë në dijeni se prosperiteti ekonomik i Shqipërisë Veriore varet nga një kufi më i hapur në mes të Shqipërisë dhe Kosovës, Qeveria shqiptare është duke bërë ç'është e mundur që të bëjë lidhjen e Shqipërisë me Kosovën nëpërmjet të vijës hekurudhore dhe asaj rrugore. Iniciativa të tilla gjithashtu janë ndërmarrë me qëllim të pakësimit të lidhjeve komunikuese dhe tregtare të Kosovës me Serbinë dhe Malin e Zi.

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, Kryeministri shqiptar Pandeli Majko vuri në rend të ditës zhvillimin e lidhjeve në mes të Shqipërisë dhe Kosovës si çështje më prioritetin më ta lartë, dhe që nga ajo kohë kjo agjendë ka mbetur në qendër të agjendave të Shqipërisë. Shqiptarëve nga Shqipëria dhe diaspora u është kërkuar që të depozitojnë të holla në një konto të veçant me qëllim të dhënies së ndihmës për ndërtimin e rrugës 350-kilometërshe ndërmjet portit shqiptar të Durrësit dhe Prishtinës, vijë kjo e cila do të lidhte Tiranën dhe Prishtinën nëpërmjet vijës kufitare që kalon në Morinë dhe në vijën kufitare të veriut të

Shqipërisë. Porti shqiptar i Durrësit gjithashtu i është ofruar Kosovës si një qytet porti i sajë, i lirë nga Beogradi. Fondi Shqiptar për Zhvillime gjithashtu ka financuar ndërtimin e rrugës 6.5-kilometërshe që do të lidhë veri-lindjen e Shqipërisë me qytetin Gjakovës në Kosovë. Vija hekurudhore 200 milion-dollarëshe që do të lidhë portin shqiptar të Durrësit me qytetin e Prizrenit në Jugun e Kosovës, është gati duke u përfunduar. Një bashkëpunim i madh SHBA-ve ka sjellur nënshkrimin e një numri të kontratave për ndërtimin e vijës hekurudhore Durrës-Tiranë.

Menjëherë pas vizitës së Kryeministrit Ilir Meta në Kosovë, në dhjetor të vitit 2000, gjatë së cilës u diskutua lidhur me forcimin e lidhjeve ekonomike, kulturore dhe arsimore në mes të dy vendeve, janë ndërmarrur iniciativa të tjera ekonomike që kanë të bëjnë me kalimin kufitar. Akademia e Shkencës së Shqipërisë ka përpiluar një plan të përbashkët që do të kurajonte zhvillimin e tregëtisë në vijën kufitare, pra një projekt të përbashkët ekonomik –Shqipëri-Kosovë. Gjatë dy viteve të fundit, kompanitë shqiptare kanë vërshuar në tregun kosovar, duke përfshirë edhe kompanitë e sigurimit, firmat e ujit mineral të Tepelenës dhe Glinës, vijat ajrore shqiptare të cilat tani veprojnë në Prishtinë. Qeveria shqiptare gjithashtu ka për qëllim që të blejë energji nga Kosova nëpërmjet të prokurimit direkt, dhe të ndërtoj një rrejt të ri të telekomunikimit në mes të Shqipërisë dhe Kosovës.

Ekspozita e madhe Panaida që reklamon prodhimet shqiptare, e cila gjatë gjashtë viteve të fundit është mbajtur në Tiranë, tani e tutje do të fillojë të hapet në Tiranë dhe pastaj do të kalojë në qytetin e Kosovës jugore, në Gjakovë. Gjakova është zgjedhur si zonë e re ekonomike në pjesën më të madhe për shkak të përmbajtjes së potencialit të sajë për privatizim.¹⁰⁵ Në maj të vitit 2001, Shqipëria dhe Kosova kanë nënshkruar një memorandum të bashkëpunimit ekonomik, me qëllim të liberalizimit të tregut dhe fillimit të bashkëpunimit institucional.

Shikuar nga prespektiva e Shqipërisë, të gjitha iniciativat e lartëpërmendura pan-Shqiptare janë të dizajnuara pikësepari për të ngritur prosperitetin ekonomik të Shqipërisë. Në këtë frymë, Shqipëria vazhdon të shohë kufizimet në kalimet kufitare si një

¹⁰⁴ Për zhvillimin e diskutimeve lidhur me zhvillimin e ekonomisë së Kosovës shih: James Pettifer, "Kosova – Shoqëria dhe ekonomia pas vitit 1945", Qendra për hulumtime dhe studime të konfliktit, mars, 2002.

¹⁰⁵ Regjioni i Gjakovës është zgjedhur si rajon prove në Kosovë për zhvillimin e ndërmarrjeve të fabrikave të pavarura në kohën e Markoviqit, në fund të viteve 80-të.

pengesë për një prospekt më të gjerë. Nga perspektiva e Kosovës, taksat e larta kanë imponuar që përmes hyrjes së mallërave në provincë të inkurajojnë edhe kontrabandën dhe aktivitetet e tjera ilegale. Një pjesë e madhe e suksesit të iniciativave ekonomike ndërkuftare përfundimisht do varen nga sukcesi i ri-ndërtimit të Kosovës, përpjekje kjo që deri më sot ka ngecur

C. LIDHJET KULTURORE

Plani për inegrimin socio-kulturor të shqiptarëve në Ballkanin Jugor bëhet gjithnjë e më energjik, dhe procesi i “unifikimit” të sistemeve arsimore të Shqipërisë dhe Kosovës është duke shkuar mirë. Bashkëpunimi i univerziteteve të Tiranës, Prishtinës dhe Tetovës është duke u intensifikuar me shkëmbimin e vazhdueshëm të stafit mësimdhënës si dhe me përpjekjet e përbashkëta punuese dhe hulumtuese në kërkim të një kurikulumi dhe plani të përbashkët ndër-univerzitar. Lëvizjet në drejtim të përfshirjes së plan-programeve arsimore të shqiptarëve etnik në Mal të Zi janë gjithashtu në rrugë të mirë. Në njëfarë forme, ky integrim arsimor është alternativë kulturore e nocionit territorial të një Shqipërie të madhe.

Në verën e vitit 1999, në vigjilie të krizave nga refugjatët Kosovar në Shqipëri, qeveria shqiptare ka ofruar mundësinë e shkëmbimit të përvojave në arsim me Kosovën, si një hap përpara në drejtim të unifikimit kulturor të të dy etniteteve shqiptare. Ethem Ruka, ish ministër i atëhershëm i arsimit I ka thënë homologut të tij në qeverinë e përkohshme të Kosovës se lidhja e Tiranës ka paraparë një investim lidhur me bashkëpunimin ndërmjet sistemeve shkollore të Kosovës dhe Shqipërisë si pjesë e “strategjisë afatgjate të shtetit tonë”.¹⁰⁶

Menjëherë pas konferencës për arsimin pan-shqiptar të mbajtur në Tiranë në qershor të vitit 2000, Ruka bëri thirrje për një përdorim të një gjuhe të vetme shqipe në shkollat fillore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi, në mënyrë që të përkrahet zhvillimi i një gjuhe standarde shqipe. Ruka u tha gjuhëtarëve se “libri i unifikuar i gjuhës shqipe do të ishte një gurë-themel për bashkimin gjith-kombëtar”¹⁰⁷ Nuk është

për t’u habitur që qëndrimet e tij shumë shpejt shkaktuan frigë se arsimimi paraqet hapin e parë të përpjekjeve nacionaliste për krijimin e Shqipërisë së madhe. Ruka, zëshëm mohoi çdo lloj tentative të kësaj natyre, dhe shumë zyrtarë të Arsimit shqiptar dhe linguist e shohin propozimin për tekste librash të përbashkëta për shkollat fillore si pjesë të traditës që filloi në vitin 1970, me qëllim të standardizimit të gjuhës. Ekzistonte gjithashtu një nevojë urgjente për t’u furnizuar Kosovën me material arsimor, dhe gjuha standarde shqipe tani është në përdorim gjithandej nëpër shkollat shqipe nëpër tërë Ballkanin.

Tendenca për të bërë libra të përbashkët nga lënda e historisë është treguar si më e vështirë. Historia është një përmbledhje në të cilën shqiptarët paraqesin imigjin, jo vetëm të identitetit të tyre nacional por poashtu edhe perceptimin real të padrejtësive historike. Periudha që nga viti 1939 e tutje ka vërtetuar se kjo çështje është veçanërisht e ndërlikuar. Në Shqipëri kjo është reflektuar në tekste librash të ndryshëm të historisë të botuara në periudhën komuniste (1944-1991), në kohën e regjimit të Sali Berishës dhe të Partisë Demokratike (1992-1997) dhe aktualisht në kohën e udhëheqjes socialiste.

Për shembull, librat e historisë të sistemit komunist kanë paraqitur Luftën e Dytë Botërore si heroizëm të luftës partizane kundër pushtuesit fashist dhe i kanë paraqitur si kolaboracionistë-tradhtarë shqiptarë – krahun e djathtë – Ballin Kombëtar dhe monarkistët. Menjëherë pas rënies së shtetit njëpartiak, Partia e re Demokratike shkatërroi tekstet komuniste dhe botoi tekste të korigjuara në të cilat Balli Kombëtar dhe Legaliteti paraqiten si lëvizje patriotike ndërsa keqinterpretuoi partizanët komunist. Tekstet e tanishme të historisë të botuara pas rënies së regjimit demokratik në vitin 1997, kanë tentuar të paraqesin një gjendje më të balancuar të kësaj periudhe kontraverze. Një libër i ri i historisë, i titulluar *Historia e Shqipërisë dhe shqiptarëve* është publikuar kohëve të fundit në Prishtinë dhe ka për qëllim që të përdoret në të gjitha shkollat shqiptare nëpër tërë Ballkanin. Libri ka të bëjë gjerësisht me çështjet që kanë të bëjnë krijimin “e padrejtë” të kufinjëve të Shqipërisë dhe me dëbime, trazira, kryengritje dhe demonstrata të cilat përfshijnë shqiptarët e ish-Jugosllavisë. Aty përshkruhet edhe dëbimi i shqiptarëve mysliman nga Greqia veriore e poashtu ai libër përmbanë edhe hartat që sqarojnë shtrirjen e teritoreve “historikisht etnike” të shqiptarëve.

¹⁰⁶ UPI, 10:37, 27 gusht 1999.

¹⁰⁷ RFE/RL, *Raport ballkanik*, Vol. 45, 16 gusht, 2000.

Në fund të nëntorit të vitit, delegat nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe nga diaspora janë mbledhur në Prizren për të mbajtur Kongresin e Parë botëror të shqiptarëve. Prizreni paraqet vendlindjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Në Kongres, në të cilin morën pjesë më tepër se 30 delegat u zhvilluan diskutime lidhur me çështjet e radhitura që nga shkëmbimet e kompanive të ndryshme teatrale shqiptare e deri te krijimi i një konvente për themelimin e një instituti për trajnimin e mësuesve, për të trajnuar mësuesit se si të japin mësim kudo nëpër “Trojet e Reja Shqiptare”, term ky që filloi të përdoret në vitin 1999, në kohën e iniciativave për dialog pan-shqiptar të Fatos Nanos, dhe që prej atëherë ka hyrë në gjuhën politike.

Ka ekzistuar një përpjekje e sinqertë në Kongres për mundësinë e një çasjeje të re për disa çështje përmbajtësore siç është debati për përdorimin zyrtar të gjuhës letrare Gegë në Shqipëri. Edhe pse Gegë dhe Toskë paraqesin përafërsisht të njëjtën gjuhë, ato mbeten dy dialekte mjaft të veçanta. Në vitin 1968, si pjesë e një tentative për identifikim me Shqipërinë, studentët shqiptar në Kosovë kanë vendosur të mos e përdorin më gjuhën e tyre tradicionale letrare Gegë, por të favorizojnë gjuhën e adoptuar atëherë të re letrare shqipe të bazuar në dialektin Toskë. Intelegjensa e shqiptarëve të Kosovës ka përkrahur përdorimin e gjuhës letrare të Tiranës nën sloganin “Një komb, një gjuhë”.¹⁰⁸ Që nga rënia e komunizmit në Shqipëri, shumë shqiptarë të Kosovës dhe intelektual të Shqipërisë veriore kanë debatuar lidhur me restaurimin e dialektit Gegë, si një gjuhë letrare zyrtare në një nivel me Toskën. Ashtu sikurse me shumicën e çështjeve pan-shqiptare, çështja e debatit për gjuhën është ngusht e lidhur me përçarjet nacionale që kanë përcjellur ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore ku “unifikimi letrar shqiptar” është ende i parë nga një shumicë njerëzish si një veprim i imponuar në saje të fituesve komunist Toskë ndaj të mundurve Gegë.

VIII. KONKLUZION

Ashtu siç bën të qartë kjo anketë, nocionet e pan-Shqiptarizmit janë shumë më shumë të shtrira dhe më komplekse sesa çështja e karakteristikave të zakonshme të shqiptarëve etnik thjeshtë që synojnë arritjen e Shqipërisë së madhe ose Kosovës së madhe. Në të vërtetë, përçarjet brenda për brenda shqiptarëve gjithandej Evropës Jugore mbeten të theksuara, dhe se dëshira e unifikimit territorial të gjithë popullatës shqiptare është mbajtur shumë më shumë si fuqi miti sesa si agjendë politike praktike. Kjo do të thotë se pan-Shqiptarizmi është vështruar nga shumë jo-shqiptarë si kërcënim i madh për regjionin.

Që prej zbatimit të politikës multi-partiake në Shqipëri, vendi ka luftuar për të tejkaluar varfërinë dhe konfliktin e brendshëm politik. Çështja më e gjerë kombëtare është injoruar në pajtim me nevojën për theks të veçantë në pajtimin kombëtar dhe ndërtimin e ekonomisë së shkatërruar. Si rrejdhojë e kësaj, Shqipëria është e interesuar në zhvillimin e lidhjeve kulturore dhe ekonomike me Kosovën, ndonëse në atë rast do të bëhej ruajtja e shteteve të ndara. Në përgjithësi, lidhjet e Shqipërisë me Kosovën dhe Maqedoninë Perëndimore kanë qenë shumë më pak intime sesa lidhjet ndërmjet këtyre dy të fundit. Për disa qarqe në Shqipëri, veçanërisht, pengesë kryesore në ndërtimin e lidhjeve të ngushta politike ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës është përplasja e theksuar ndërmjet të dy elitave. Dominimi i Toskës në qeverinë e tanishme shqiptare, reflekton një frigë nga mundësia e një inkuorporimi të madh të Gegës në shtetin e bashkuar shqiptar. Përveç përkrahjes së madhe dhënë mijëra refugjatëve Kosovar gjatë viteve 1998 dhe 1999, Shqipëria mbetet e përmbajtur ndaj konflikteve në Preshevë dhe Maqedoni.

Ekziston një paqartësi e theksuar në aspiratat kombëtare ndër-shqiptare. Shqiptarët janë mësuar me idenë e etniteteve të ndara shqiptare në Ballkan. Ata janë në dijeni të ekzistimit të një ndarjeje ideologjike dhe kulturore ndërmjet tyre, dhe si rrjedhojë e kësaj, është duke vazhduar ruajtja e etniteteve të ndara politike me mënjanim të theksuar të kufizimeve të biznes, kulturë dhe lëvizje. Tani për tani, vetëm disa shqiptarë e potencojnë çështjen e formimit të një faktori të vetëm politik. Sodoqoftë, nëse statusi final i Kosovës nuk do të arrihet ashtu siç është paraparë, në Ballkanin jugor nuk do të mund të shmanget

¹⁰⁸ Stavro Skendi, *Studime mbi kulturën e Ballkanit*, Boulder, Colorado, 1980, f. 38-41

shpërthimi i konfliktit. Kështu, pavarësia e Kosovës mbetet element thelbësor i çështjes shqiptare.

Situata lidhur me shqiptarët e Maqedonisë është më komplekse. Ekziston lufta për më shumë të drejta ekonomike, kombëtare dhe kulturore. Në përgjithësi ata janë të fokusuar në arritjen e koekzistencës brenda për brenda shtetit maqedon duke u siguruar në aftësitë për qeverisjen e vetvetes në nivele lokale dhe duke pasur përfaqësim të barabart në nivelin qeveritar. Është esenciale për qeverinë e Maqedonisë të implemetoj në tërësi reformat lidhur me Marrëveshjen e Ohrit, në mënyrë që të pengohet rritja e grupeve të vogla të nacionalistëve radikalë siç është AKSH dhe grupe të tjera me veprim në diasporë.

Pak a shumë mund të flitet njësoj rreth Luginës së Preshevës dhe planit të Qoviqit, i cili është përpiluar me qëllim të re-integrimit të shqiptarëve në jetën e shoqërore serbe. Shqiptarët sidoqoftë, duan të shfrytëzojnë rastin të jetojnë jetën e tyre në shoqëri në gjuhën e tyre amtare. Me progresin e arritur në zgjedhjet e fundit vendore, krijimin e një force policore multietnike dhe planin për koncenus, ekziston edhe më tutje një dëshirë e theksuar në mes të shqiptarëve të Preshevës për autonomi, e tillë çfarë ishte me Kushtetutën Jugosllave të vitit 1974 në Kosovë, ku flitej gjuha shqipe. Në ndërkohë, shqiptarët e Malit të Zi, i kanë rezistuar çdo lloj forme të organizimit parashtarak, dhe në përgjithësi, ata përkrahin qeverinë e kryeministrit Milo Djukanovic. Ata do të vazhdojnë të bëjnë presion për vendosjen e një autonomie, por nuk duan që këtë t'a bëjnë me mjete të dhunëshme.

Për momentin, nuk ekziston ndonjë studim i hollësishëm lidhur me rolin e diasporës në financimin dhe koordinimin e grupeve të ndryshme etnike kryengritëse shqiptare që kanë luftuar në Kosovë, Maqedoni dhe Serbi. Komunitete të diasporës së madhe të shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në SHBA, Gjermani dhe Zvicër kanë pasur dhe do të vazhdojnë të kenë një rol kyç në zhvillimet aktuale ekonomike, sociale, politike në Kosovë tani dhe në të ardhmen si dhe do të vazhdojnë të drejtojnë ngjarjet e formacioneve ushtarake në këto hapsira. Ato shumë lehtë do të hapnin fronte të reja nëse do të dëshironin të mbanin tensionin e ngritur karshi çështjeve të pazgjidhura shqiptare. Për shembull ashtu sikurse grekët që do të mund të ndeznin situatën me

minoritetin e tyre gjithnjë në zvogëlim në Shqipërinë jugore, çështja Çame, që është një plagë e rëndë në marrëdhëniet shqiptaro-greke do të mund të shfrytëzohej lehtë të përdorej për t'ë ushtruar presion gjetkë në aspekte të tjera të një lufte kombëtare -p.sh zhvillimi i presionit për një autonomi të shqiptarëve në Mal të Zi. Për këto arsye do të ishte mirë që Qeveria Shqiptare dhe ajo Greke të provojnë të përpilojnë një marrëveshje të qëndrueshme dhe afatgjate të çështjes së popullatës çame të zhvendosur nga Greqia më 1945, para se kjo çështje të ketë marrë hov dhe eksploduar nga nacionalistët ekstremist atëherë kur ankesat legjitime të çamëve do të ishin humbur në çështje më të thella kombëtare

Ndërmjet shqiptarëve në përgjithësi e në veçanti tek ata që kanë jetuar në ish-Jugosllavi, ekziston një jo-tolerancë në rritje lidhur me qëndrimin e Bashkësisë Ndërkombëtare dhe mospranimin nga ana e saj të zhvillimit të dinamikës së re shqiptare. Populli shqiptar është përgjithësisht një popull i ri me karakteristikë të rritjes së shpejtë, shumica e të cilëve ose janë rritur në klimën e dhunës dhe anarkisë në Shqipëri ose i janë nënshtruar keqpërdorimit të të drejtave njerëzore dhe luftës në ish-Jugosllavi. Ata dëshirojnë të shohin një progres të theksuar jo vetëm në të ardhmen e tyre politike por edhe në përgjithësi në standardet e tyre jetësore dhe në krijimin e mundësive për një jetë të qetë.

